



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 98

Tiranë – E martë, 22 qershor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 16.6.2021	Për miratimin e raportit të tretë periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës kundër Torturës dhe Vuajtjeve të Tjera ose Trajtimit Më të Keq, Jonjerëzor a Degradues..... 9631
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 363, datë 16.6.2021	Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 442, me emërtim “ish-Batalion i Gatshëm”, me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje, truall funksional, pjesë e pronës nr. 436, me emërtim “Ndërtesë sinoptike”, me vendndodhje në Kukës, kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë te Ministria e Mbrojtjes, të një sipërfaqeje prej 1 181 m ² , dy ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit, dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003 dhe nr. 343, datë 7.6.2006..... 9675
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 245, datë 3.6.2021	Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatin..... 9681
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 246, datë 3.6.2021	Për procedurën dhe afatin për marrjen e vendimit të pushimit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë..... 9682
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 25.5.2021	Me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Interpretimin e nenit 98, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë..... 9683
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ali Meti..... 9698



VENDIM
Nr. 347, datë 16.6.2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
TRETË PERIODIK KOMBËTAR MBI
ZBATIMIN E KONVENTËS KUNDËR
TORTURËS DHE VUAJTJEVE TË TJERA
OSE TRAJTIMIT MIZOR, JONJERËZOR
A DEGRADUES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 1, të nenit 19, të Konventës kundër Torturës dhe Vuarjtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Jonjerëzor a Degradues të OKB-së, aderuar me ligjin nr. 7727, datë 30.6.1993, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të tretë periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës kundër Torturës dhe Vuarjtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Jonjerëzor a Degradues, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**SHQYRTIMI I RAPORTEVE DËRGUAR
NGA SHTETET PALË,
NË MBËSHTETJE TË NENIT 19 TË
KONVENTËS SË OKB-së KUNDËR
TORTURËS, TRAJTIMEVE APO DËNIMEVE
TË TJERA TË EGRA, ÇNJERËZORE
DHE DEGRADUESE
SHQIPËRIA**

**RAPORTI I TRETË KOMBËTAR
PERIODIK**

**TABELA E PËRMBAJTJES
LISTA E SHKURTIMEVE
HYRJE**

I. Masat për zbatimin e neneve të Konventës kundër Torturës

Neni 1: Përkufizimi i torturës dhe kriminalizimi i saj

Neni 2: Masa ligjore, administrative dhe gjyqësore për parandalimin e akteve të torturës, trajtimeve apo dënimeve të tjera të egra, çnjërëzore dhe degraduese

Neni 3: Ndalimi i dëbimit apo i ekstradimit kur ka arsye thelbësore për torturë

Neni 4: Parashikimi nga legjislacioni penal i brendshëm (Kodi Penal) i torturës

Neni 5: Juridiksioni mbi veprimet e torturës

Neni 6: Masat për ruajtjen e personave që kanë kryer akte torture, në pritje të fillimit të procedimit penal apo të procedurave të ekstradimit

Neni 7: Ndjekja penale ndaj personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale të torturës, autoriteteve kompetente, në rast se shteti nuk e ekstradon atë

Neni 8: Ekstradimi

Neni 9: Ndihma juridike

Neni 10: Masat e ndërmarra për informimin, trajnimin e personelit ligjzbatues mbi ndalimin e torturës

Neni 11: Ushtrimi i mbikëqyrjes mbi rregullat e marrjes në pyetje, hetimi, ruajtja dhe trajtimi i personave, të ndaluar ose të burgosur

Neni 12: Hetimi i shpejtë dhe i paanshëm i një veprimi kur ka arsye të besueshme se është ushtruar torturë

Neni 13: E drejta e ankimit dhe shqyrtimit të shpejtë dhe të paanshëm

Neni 14: Dëmshpërblimi i viktimës së një akti të torturës

Neni 15: Mospërdorimi i deklaratës së marrë nëpërmjet torturës si element prove në një proces

Neni 16: Parandalimi i veprimeve të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjërëzore ose poshtëruese, që nuk janë veprime torture

II. Masat për zbatimin e vëzhgimeve dhe rekomandimeve përfundimtare

SHTOJCË

Lista e shkurtimeve

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CAT	Komiteti i Konventës kundër Torturës
DPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas



IEVP	Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale
KB	Kombet e Bashkuara
KiE	Këshilli i Evropës
KP	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KKBGJ	Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MKRDHF	Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QKPA	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuues
RSH	Republika e Shqipërisë
VP	Vëzhgimet përfundimtare
VT	Viktimat e trafikimit
VTM	Viktimat e mundshme të trafikimit

I. HYRJE

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën e OKB-së Kundër Torturës dhe Vuajtjeve të Tjera ose Trajtimit Mizor, Jonjerëzor a Degradues¹, me ligjin nr. 7727, datë 30.6.1993.

Bazuar në nenin 19/1 të Konventës, Shqipëria ka paraqitur pranë Komitetit të Konventës (Komiteti CAT) dy raporte periodike mbi zbatimin e neneve të Konventës dhe rekomandimeve të Komitetit CAT ka miratuar konkluzionet dhe rekomandimet për Shqipërinë. Ky Raport është hartuar në përputhje me udhëzimet specifike (*guidelines*), për hartimin e raporteve periodike. Në pjesën e parë të Raportit trajtohen masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave të Konventës, zhvillimet kryesore në kuadrin ligjor, institucional sipas fushave. Në pjesën e dytë trajtohen masat për zbatimin e vëzhgimeve përfundimtare dhe rekomandimeve të Komitetit CAT². Raporti përfshin informacion kryesisht mbi periudhën 2015–2020, por edhe informacion mbi

kuadrin ligjor dhe masave, sipas fushave edhe para kësaj periudhe, në funksion të një raportimi të plotë mbi çështjet që mbulon Konventa kundër Torturës. Në shtojcat pjesë përbërëse të Raportit paraqitet informacion shtesë mbi zbatimin e saj.

Një ndër të drejtat themelore të njeriut është e drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues, e cila sanksionohet nga Kushtetuta, kuadri ligjor, Konventa e OKB-së kundër Torturës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare, shteti shqiptar ka detyrimin dhe përgjegjësinë të krijojë një sistem efikas të brendshëm për parandalimin e fenomeneve të tilla, të garantojë ndjekjen penale të rasteve të torturës ose të trajtimit çnjerëzor e degradues, si dhe shqyrtimin gjyqësor, me paanshmëri dhe efikasitet. Shqipëria është angazhuar për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të saj, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimeve Çnjerëzore ose Degraduese ose Dënimeve (CPT), gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar tri vizita në Shqipëri, me qëllim vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve, vlerësimin e gjendjes dhe kushteve në vendet e ndalimit dhe vuajtjes së dënimit (përfshirë spitalet psikiatrike, qendrat sociale) dhe trajtimin e personave të ndaluar, të dënuar, duke paraqitur edhe raportet me gjetjet dhe rekomandimet. Institucionet shqiptare kanë paraqitur komentet dhe informacionin mbi gjetjet dhe rekomandimet e Komitetit CPT³.

Kushtetuta e RSH-së, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm dhe kuadri ligjor i brendshëm, garantojnë zbatimin në praktikë të të drejtave të njeriut. Konventa kundër Torturës, e cila pas ratifikimit në bazë të Kushtetutës së RSH-së është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm, përbën bazën mbi të cilën mbështetet marrja e masave për eliminimin e çdo forme torture, trajtimi çnjerëzor, degradues. Kuadri ligjor i brendshëm, mbi të drejtat e njeriut, sistemin e burgjeve dhe në fusha të tjera është përmirësuar vazhdimisht, në

¹ Këtej e tutje referuar “Konventa kundër Torturës”. Versioni anglisht: *Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment*.

² CAT/C/ALB/CO/2.

Faqe|9632

³ Informacion mbi vizitat e Komitetit CPT, raportet dhe përgjigjet e institucioneve shqiptare jepet në faqen: <https://www.coe.int/en/web/cpt/albania>



frymën e Konventës kundër Torturës dhe standardeve evropiane.

Bazuar në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, (neni 25/3), ministritë dhe institucionet kompetente, informojnë periodikisht Ministrinë për Evropën dhe Punët të Jashtme (MEPJ), në kuadrin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në të cilat RSH-së është palë. Bazuar në pikën 4 të këtij neni, MEPJ-ja drejton procesin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, të cilat i paraqet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Mbështetur në urdhrin e Kryeministrit nr. 112, datë 5.3.2014, “Për ngritjen e grupit ndërmnisht të punës mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, MEPJ-ja koordinon procesin e përgatitjes së raporteve kombëtare mbi zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut. Ky Raport është hartuar si rezultat i koordinimit dhe përfshirjes të kontributeve të institucioneve qendrore si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në Raport përfshihen kontributet e institucioneve të pavarura, si Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Raporti i tretë periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës kundër Torturës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në shtojcat pjesë përbërëse e këtij Raporti paraqiten gjithashtu informacione shtesë, sipas çështjeve dhe fushave respektive.

I. INFORMACION MBI ZBATIMIN E KONVENTËS KUNDËR TORTURËS, NENET 1–16

Neni 1: Përkufizimi i torturës në legjislacionin shqiptar

1. Kushtetuta e RSH-së (e ndryshuar), parashikon shprehimisht se “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues” (neni 25).

2. Kodi Penal (i ndryshuar) e përkufizon torturën në përputhje të plotë me nenin 1 të Konventës kundër Torturës. KP-ja, në nenin 86

“Tortura”⁴ parashikon se: “Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:

a) për të marrë prej tij ose një tjetri informacion ose pohime;

b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;

c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër;

ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;

d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues, dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Gjithashtu, “Kodi i Procedurës Penale i RSH-së” (i ndryshuar),⁵ me qëllim për të parandaluar çdo lloj torture apo keqtrajtimi ndaj personave nën akuzë, parashikon: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues” (neni 5/1).

3. Në vitin 2020, me ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”⁶ në nenin 3 “Përkufizime” parashikohet se: “Torturë” është çdo veprim me anë të të cilit të burgosurit i shkaktohen qëllimisht dhembje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore, kur këto dhembje ose vuajtje shkaktohen nga personeli i institucionit ose një person tjetër, që vepron në përmbushje të detyrës zyrtare ose me nxitjen apo pëlqimin e tij, i kryer për një nga qëllimet e parashikuara në Konventën kundër Torturës dhe trajtimit ose ndëshkimeve të tjera mizore, njerëzore ose degraduese.

Neni 2, paragrafi 1: Masa të efektshme ligjore, administrative dhe gjyqësore për parandalimin e akteve të torturës

4. Kushtetuta e RSH-së dhe legjislacioni shqiptar, parashikojnë një sërë dispozitash, të cilat garantojnë se askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, si dhe lidhur me parandalimin e akteve të torturës apo keqtrajtimeve. Përcaktimi në Kodin Penal të RSH-së (me ndryshimet përkatëse), i

⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 9686, datë 26.2.2007; ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012.

⁵ Miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 i ndryshuar.

⁶ I miratuar nga Kuvendi në datën 25.6.2020.



torturës si vepër penale dhe dënimin përkatës përbën një masë kryesore në parandalimin e akteve të torturës. Gjithashtu, Kodi Penal e përcakton torturën apo çdo akt tjetër çnjerëzor, si dhe rastet kur këto veprime kanë sjellë pasoja të rënda, si vepër penale me dënimin përkatës (neni 87).

5. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar), përcakton se: 1. Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. 2. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues. 3. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.

6. Neni 248, KP-ja sanksionon: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta ose kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

7. Neni 314, KP-ja sanksionon: “Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”. Nga një analizë e elementeve objektive dhe subjektive të këtyre veprave penale krijohet përshtypja se mund të ketë paqartësi të organeve të hetimit dhe gjykimit, lidhur me cilësimin juridik të veprës, përfshirë dhe torturën.

8. Duke analizuar elementet e këtyre veprave penale, respektivisht, “dashja në kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve, në kundërshtim me ligjin ... nga personi me funksione publike..., të cilët kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetasve...” apo “kryerja e veprimeve ose dhënie e urdhrave arbitrarë... punonjës me funksion shtetëror apo publik...”, ose “përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve... detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri...”, të parashikuara në veprat përkatëse, mund të jenë elemente të anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale të torturës apo trajtimit çnjerëzor ose degradues (nenet 86, 87 i KP-së).

9. Kodi i Procedurës Penale i RSH-së (i ndryshuar) parashikon se legjislacioni procedural

Faqe|9634

penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve. Me ndryshimet në vitin 2017⁷ dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit, si dhe të pandehurit e mitur (nenet 1, 2). Neni 11 i KP-së parashikon se Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë dhe askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një vepre penale pa vendim gjykatë.

10. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, parashikon se Policia e Shtetit ka si për mision respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtave që kanë personat e privuar nga liria (të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar) në ambientet e policisë, si dhe detyrimet e policisë për të respektuar e garantuar ato. Parimet e veprimtarisë së Policisë së Shtetit, si: ligjshmëria, mosdiskriminimi, respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, proporcionaliteti, pavarësia operationale, paanshmëria politike, integriteti, merita dhe profesionalizmi, transparenca, kontrolli dhe llogaridhënia.

11. Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH-së”, parashikon, ndër të tjera, se:

Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj (neni 3).

- Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-së dhe ligjeve të tjera në fuqi; prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik (neni 4).

- Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat,

⁷ Me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera (neni 8).

12. Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i ndryshuar)⁸, i cili ka qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri nr. 81/2020 ka parashikuar të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente⁹.

13. Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ka si objekt përcaktimin e të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimin e sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente. Ligji synon garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Në nenin 5, “Respektimi i të drejtave të njeriut”, parashikohet se të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për RSH-së. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Në nenin 71, përcaktohet ndalimi i përdorimit të forcës për qëllime të torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues.

14. Prej vitit 2008, në bazë të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (i ndryshuar¹⁰), institucioni i Avokatit të Popullit ushtron funksionet e “Mekanizmit kombëtar për parandalimin e

torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

16. Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikon kompetencat, garancitë, dhe format e mbikëqyrjes për mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij (neni 81).

17. Në ligjin nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (neni 4), përcaktohet se “prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi, si dhe kompetencat e tyre, duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.

18. Ligji nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e çrregullime që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor, duke përcaktuar procedurat dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor”.

Neni 2, paragrafi 2. Masat ligjore, administrative dhe gjyqësore për ndalimin e torturës në çdo rrethanë, duke përfshirë gjendjen e luftës, destabilitetin e brendshëm politik, emergjencë tjetër publike

19. Kushtetuta (neni 17) parashikon kufizimet e të të drejtave dhe lirive vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 26 i saj ndalon kryerjen e një pune të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve.

⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 8758, datë 26.3.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9071, datë 22.5.2003 (ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10.3.2008; ndryshuar me ligjin nr. 10087, datë 26.2.2009; ndryshuar me ligjin nr. 40/2014.

⁹ Informacion i detajuar mbi parashikimet e këtij ligji është dhënë në raportin e dytë mbi zbatimin e Konventës kundër Torturës.

¹⁰ Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.



20. Kodi Penal si vepra penale (neni 75) parashikon edhe: “Veprat e kryera nga persona të ndryshëm në kohë lufte, si vrasja, keqtrajtimi ose dëbimi për punë skllavëruese, si dhe për çdo lloj shfrytëzimi tjetër çnjerëzor në dëm të popullsisë civile ose në territor të pushtuar, vrasja ose keqtrajtimi i robërve të luftës, vrasja e pengjeve, shkatërrimi i pasurisë private ose publike, shkatërrimi i qyteteve, komunave, fshatrave jo të diktuar nga nevoja ushtarake” me dënimin maksimal jo më pak se 15 vjet ose me burgim të përjetshëm”.

21. Në Shqipëri nuk ka një ligj për gjendjen e luftës apo destabilitet të brendshëm politik që të ndryshojë statusin dhe detyrat e përgjegjësitë institucionale të Policisë së Shtetit dhe të ketë si objekt rregullimin apo të justifikojë torturën dhe shkeljen e të drejtave të personave që janë të ndaluar apo arrestuar. Kështu që edhe në këto raste do të zbatohen të njëjtat dispozita që parashikon legjislacioni në fuqi. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (neni 4) parashikon se Statusi i Policisë, i përcaktuar në këtë ligj, nuk ndryshon edhe në kushtet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme apo të rasteve të fatkeqësive natyrore. Policia zbaton masat e jashtëzakonshme në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin përkatës.

22. Ky ligj në nenin 101 përcakton se punonjësit e Policisë në zbatim të përgjegjësive të përcaktuara në këtë ligj, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) duhet të shmangin në të gjitha rastet rrezikun për shtetasit dhe veten;

b) në rastet kur punonjësit e Policisë vlerësojnë se ka nevojë për marrjen e masave shtesë ose nevojitet ndihmë, duhet menjëherë të njoftojnë autoritetet përgjegjëse administrative dhe t'i këshillojnë ato për masat e mundshme.

23. Sipas nenit 102, masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe ajo nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur. 2. Masa mbetet e përshtatshme edhe nëse ajo ul masën e rrezikut ose e pakëson atë përkohësisht. Nëse masa është e pafektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër me ndikim më të madh. Neni 103 parashikon, se: 1. Ekzekutimi i menjëhershëm i masës mund të merret vetëm nëse duhet mënjanuar një rrezik real dhe i çastit për sigurinë dhe rendin publik, i cili nuk

mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera. 2. Personi, ndaj të cilit ndërmerret masa, duhet të njoftohet menjëherë për masën e marrë.

24. Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikon dispozita mbi trajtimin e ndryshëm të përligjur të të burgosurit, i cili, duhet të jetë i përligjur dhe të rezultojë i nevojshëm, për shkak të rrezikshmërisë që paraqet i burgosuri dhe të ketë për qëllim përmbytjen e funksionit rehabilitues të dënimit (neni 7). Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbytje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj (neni 8).

25. Sipas nenit 9, KP “Kufizimi në grup i të drejtave”, të drejtat e të burgosurve mund të kufizohen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë, në minimumin e nevojshëm, në përmbytje të një qëllimi të ligjshëm dhe vetëm në rastet e veçanta: a) gjendjes së jashtëzakonshme, të shpallur me ligj; b) situatës emergjente; c) gjendjes së luftës; ç) gjendjes së emergjencës, në përputhje me legjislacionin për emergjencat civile; d) rreziqeve potenciale për jetën dhe shëndetin e të burgosurve; dh) sulmeve të armatosura nga jashtë institucionit apo referimit të informacionit për kryerjen e sulmeve të mundshme.

Neni 2, paragrafi 3: Masat ligjore, administrative për ndalimin e torturës, në rastet kur një urdhër nga një nëpunës epror apo autoritet publik përdoret për të justifikuar torturën

26. Në Kodin Penal (i ndryshuar) përcaktohen dhe sanksionet që merren ndaj personave të ngarkuar me zbatimin e ligjit kur ushtrojnë veprime dhe mosveprime në kundërshtim me ligjin. Kodi Penal, përmban dispozita të cilat parashikojnë si kundërvajtje apo vepër penale (me sanksionet përkatëse), kryerjen e veprimeve ose dhënien e urdhrave arbitrarë të cilat prekin lirinë e shtetasve, nga punonjësit që ushtrojnë një funksion shtetëror apo publik, mosmarrjen e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme (nenet 250, 251 të KP-së).

27. Në nenin 248, “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve apo e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbytje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose



personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

28. Në nenin 253, “Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

29. Në KP, lidhur me veprën penale “zhdukja me forcë” (neni 109/c) parashikohet se eprori, që:

a) ka dijeni se vartës të vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tij efektiv po kryejnë ose do të kryejnë zhdukje me forcë, ose nuk merr parasysh të dhëna dhe informacione që e tregojnë qartë këtë fakt;

b) ushtron përgjegjësinë dhe kontrollin e tij efektiv mbi veprimtaritë me të cilat është lidhur zhdukja me forcë;

c) nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të arsyeshme që janë në kompetencën e tij për të penguar ose ndëshkuar personin që jep autorizimin, mbështetjen dhe miratimin e zhdukjes me forcë, ose për t’ua dërguar çështjen organeve kompetente të ndjekjes penale, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

30. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (neni 86), përcakton detyrimin për punonjësit e policisë që të zbatojnë vetëm urdhrat të bazuar në ligj:

1. Punonjësi i Policisë duhet të zbatojë të gjithë urdhrat që i jepen nga një person më i lartë në funksion ose në gradë.

2. Punonjësi i policisë, nëse ka arsye të dyshojë se urdhri i dhënë është i paligjshëm, ai menjëherë ia bën të ditur eprorit dhe, kur është e mundur, kërkon me shkrim që urdhri të jepet me shkrim. Në çdo rast, kur ka kërkesë verbale apo me shkresë për dhënien e urdhrit me shkrim, eprori është i detyruar të procedojë sipas kërkesës me shkrim.

3. Në rastet kur moszbatimi i urdhrit deri në dhënien e tij me shkrim, sipas pikës 2 të këtij neni,

rrezikon jetën e një personi tjetër, punonjësi i policisë duhet të zbatojë urdhrin.

4. Kur një punonjës policie, edhe pas zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë nen, vazhdon të ketë arsye për të dyshuar se urdhri është i paligjshëm, ai kryen veprimet e mëposhtme:

a) kundërshton urdhrin, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 3, të këtij neni;

b) vë menjëherë në dijeni punonjësin e policisë, i cili është drejtpërdrejt në një funksion më të lartë se sa eprori që ka dhënë urdhrin, si dhe për masat e marra prej tij në zbatim të këtij neni.

31. Në ligjin nr. 97/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH-së”, përcaktohet se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë jepen me shkrim dhe janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët. Ky përcaktim bën të mundur eliminimin e rasteve për dhënien e urdhrave verbalë arbitrare nga punonjës me funksion publik apo shtetëror.

Neni 3: Ndalimi i dëbimit apo i ekstradimit kur ka arsye thelbësore për torturë

32. Kushtetuta parashikon mbrojtjen dhe trajtimin e të huajve dhe garantimin e të drejtave të tyre, si dhe parimin e moskthimit të një personi në një vend tjetër ku ai do t’i nënshtrohej torturës. Të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet për shtetasit shqiptarë vlejnë edhe për të huajt, personat pa shtetësi me përjashtim të rasteve kur ushtrimi i tyre lidhet në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare (neni 16).

33. Ligji nr. 108/2013, “Për të huajt” (i ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, datë 14.7.2016 dhe ligjin nr. 13/2020) rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, qarkullimit, punësimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, si dhe të daljes së tyre prej territorit të saj. Subjekt i këtij ligji janë të huajt, të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në RSH-së, me qëllim qëndrimin, tranzitimin, punësimin, studimin ose ripranimin. Ky ligj garanton të drejtat dhe detyrimet e të huajve që punojnë dhe jetojnë në Shqipëri.

34. Ky ligj respekton parimet e normat e pranuar të akteve ndërkombëtare, parimin e reciprocitetit, parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe interesat e sigurisë kombëtare dhe publike. Ligji përcakton dispozita lidhur me largimin e detyruar, të drejtat dhe detyrimet, procedurat përkatëse për nxjerrjen jashtë territorit dëbimin, procedurat për ekzekutimin e urdhrit të



largimit, rastet e përjashtimit të nxjerrjes jashtë territorit të RSH-së, largimin e të huajit në rastet kur ka kryer vepër penale. Të huajt kanë të drejtën e ankimimit administrativ dhe gjyqësor ndaj urdhrit të largimit, refuzimit të çdo kërkesë, masave ndëshkimore ose gjobave, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Neni 49 përcakton rastet e përjashtimit nga nxjerrja jashtë kufirit të RSH-së dhe konkretisht asnjë shtetas i huaj, me status refugjati apo gjatë shqyrtimit të kërkesës për azil, nuk do të nxirret jashtë kufijve të RSH-së në drejtim të një vendi tjetër, ku jeta ose liria e tij kërcënohen për shkak të racës, bindjeve fetare, përkatësisë etnike, bindjeve politike ose përkatësisë në një grup politik apo social. Nuk do të nxirret jashtë kufijve të RSH-së edhe ai person i huaj për të cilin ka arsye të besohet se i kërcënohet jeta në vendin ku do të dëbohet.

35. Ligji përcakton se “i huaj” është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar. Ky ligj parashikon se “dëbimi” është zbatimi i detyrimit për kthim i të huajit, subjekt i urdhrit të dëbimit, të personit të shpallur si i padëshiruar, si dhe ai i largimit të të huajit nga autoritetet e përcaktuara në këtë ligj. Ligji parashikon dispozita të detajuara lidhur me rastet, kriteret e dëbimit të të huajit, urdhrin e dëbimit, autoritetet përgjegjëse, të drejtën e ankimimit ndaj urdhrit të dëbimit. Deri në përfundimin e procedurës së ankimit, i huaji mbahet në kushtet e masave alternative të mbikëqyrjes ose në qendrën e mbyllur, në pritje të largimit të menjëhershëm, sipas urdhrit të nxjerrë për këtë qëllim.

36. Ligji nr. 121/2014, “Për azilin në RSH-së”, i cili ka qenë në fuqi deri në hyrjen e ligjit të ri për azilin, në shkurt 2021¹¹ parashikonte: të drejtën për azil apo mbrojtje plotësuese dhe të përkohshme; të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, refugjatëve e të personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese; përmbajtjen e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese; të drejtën për bashkim familjar, si dhe përcaktimin e kushteve për integrimin e refugjatëve e të personave nën mbrojtje plotësuese në RSH-së. Ky ligj parashikonte detyrimin për të mos kthyer dhe larguar jashtë territorit të vet, personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të

mbrojtjes së përkohshme, si dhe rastin ku ka arsye të besueshme se azilkërkuesi mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në traktatet/konventat ndërkombëtare ku RSH-së është palë.

37. Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, është përafëruar me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së mbi trajtimin dhe menaxhimin e duhur të refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar, si dhe për integrimin e tyre. Ligji garanton që personat që kërkojnë azil të kenë qasje në procedurën e azilit, rregullon kushtet për përpunimin e kërkesave të tyre dhe ofron garanci shtesë për trajtimin e kategorive të ndjeshme midis azilkërkuesve – siç janë të miturit e pashoqëruar. Ligji, përfshin një procedurë të përsheptuar për të vlerësuar kërkesat e azilit në mënyrë të shpejtë, kur plotësohen kushtet. Ligji parashikon se “azili” është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që RSH-së u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese.

38. Ky ligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e RSH-së, për aq kohë sa atyre u lejohej të qëndrojnë në territorin e RSH-së si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre. Ligji (neni 3) parashikon shprehimisht se “moskthimi” është detyrimi i ndalimit për të dëbuar apo kthyer shtetasin e huaj ose personin pa shtetësi, në çfarëdo mënyre në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta ose liria e tij, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjeve të tij politike. Neni 11, “Parimi i moskthimit parashikon”: 1. Kërkuesi, refugjati, personi me statusin e mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme nuk dëbohet, kthehet apo ekstradohet jashtë territorit të RSH-së: a) në një shtet ku jeta ose liria e tij kërcënohet për shkak të racës, të besimit, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike; b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në marrëveshjet/konventat ndërkombëtare ku

¹¹ Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në RSH-së”, miratuar nga Kuvendi më 1.2.2021.



Republika e Shqipërisë është palë; c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë; ç) në shtetin e tij të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

39. Sipas nenit 11/2, i huaji, kërkesa e të cilit është refuzuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nuk dëbohet ose nuk nxirret jashtë territorit të RSH-së përpara ushtrimit apo dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe. Sipas nenit 11/3, "Përjashtimisht", kërkuesi mund të kthehet, kur: a) ka arsye të bazuara për ta konsideruar atë si një rrezik për sigurinë kombëtare të RSH-së; b) është dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për një krim i cili përbën rrezik për sigurinë e RSH-së.

Neni 4: Parashikimi nga legjislacioni penal i brendshëm (Kodi Penal) i torturës

40. Neni 87 i KP-së, "Tortura me pasoja të rënda" parashikon, se: tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor, kur ka sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

41. Kodi Penal përcakton si veprë penale përdorimin e dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë fajësinë e tij a të një tjetri dhe parashikon dënimin me burgim nga 3-10 vjet" (neni 314).

42. Në Kodin Penal të RSH-së (të ndryshuar) është shtuar një rrethanë tjetër rënduese në nenin 50, "Rrethanat rënduese" dhe konkretisht me këtë përmbajtje: "kryerja e veprës e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale", rrethanë e cila e rëndon dënimin për veprat penale të përcaktuara nga KP-ja.

Neni 5: Juridiksioni mbi veprimet e torturës

43. Fusha e zbatimit të ligjit penal shqiptar parashikohet në nenet 5, 6, 7, 7/a, 8 dhe 9 të Kodit Penal. KP-ja parashikon se Shqipëria ka juridiksion universal për veprën penale të torturës. Konkretisht neni 7/a, "Ligji penal i RSH-së është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që ndodhet në territorin e RSH-së dhe nuk është ekstraduar, i cili jashtë

territorit të RSH-së ka kryer torturë. Ligji penal është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që jashtë territorit të RSH-së kryen ndonjëherë nga veprat penale, për të cilat ligje të veçanta ose marrëveshje ndërkombëtare ku RSH-së është palë, përcaktojnë zbatueshmërinë e legjislacionit penal shqiptar."

44. Mbështetur në Kodin e Procedurës Penale (i ndryshuar), juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në Kod.

Neni 6: Masat për ruajtjen e personave që kanë kryer akte torture, përpjekje për të ushtruar torturë, bashkëpunim apo pjesëmarrje në torturë, në pritje të fillimit të procedimit penal apo procedurave të ekstradimit

45. Legjislacioni shqiptar parashikon një sërë masash ligjore për të marrë një person në ruajtje ose për të siguruar praninë e tij. Për personat që kanë kryer akte torture, përpjekje për të ushtruar torturë, bashkëpunim apo pjesëmarrje në torturë, në pritje të fillimit të procedimit penal apo procedurave të ekstradimit zbatohen të njëjtat procedura ligjore (të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe KPP-ja), për ruajtjen dhe trajtimin e tyre, si për të gjithë personat e ndaluar apo të cilëve iu është privuar liria.

46. Mbështetur në Kodin e Procedurës Penale (KPP), dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit (neni 2). KPP-ja parashikon qartë rastet e kufizimit të lirisë së personit me masa sigurimi, konkretisht kur: a) ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

47. Në bazë të ligjit të Kodit të Procedurës Penale" (i ndryshuar), liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj (neni 5). KPP-ja parashikon se, masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës



kompetente arsyet. KPP-ja (i ndryshuar) lidhur me ekstradimin parashikon rregullat dhe procedurën e nevojshme që ndiqet nga ana e organeve përkatëse (Policia Gjyqësore, Prokuroria, Gjykata, Ministria e Drejtësisë). Në bazë të këtij Kodi, prokurori, personi i interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit, mbi vendimin e dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet.

48. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, përcakton se punonjësi i Policisë ka për detyrë që në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar arratisjen e një personi në rastet e shoqërimit, të ndalimit apo të arrestimit nga Policia. (neni 89).

49. Neni 109 parashikon rastet e Shoqërimit në polici ku ndër të tjera parashikohet: kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale; për të parandaluar kryerjen e një veprë penale; kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale; për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë. Ky ligj parashikon detyrimin për policinë që të hedhë dhe administrojë të dhënat për personat e shoqëruar në rrugë manuale dhe në rrugë elektronike dhe në përfundim të shoqërimit të përpilojë një procesverbal të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar dhe dhënien e një kopjeje të këtij procesverbal personit të shoqëruar, kur lihet i lirë.

50. Dispozitat e ligjit nr. 108/2014 parashikojnë, gjithashtu:

- Kushtet, format dhe procedurat e kryerjes së kontrollit të personit, si: për të shmangur një rrezik real dhe të çastit; për objekte ose sende që mund të rrezikojnë jetën e tij ose të tjerëve; për të siguruar prova për kryerjen e veprës penale (neni 113).

- E drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore nga çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër lidhur me sjelljen/qëndrimin dhe verifikimet e policisë, si dhe detyrimin e policisë për të evidentuar/regjistruar,

trajtuar, zgjidhur dhe kthyer përgjigje ankuesit/kërkuesit (neni 115).

- Rastet kur policia kryen shoqërimin e personave si masë mbrojtëse ndaj atyre personave gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tyre dhe për këtë arsye mund pësojnë dëmtime fizike ose përbëjë rrezik për jetën e tyre ose të të tjerëve, si: personat e sëmurë mendor, të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës (neni 122).

- Rregullat për përdorimin e forcës vetëm në rastet e përmbushjes së detyrës, kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura (neni 133).

Neni 6, paragrafi 3: Masat që garantojnë komunikimin e personit të arrestuar me përfaqësuesit më të afërt të shtetit të tij apo në rastin kur është pa shtetësi me përfaqësuesit e shtetit ku ai banon zakonisht.

51. Në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, parashikohen rastet dhe trajtimin e të huajve që janë subjekt dëbimi nga territori i Republikës së Shqipërisë. Në nenin 126 përcaktohet se me kërkesën e të huajit ose, kur përcaktohet nga një marrëveshje dypalëshe, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme njoftohet menjëherë misioni diplomatik apo konsullor i shtetit të të huajit të ndaluar në qendër, për ndalimin e tij, si dhe për zgjatjen e periudhës së ndalimit. Në rast se i huaji ka kërkuar azil ose gëzon statusin e refugjatit apo të një mbrojtjeje tjetër nga Republika e Shqipërisë, ky informacion nuk do t’i bëhet i ditur përfaqësuesit konsullor apo diplomatik të vendit të tij.

52. Në nenin 127 të këtij ligji parashikohen të drejtat e të huajit të ndaluar në qendrën e mbyllur dhe konkretisht i huaji, i cili qëndron në një qendër të mbyllur, sipas dispozitave të këtij kreu, njihet në gjuhën që kupton, me çdo veprim, i cili kryhet nga autoritetet kompetente, për mbajtjen e tij në qendër, si dhe gëzon të drejtën për një trajtim njerëzor. Sipas nenit 127/3 i huaji gëzon të drejtën për të informuar përfaqësuesin konsullor për ndalimin e tij. I huaji gëzon të drejtën për t’u ankuar në gjykatën e rrethit gjyqësor për shkeljen



në qendër të të drejtave të tij themelore. Në rast se ripranohet, i huaji informohet për të drejtat dhe detyrimet, që ka në bazë të legjislacionit shqiptar, në gjuhën që kupton (neni 127/5).

Neni 7: Ndjekja penale ndaj personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale të torturës, autoriteteve kompetente në rast se shteti nuk e ekstradon atë

53. Mbështetur në Kushtetutën e RSH-së ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor.

54. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) parashikon rregullat që ndiqen lidhur me procedimin e drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, për të mbrojtur liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve. Ky Kod parashikon organet që ushtrojnë ndjekjen penale dhe funksionet:

- Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë.

- Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

- Policia gjyqësore, merr dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, kryen hetime që i shërbejnë zbatimit të ligjit penal.

55. KPP-ja i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, parashikon:

- Të drejtat e viktimës nga vepra penale: Gjatë procedimit penal, viktimat ka të drejtat e parashikuara nga ky Kod. Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.

- Dispozitat procedurale mbi rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit

penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

- I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

- Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

- Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. Cilësia e të pandehurit rimerret kur priset vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit (neni 34).

56. Sipas KPP-së (i ndryshuar), merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit. 2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. 25 3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur priset vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit.

57. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar¹²) në nenin 450 parashikon se rishikimi mund të kërkojë edhe në rastin kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjykimit të çështjes. KPP-ja¹³ parashikon rastet e vendimit të gjykatës në favor ose kundër ekstradimit:

¹² Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

¹³ Ndryshuar pikat 1 dhe 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



1. Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit, kur në ngarkim të personit të kërkuar ka një masë shtrënguese, kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.

2. Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit.

3. Kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit, ekstradimi nuk mund të bëhet.

4. Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata.

5. Kundër vendimit të gjykatës, lidhur me kërkesën e ekstradimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga personi i interesuar, nga mbrojtësi i tij dhe nga prokurori brenda 10 ditëve.

Neni 7, paragrafi 3: Masat mbi hetimin e personave që kryejnë akte torture, si dhe trajtimi i tyre në të gjitha fazat e procedimit penal

58. Në bazë të nenit 27 të Kushtetutës, “Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ndër të tjera parashikohet se liria e personit mund të kufizohet, kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Personi duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Në të gjitha rastet e tjera, personi, që i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, që vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase (neni 28/4). Çdo person, të cilit i është hequr liria, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij (neni 28/5).

59. Sipas nenit 28, personit të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai

kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet dhe ky person duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.

60. Kushtetuta (neni 30) përcakton, se: “Kushdo konsiderohet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Sipas nenit 31, “gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë; a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t’i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe; ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme; d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, që mund të sqarojnë faktet”.

61. KPP-ja (neni 5) parashikon kufizimet e lirisë së personit vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj; ndalimin e torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues; trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral i të dënuarve me burgim.

62. KKP-ja i ndryshuar¹⁴, parashikon se:

- I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod (neni 6).

- Në të gjitha fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e faktet, si dhe për zhvillimin e procedimit (neni 8).

- Faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. 2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij (neni 8/a).

- Rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje:

1. I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi

¹⁴ Me ligjin nr. 35/2017.



izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës. 2. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve, KPP-ja, i ndryshuar (neni 38).

63. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” (neni 109/3) parashikon të drejtat e personave të shoqëruar, si: njoftimi në gjuhën që ata kuptojnë për shkaqet e shoqërimit; njoftimi se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë, të drejtën që të mbahen në ambiente të përshtatshme dhe me kushte të ndryshme nga ambientet ku mbahen të ndaluarit/arrestuarit, të drejtën për të njoftuar një pjesëtar të familjes apo person tjetër, të drejtën për të komunikuar menjëherë me një person të besuar dhe avokatin. E drejta që t’i drejtohen gjykatës për ankesat/kërkesat që mund të kenë lidhur me shoqërimin, në çdo kohë.

Neni 8: Ekstradimi

64. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar), lidhur me zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare parashikon: Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi (neni 10).

65. KPP-ja (neni 488), parashikon se: “Dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit”. Në KP parashikohen kushtet që duhen të përmbushen lidhur me “kërkesën për ekstradim” (neni 489); Në nenin 490 të KPP-së¹⁵ parashikohen “kushtet e ekstradimit”. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t’i dorëzohet një shteti tjetër për një veprë penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

66. Ky Kod (neni 491)¹⁶ parashikon mospranimin e kërkesës për ekstradim, ku përfshihet edhe rasti kur ka arsye të mendohet se

personi që kërkohet do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve, për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut. KPP-ja parashikon dispozita mbi: veprimet e prokurorit – neni 492; masat shtrënguese dhe sekuestrimet (neni 493); zbatimin e përkohshëm i masave shtrënguese (neni 494); arrestimi nga policia gjyqësore (neni 495); shqyrtimi i kërkesës për ekstradim (neni 497).

67. Në rastin kur Shqipëria refuzon një kërkesë ekstradimi, për shkak se personi është shtetas shqiptar, atëherë kjo kërkesë trajtohet si njoftim për kryerjen e një veprë penale nga një shtetas shqiptar jashtë vendit dhe në bazë të neneve 6 dhe 7/a të Kodit Penal, autoritetet përkatëse janë të detyruara të regjistrojnë veprën penale kundër personit dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme, sipas legjislacionit të brendshëm dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë për të siguruar praninë e tij. Procedimi penal në Shqipëri është i detyrueshëm dhe prokurori nuk ka të drejtë që të vendosë fillimin ose jo të procedimit penal në varësi të rëndësisë së veprës penale.

Neni 9: Ndihma juridike

68. Procedura e komunikimit ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale, rregullohet nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe KPP-së së RSH-së. Ndihma juridike në fushën penale rregullohet nga:

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”, protokollet e saj shtesë;

- Konventa Evropiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”;

- Protokolli shtesë i Marrëveshjes Evropiane “Për transmetimin e kërkesave për ndihmë juridike”.

69. Kodi i Procedurës Penale parashikon se marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij kodi. Gjithashtu, KPP-ja (titulli X, kreu II, nenet 505–508) parashikon për letërporositë nga jashtë shtetit.

¹⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 99, datë 31.7.2014.

¹⁶ Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



70. Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar me ligjin nr. 100/2013” ka për objekt përcaktimin e rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale.

Neni 10: Masat e ndërmarra për informimin, trajnimin e personelit ligj zbatues mbi ndalimin e torturës¹⁷

71. Në vazhdimësi janë zhvilluar trajnime të personelit ligjzbatues lidhur me respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore të tyre; rregullat dhe procedurat standarde që kanë të bëjnë me mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit.

72. Personeli i Policisë së Shtetit, i cili është përgjegjës për sigurimin, trajtimin e të ndaluarve, arrestuarve deri në momentin e caktimit të masës së sigurimit “arrest me burg” nga organet e gjykatës, përzgjidhet në bazë të kriterëve profesionale. Personeli i strukturave të policisë ka si detyrë njohjen dhe zbatimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që sanksionojnë të drejtat dhe liritë themelore të personave që u privohet liria, si dhe ju nënshtrohen trajnimeve e kontrolleve të vazhdueshme në këtë drejtim. Për njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në mënyrë të vazhdueshme dhe konstante janë kryer trajnime që kanë të bëjnë me rritjen e nivelit të njohjes dhe zbatimit të të drejtave që ka kjo kategori personash. Çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë harton programe për zhvillimin e trajnimeve me punonjësit e policisë sipas niveleve dhe gradave.

73. Janë miratuar procedurat standarde mbi “Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” (miratuar me urdhrin nr. 440/3, datë 27.4.2017). Në zbatim të ligjit për Policinë e Shtetit është miratuar “Rregullorja e personelit të Policisë së Shtetit”, e cila ka ndër të tjera si qëllim, përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me trajnimin e personelit të Policisë së Shtetit.

74. Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit të burgjeve, në mënyrë që ata t’u përgjigjen nevojave të të gjitha kategorive të të dënuarve, si dhe ndryshimeve cilësore që po pëson sistemi i burgjeve dhe paraburgimeve, ka qenë dhe mbetet prioritet i strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Prej vitit 2016, në sistemin e burgjeve zbatohet një platformë për motivimin e stafit gjatë ushtrimit të detyrave funksionale (miratuar me urdhrin nr. 19, datë 2.6.2016 të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve), në funksion të sjelljes etike dhe korrekte gjatë ushtrimit të detyrave funksionale veçanërisht nga punonjësit e sigurisë.

75. Lidhur me formimin bazë të personelit multidisiplinar të sistemit të burgjeve, në lidhje me Manualin për Hetimin dhe Dokumentimin Efektiv të Torturës, Dënimeve dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese (Protokolli i Stambollit), Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka trajnuar periodikisht stafin e sigurisë, civil dhe mjekësor mbi këtë manual dhe formatet përkatëse të dokumentimit të rasteve. Programi i miratuar i trajnimit për punonjësit e nivelit bazë të sigurisë përfshin një modul mbi konceptet dhe parandalimin e torturës nga administrata e sistemit të burgjeve. Janë miratuar udhëzues administrativë, për shërbimin psikosocial, shëndetësisë dhe të sigurisë në institucionet e vuajtjes së dënimit (IEVP).

Neni 11: Ushtrimi i mbikëqyrjes mbi rregullat e marrjes në pyetje, hetimi, ruajtja dhe trajtimi i personave, që i nënshtrohen çdo forme arresti, ndalimi ose burgosjeje, me qëllim parandalimin e çdo lloji rasti torture në të gjithë territorin

76. Kodi i Procedurës Penale¹⁸ (neni 34/a – Të drejtat e të pandehurit), parashikon:

- Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë:

a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave; b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar; c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara; ç) të mbrohet vetë

¹⁷ Informacion i detajuar jepet në vijim mbi zbatimin e rekomandimeve specifike.

¹⁸ Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike; dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson; e) të këtë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen; ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi; f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij; g) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit; gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

- Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.

77. KPP-ja (i ndryshuar) parashikon të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar (neni 34/b). I arrestuari ose i ndaluar ka të drejtë: a) të takojë mbrojtësin e tij; b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij; c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij. Në rast se i arrestuari ose i ndaluar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij dhe në rast se është person pa shtetësi apo refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet një organizatë ndërkombëtare; ç) të marrë përkujdesjen e nevojshme mjekësore. Organi procedues e njofton menjëherë personin e arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. Personi ka të drejtë ta mbajë letrën e të drejtave.

78. Ligji nr. 81/2020 për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve – neni parashikon se: Të burgosurit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Të burgosurit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 12: Hetimi i shpejtë dhe i paanshëm i një veprimi kur ka arsye të besueshme se është ushtruar torturë

79. KPP-ja i ndryshuar parashikon respektimin e normave procedurale. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit. KPP-ja parashikon dispozita mbi: hetimet paraprake; kushtet e procedimit; veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore; veprimtaria e prokurorit; sigurimi i provës; afatet e përfundimit të hetimeve.

Neni 13: E drejta e ankimit dhe të shqyrtimit të shpejtë dhe të paanshëm të çështjes së tyre

80. Kodi i Procedurës Penale parashikon dispozita mbi ankimet; rastet dhe mjetet e ankimit. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. Kodi parashikon:

- ankimin e prokurorit në gjykatën më të lartë, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod;

- ankimi i viktimës akuzuese vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, si për efekte penale, ashtu dhe për ato civile;

- ankimi i të pandehurit, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit.

81. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, (neni 6/4) parashikon se në rastet e ushtrimit të dhunës, autoritetet e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale nisin hetim të pavarur nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, të mbrojtjes dhe të sigurisë personale. Neni 10, parashikon të drejtën e ankimit dhe paraqitjes së kërkesave. Të burgosurit, individualisht ose në grup, kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe ankesa për zbatimin e këtij ligji, legjislacionit në fuqi, të rregullores së përgjithshme të burgjeve, si dhe të rregullores së brendshme të institucioneve.

82. Rregullat dhe procedurat standarde të trajtimit të personave të ndaluar dhe të arrestuar në ambientet e policisë”, përfshijnë evidentimin dhe



trajtimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit.

Neni 14: Dëmshpërblimi i viktimës së një akti të torturës

83. Gjatë procedimit penal, viktimat ka të drejtat e parashikuara nga KPP-ja (neni 9/a – Të drejtat e viktimës nga vepra penale- shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017). Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.

84. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) përmirësojnë ndjeshëm të drejtat dhe pozitën e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore. Më konkretisht, është prezantuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal, janë shtuar nene të tjera, specifikisht për viktimat e trafikimit, në të cilat janë parashikuar si figura të posaçme viktimat e mitur dhe viktimat e abuzuar seksualisht apo subjekt i trafikimit përkatësisht neni 58, 58/a dhe 58/b, 59, 60 dhe 61 i KPP.

85. Neni 58, KPP-ja: 1. Viktimat e veprës penale ka të drejtë: a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale; c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar; ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi; d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues; g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal.

86. Në ligjin nr. 97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/

koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/ përgjegjëse për informimin e viktimave. Në këtë ligj (neni 68) është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbime të nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas kodit të procedurës penale dhe për këtë në çdo prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

87. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikon parandalimin e dhunës dhe trajtimi i viktimës (neni 6). 1. Të burgosurit që ka pasur përvojë të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i sigurohen menjëherë masa mbrojtje, mbështetje dhe këshillime ligjore, me qëllim rehabilitimin e tij. 2. Personeli i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale i kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturve në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për Mitur. 3. Personeli i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale u kushton vëmendje të veçantë mbrojtjes së dinjitetit, nevojave fizike, sociale, profesionale, shëndetësore dhe psikologjike të të burgosurave.

Neni 15: Mospërdorimi i deklaratës së marrë nëpërmjet torturës si element prove në një proces

88. KPP-ja i ndryshuar¹⁹, parashikon: rregulla të përgjithshme mbi marrjen e provave: llojet e provave; mjetet e kërkimit të provës. Neni 149 – Kuptimi i provës (shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017). 1. Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. 2. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi

¹⁹ Ndryshuar dhe shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017.



mënyrën e marrjes së saj. Neni 150, parashikon se janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.

89. Neni 151 – Marrja e provave. 1. Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos menjëherë, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme. 3. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria e provave ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Neni 16: Parandalimi i veprimeve të tjera që përbëjnë dënime a trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, që nuk janë veprime torture

90. Siç është evidentuar më sipër Kodi Penal (i ndryshuar) parashikon një sërë veprash penale (ku përfshihen elemente apo përdorimin e akteve çnjerëzore e poshtëruese, me pasoje dëmtimin e shëndetit dhe jetës) me dënimet përkatëse.

91. Në Kodin Penal me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013 është parashikuar si vepër penale “Zhdukja me forcë” (109/c):

- Zhdukja me forcë, nëpërmjet arrestimit, burgimit, rrëmbimit ose çdo forme tjetër heqjeje lirie të personit, nga funksionarët publikë apo nga persona që veprojnë me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e tyre, shoqëruar me mospranimin e faktit të heqjes së lirisë apo me fshehjen e fatit të personit ose vendit në të cilin ndodhet ai, duke i mohuar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme, sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- Marrja e paligjshme e fëmijëve që janë subjekt i një zhdukjeje me forcë ose e fëmijëve, babai, nëna ose përfaqësuesi ligjor i të cilëve është bërë subjekt i një zhdukjeje me forcë apo e fëmijëve të lindur gjatë periudhës së zhdukjes me forcë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

- Kur kjo vepër kryhet kundër fëmijëve, grave shtatzëna ose personave që, për shkaqe të ndryshme, nuk mund të mbrohen, apo shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

- Kur kjo vepër ka sjellë si pasoje vdekjen e personit, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

92. Ndryshimet dhe shtesat e vazhdueshme në Kodin Penal²⁰ e parashikojnë dhunën në familje si vepër penale me sanksionet përkatëse (neni 130/a)²¹, si dhe kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale. Gjithashtu, ligji parashikon ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj vepre penale.

93. Në KP (neni 90), është parashikuar vepra penale “Dëmtime të tjera me dashje”:

- “Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë deri në 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”. Nga një vështrim i kësaj dispozite rezulton se ajo parashikohet si një vepër penale e lehtë, me subjekt aktiv të përgjithshëm. Pavarësisht se vepra penale, sipas kësaj dispozite, mund të bëhet objekt shqyrtimi nga gjykata vetëm me nismën e të dëmtuarit akuzues, përdorimi i rrahjes dhe çdo vepre tjetër dhune mund të jetë ushtruar në atë masë, formë, intensitet etj., sa që mund të cilësohet, eventualisht, si rrethana e anës objektive të figurës së veprës penale të torturës apo akteve çnjerëzore e poshtëruese, me pasoje dëmtimin e shëndetit dhe jetës.

- Vepra penale si “Shpërdorimi i detyrës”, “Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Përdorimi i dhunës gjatë hetimeve”, të parashikuara në kreun VIII, seksioni II, të Kodit Penal, ku trajtohen “Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, në dukje përmbajnë elementet që mund të kenë ngjashmëri me elementet e figurës së veprës penale të torturës apo akteve çnjerëzore e poshtëruese.

- Neni 248, KP: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin”.

- Neni 250, KP: “Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare, nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik

²⁰ Në vitet 2012, 2013 dhe 2020.

²¹ Informacion i detajuar jepet në vijim.



gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve”.

- Neni 314, KP: “Përdorimi i dhunës nga personi i ngarkuar me zhvillimin e hetimeve për ta detyruar shtetasin të bëjë deklaratë, të dëshmojë ose të pohojë pafajësinë e tij a të një tjetri”.

94. Në parashikimet specifike të nenit 8 “Mbrojtja nga diskriminimi, tortura, trajtimet çnjerëzore dhe poshtëruese”, të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar, personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë, si dhe asnjë person me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues. Gjithashtu, të gjitha aspektet lidhur me “kufizimin e lirisë” së një personi me çrregullime të shëndetit mendor, janë trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë ligj (dispozitat që lidhen me trajtimin dhe shtrimin e pavullnetshëm, si dhe kufizimin fizik) dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij (urdhër nr. 586, datë 30.10.2013 “Për miratimin e standardeve të kufizimit fizik në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër”, si dhe formularët e trajtimit të pavullnetshëm të miratuar me urdhër nr. 268, datë 23.4.2013). Në rastet e trajtimit dhe shtrimit të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor, legjislacioni shqiptar në këtë fushë ofron një mbrojtje të shtuar ligjore, duke parashikuar vlerësimin dhe vendimmarrjen për këto procedura nga gjykata kompetente.

95. Në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar, parashikohet monitorimi i jashtëm i shërbimit të shëndetit mendor, nga Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues. Ky organ me anë të inspektimeve periodike, vëzhgon respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

96. Shtesat dhe ndryshimet e fundit në ligjin e shëndetit mendor, miratuar me ligjin nr. 20/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ofrojnë mbrojtje të shtuar ligjore për personat me çrregullime të shëndetit mendor, referuar gjetjeve dhe rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës (CPT) të trajtuara në raportin e fundit të vendit të botuar në shtator 2019. Nëpërmjet amendimeve të fundit është siguruar diferencimi i konceptit dhe procedurave të trajtimit nga shtrimi, qoftë të një natyre të vullnetshme apo të pavullnetshme. Ndryshimet e fundit, gjithashtu, sigurojnë që edhe personat madhorë me çrregullime të shëndetit mendor, pa zotësi për të vepruar, të përfitojnë zbatimin e procedurave të trajtimit të pavullnetshëm me natyrë civile, me të njëjtat të drejta, si edhe personat me aftësi të plotë për të vepruar, pavarësisht pëlqimit/miratimit nga ana e kujdestarit të tyre ligjor.”

II. MASAT MBI ZBATIMIN E VËZHGIMEVE DHE REKOMANDIMEVE E KOMITETIT KUNDËR TORTURËS (KOMITETI CAT)

Rekomandimi 8. Përkufizimi dhe penalizimi i torturës

97. Siç është evidentuar në nenin 1, më sipër, Kodi Penal dhe kuadri ligjor parashikon dispozita mbi torturën, trajtimet çnjerëzore dhe degraduese. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur raste të hetuara dhe të gjykuara për veprën penale “Torturë” të parashikuar nga nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal. Nga të dhënat statistikore rezulton se, për veprën penale të “Torturës” parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal nuk janë regjistruar procedime penale. Mbi rastet e incidenteve të keq-trajtimeve nga punonjësit e zbatimit të ligjit, nuk ka pasur raste të keqtrajtimit apo ushtrimit të dhunës të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Rekomandimi 9. Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës

98. Në bazë të nenit 122 të Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Neni 116 i Kushtetutës, i cili përcakton hierarkinë e akteve normative me fuqi në territorin e RSH-së, i vendos marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara



pas Kushtetutës dhe mbi ligjet e vendit. Në këtë mënyrë, në rast konflikti ndërmjet një ligji dhe një marrëveshjeje ndërkombëtare, kjo e fundit ka gjithmonë epërsi.

Rekomandimi 10. Avokati i Popullit si një mekanizëm kombëtar parandalues

99. Me miratimin e ligjit nr. 9094, datë 3.7.2003 “Për ratifikimin e protokollit opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, rrodhi detyrimi për të krijuar një strukturë kombëtare për parandalimin e torturës, funksioni i së cilës iu besua Avokatit të Popullit.

100. Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të Kushtetutës së RSH-së dhe ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ushtron mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të paracaktuara nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë në fokus mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në zbatim të këtij ligji, anëtarët e Mekanizmit Kombëtar, si persona të autorizuar nga Avokati i Popullit, “kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

101. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ashtu si edhe ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, parashikon: krijimin dhe funksionimin e Mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (Mekanizmi kombëtar); i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit. Sipas nenit 81, në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca: a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, paraburgimit dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura,

trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues; b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

102. Neni 82 – Mekanizmit kombëtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij i garantohet: a) marrja e çdo informacioni për numrin e individëve që u është hequr liria në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre; b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit; c) aksesin në të gjithë dokumentacionin që mbahet dhe administrohet nga institucioni në përputhje me funksionet e kryera prej tij, sipas legjislacionit në fuqi; ç) hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit, pa njoftimin paraprak. d) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët të cilëve u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm; dh) zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitojë dhe e individëve që kërkon të intervistojë.

103. Neni 83 – 1. Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet: a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të burgosurit, ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë dhe organizatat të cilat e ushtrojnë këtë të drejtë, pasi të jetë dhënë pëlqimi paraprak nga ana e të burgosurit; b) marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të burgosurit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit, ose të organeve shtetërore, ose organizatave jofitimprurëse, të cilat kanë kontrolluar ose vizituar institucionin sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga mbrojtësi i të burgosurit; c) kërkimit të informacioneve nga personeli i institucionit; ç) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të burgosurin, brenda dhe jashtë institucionit. 2. Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, mekanizmi kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe, pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrit të vërejtjeve.



104. Sipas ligjit nr. 44/ 2012, datë 8.5.2012 “Për shëndetin mendor”, neni 31, “Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, vëzhgon rregullisht, me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.

105. Avokati i Popullit si MKPT, gjatë veprimtarisë së tij në vite, ka pasur një akses të rregullt dhe të pa kufizuar në kohë në të gjitha vendet e vuajtjes së dënimit, ka kryer vizita për këqyrjen e vendit të abuzimit, pa miratimin paraprak të autoriteteve respektive për zhvillimin e vizitës me përjashtim të dy rasteve të ilustruara më poshtë. Gjatë periudhës raportuese janë kryer një sërë inspektimesh, kontrole dhe vizita monitoruese në të gjitha institucionet ku privohet liria e individit (institucionet e vuajtjes së dënimit komisariatet e policisë, psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut) në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Rekomandimi 12. Mbi statusin e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e rekomandimeve të këtij institucioni për përmirësimin e kushteve të ambienteve për të ndaluarit/arrestuarit në polici

106. Ka një vazhdimësi të masave për njohjen e statusit dhe të kompetencave që ka Institucioni i Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, duke bërë të njohur personelit policor përmbajtjen e këtij ligji dhe sjellë në vëmendjen:

- Pritjen dhe lejimin e hyrjes dhe kryerjen e vizitave në ambientet e policisë (dhomat e shoqërimit dhe ato të sigurisë) nga ana e ndihmës komisionerëve të Avokatit të Popullit, në çdo kohë;

- Krijimin e kushteve dhe të lehtësirave në kryerjen e inspektimeve dhe vizitave monitoruese të ndihmës komisionerëve të Avokatit të Popullit; eliminimin e zvarritjeve apo vonesave në këtë drejtim; vënien në dispozicion të personelit policor dhe të dokumentacionit përkatës që administrohet

për mbajtjen e trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar; kryerjen e intervistave me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në kushte privatësie nga ekspertët/përfaqësuesit e Avokatit të Popullit; njohjen e raporteve të monitorimeve dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, si dhe kthimin e përgjigjeve brenda afateve ligjore etj.

107. Avokati i Popullit në mënyrë të vazhdueshme dhe të përvitshme ka kryer inspektime dhe vizita monitoruese në njësitë vendore të policisë (drejtori/komisariat dhe stacion policie) për të parë nga afër kushtet e ambienteve ku mbahen e trajtohen kjo kategori personash; trajtimi që ju bëhet nga personeli policor; masat e marra për respektimin dhe garantimin e të drejtave ligjore të tyre; zbatimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme etj. Nga ana e Avokatit të Popullit janë hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit raportet me gjetjet/konstatimet përkatëse dhe rekomandimet me masat përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe eliminimin e mangësive në drejtim të trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë. Avokati i Popullit ka hartuar rekomandime për përmirësimin e kushteve të ambienteve të dhomave të shoqërimit dhe atyre të sigurisë për të ndaluarit/arrestuarit, në drejtoritë dhe komisariatet e policisë.

108. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) mban një dialog konstruktiv me Kuvendin e Shqipërisë dhe autoritetet shtetërore, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e përpiluara nga ana e saj pas inspektimeve në vendet e privimit të shtetasve nga liria. MKPT-ja bën publike dhe përdor tërësisht e pavarur dhe e pa penguar, mjetet e komunikimit publik për të zbatuar efektivisht misionin e saj dhe për të rritur ndërgjegjen publike lidhur me rekomandimet. Veprimtaria e tij ka pasur rritje cilësore në parandalimin e shkeljeve, promovimin e praktikave të mira, rritjen e transparencës dhe forcimin e dialogut me autoritetet shtetërore.

109. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin me nr. 155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, ‘Për Avokatin e Popullit’, të ndryshuar”. Ky ligj ka sjellë ndryshime në ndjekjen dhe zbatimin të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në rastin e raporteve vjetore, ashtu edhe ato të veçanta. Gjithashtu, një ndër



risitë që solli miratimi i këtij ligji është edhe krijimi i Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, si një seksion i veçantë i Zyrës së Avokatit të Popullit. Ngritja në nivel seksioni i Mekanizmit (MKPT) garanton pavarësinë e tij, si dhe mundëson pajisjen me burimet e nevojshme për të ushtruar funksionet e tij. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, në të cilën janë përfshirë edhe sugjerimet e Avokatit të Popullit.

Rekomandimi 12(d). Roli i AP-së mbi promovimin e të drejtave të njeriut me qëllim përmirësimin e sigurisë, kushteve të jetesës dhe trajtimin e të dënuarve

110. Institucioni i Avokatit të Popullit ka akses të pakushtëzuar për të kryer monitorimet në sistemin e burgjeve, si dhe akses në dokumentacion në çdo kohë dhe pa nevojën e një njoftimi apo konfirmimi paraprak. Një ndër prioritetet që ka Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) është forcimi i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, duke implementuar rekomandimet, si dhe duke përditësuar Planin e Veprimit për Sistemin e Burgjeve. Si pjesë e procesit të menaxhimit të statistikave mbi bashkëpunimin me Avokatin e Popullit, një databazë administrohet nga DPB-ja mbi vizitat monitoruese të kryera nga Avokati i Popullit, numrin dhe përqindjen e rekomandimeve të lëna dhe rezultatet e trajtimit të tyre.

Garancitë për liritë themelore

Rekomandimi 13(a). Informimi i personave të ndaluar nga policia mbi të drejtat e tyre themelore

111. Me ndryshimet e bëra në vitin 2017, në Kodin e Procedurës Penale, (nenet 34/a, 34/b, 38) është parashikuar njoftimi i menjëhershëm i personave të arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara në këtë Kod, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit “letren e të drejtave” në formë të shkruar, të cilën personi ka të drejtë ta mbajë me vete.

112. Edhe para ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, Policia e Shtetit ka hartuar e përgatitur një format të shkruar me të drejtat e personave të arrestuar/ndaluar: “Deklarata e të drejtave”, i cili përveç sa i bëhet i ditur personit që

në momentet e para të arrestimit/ndalimit i jepet që ta nënshkruajë duke pasqyruar datën dhe orën e njohjes. Deklarata të drejtave nënshkruhet nga personi i arrestuar/ndaluar në dy kopje të saj dhe një kopje i jepet personit që ta mbajë me vete, ndërsa kopja tjetër administrohet nga personeli përgjegjës i dhomave të sigurisë. Deklarata e të drejtave për të arrestuarit/ndaluarit është prodhuar në disa gjuhë të huaja dhe u janë shpërndarë gjithë strukturave vendore të policisë për vënien në përdorim të tyre ndaj personave të arrestuar/ndaluar të huaj dhe sipas gjuhës që ata kuptojnë²². Pjesë e procedurave dhe rregullave për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, (miratuar me urdhrin nr. 925, datë 18.7.2019, të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit), është dhe detyrimi i personelit policor për njohjen/dhënien e informacionit për të arrestuarit/ndaluarit mbi të drejtat e tyre.

113. Oficerët e Policisë Gjyqësore, specialistët e ndihmësspecialistët dhe policisë menjëherë në momentin e parë të ndalimit dhe arrestimit realizojnë komunikimin verbal dhe bërjen të ditur ndaj të ndaluarit/arrestuarit të të drejtave ligjore, si:

- Njohja me shkallën/arsyen e ndalimit/arrestimit; e drejta për të pasur mbrojtje me avokat mbrojtës; e drejta për të përfutur shërbim mjekësor gjatë qëndrimit në ambientet e policisë; e drejta për të njoftuar një anëtar të familjes apo një person tjetër të zgjedhur prej tij; e drejta të bëjë/paraqesë kërkesë/ankesa për trajtimin që kryhet nga personeli policor; e drejta për trajtim humanitar, njerëzor dhe me dinjitet; e drejta për t'u trajtuar me ushqim tri herë në ditë etj.

- Deklarata tip të drejtave të personave të privuar nga liria, njohja e të drejtave për këtë kategori nëpërmjet një në të cilën janë pasqyruar të gjitha të drejtat kushtetuese dhe ligjore që kanë. Menjëherë pas ndalimit/arrestimit dhe para se personi të vendoset në ambientet e sigurisë i jepet një kopje e “deklaratës tip” dhe pasi njihet me të ai nënshkruan për njohjen e saj.

Rekomandimi 13 (b). Trajnimi i nëpunësit të policisë mbi detyrimet ligjore që garantojnë akses për avokat dhe mjek njoftimin e

²² Deklarata e të drejtave në gjuhën angleze, franceze italiane, gjermane, slovene, serbe, greke, rumune dhe rome.

**pjesëtarëve të familjes mbi vendin e ndalimit ose burgimit**

114. Policia e Shtetit në vazhdimësi ka marrë masa për ndalimin e rreptë të torturës, keqtrajtimit, që mund të shkaktohen nga personeli policor gjatë veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë, si dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore vetëm në bazë të ligjit duke respektuar të drejtat e njeriut.

Janë marrë masa për respektimin dhe garantimin e të drejtave të të ndaluarve/arrestuarve:

- Respektimi dhe garantimi në praktikë i së drejtës për të pasur dhe mbrojtur me avokat mbrojtës që në momentet e para të privimit të lirisë, për këtë shërbimet e policisë gjyqësore marrin masa për njoftimin/sigurimin e mbrojtësit ligjor të zgjedhur nga i arrestuari/ndaluar dhe për ata që s'kanë mjete financiare sigurojnë avokat mbrojtës kryesisht të caktuar nga prokurori, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale;

- Dhënia për personat e ndaluar/arrestuar e kopjes së formatit/deklaratës të shkruar me të drejtat që u njeh ligji në këtë fazë këtyre personave;

- Avokatit mbrojtës i garantohet e drejta për të marrë kontakt me klientin e tij në çdo kohë dhe pa prezencën e personave të tjerë;

Në ambientet e dhomave të sigurisë janë të afishuara listat emërore të avokatëve mbrojtës dhe numrat e kontakteve të tyre;

- Nga policia gjyqësore, zbatohet rregullisht njoftimi i një anëtarit të familjes të personit të ndaluar/arrestuar lidhur me masën e marrë dhe vendndodhjen aktuale të personit;

- Personeli mjekësor i policisë ka detyrimin që të kryejë vizitat mjekësore ndaj të arrestuarve/ndaluarve menjëherë pas marrjes së këtyre masave dhe jo më vonë se 12 orë nga arrestimi/ndalimi, të cilat pasqyrohen në dokumentin mjekësor/kartelën mjekësore;

- Rregullat e kryerjes së vizitave mjekësore janë përcaktuar në procedurën standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, trajtimi dhe zgjidhja e kërkesë ankesave të tyre”, miratuar me urdhrin nr. 925, datë 18.7.2019, të DPP-së së Shtetit.

Rekomandimi 13/c. Dërgimi i personave të ndaluar nga policia para gjyqtarit brenda afatit kohor

115. Policia gjyqësore, pas kryerjes së arrestimit/ndalimit kryen referimin e materialeve procedurale në organin e prokurorisë brenda 24 orëve nga kryerja e arrestimit/ndalimit dhe më pas prokurori brenda 48 orëve nga arrestimi/ndalimi paraqet kërkesën në gjykatë për shqyrtimin, vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurisë për personin e arrestuar/ndaluar. Gjykata brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit zhvillon seancën gjyqësore për vlerësimin dhe caktimin e masës së sigurimit personal.

Rekomandimi 14. Dhuna ndaj grave; dhuna ndaj fëmijëve

116. Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, parashikon forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesë. Ligji u ndryshua edhe në tetor 2020, duke saktësuar masat për largimin e dhunuesit nga banesa dhe kthimin me mbarimin e afatit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes UM/UMM, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesin, regjistrin e UMM/UM-ve etj.

117. Ndryshimet dhe shtesat e vazhdueshme në Kodin Penal²³ e parashikojnë dhunën në familje si vepër penale me sanksionet përkatëse (neni 130/a)²⁴:

- rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt, krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet;

²³ Në vitet 2012, 2013 dhe 2020.

²⁴ Informacion i detajuar jepet në vijim.



- kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasoje cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet;

- plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet;

- gjithashtu, është cilësuar se në rast se këto vepra do të kryhen në mënyrë të përsëritur ose në praninë e fëmijëve, dënimi ashpërsohet nga një deri në pesë vjet burgim.

118. Në vitin 2013, u ndryshua neni 102 “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”: neni 102: Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura: kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasoje vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

119. Institucioni i prokurorisë ka synuar në vazhdimësi të sigurojë qasje dhe mbështetje të viktimave, veçanërisht ato të dhunës seksuale, trafikimit apo dhunës në familje. Në muajin janar 2016, në Prokurorinë e Përgjithshme u krijua Zyra e Ndihmës të Viktimave e parashikuar dhe në ligjin nr. 97/2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH-së”. Në këtë ligj (neni 68) është parashikuar detyrimi i prokurorisë për të garantuar shërbime të nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe për këtë në çdo prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën një koordinator të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

120. Aktualisht, në zbatim të këtij ligji në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së

parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme ushtrojnë funksionet koordinatorët e viktimave, të cilëve pas marrjes së detyrës iu siguroa edhe trajnimi fillestar. Nga ana tjetër, në përputhje dhe në zbatim të parashikimeve ligjore, Prokurori i Përgjithshëm më datë 25.10.2018 ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm, nr. 5/2018, që synon të sigurojë kuptimin dhe zbatimin në mënyrë të unifikuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që lidhen me viktimat e veprave penale dhe nga ana tjetër të përcaktojë politikat e Prokurorisë në lidhje me trajnimet e tyre. Udhëzimi shoqërohet edhe nga disa shtojca që janë modele të unifikuara aktesh të nevojshme në zbatim të udhëzimit dhe punës së prokurorëve. Po kështu u miratua edhe një broshurë informative për viktimat e krimit, që është shpërndarë në prokuroritë e shkallës së parë dhe është publikuar dhe në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

121. Ligj nr. 47, datë 23.7.2018²⁵, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, të ndryshuar, synon:

- parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

- përmirësimin e masave mbrojtëse të parashikuara në ligj në kuadrin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrin të mbrojtjes, duke pasur parasysh sidomos përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët;

- rritjen e ndihmës së kualifikuar gjyqësore falas;

- përcaktimi i afateve të qarta procedurale, për regjistrimin e kërkesës për urdhrë mbrojtje (UM) dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM), si dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore;

- përcaktimi më i qartë i organeve përgjegjëse për kryerjen e detyrave dhe i përgjegjësisë së zyrtarëve;

- parashikimi shprehimisht i detyrimit të organeve shtetërore për të ofruar falas, çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje;

- rritja e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, droguar ose me çrregullime të shëndetit mendor, të dhëna

²⁵ Hyrë në fuqi, më 18.8.2018.



qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

122. Në zbatim të ligjit nr. 47, janë miratuar:

- udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018 i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”;

- dokumenti i standardeve të shërbimit për “Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”, me fokus kryesor shërbimin emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë), për viktimat/ të mbijetuarit/rat e dhunës seksuale, si dhe për anëtarët e tjerë të familjeve të tyre, u përgatit me qëllim funksionimin sa më eficient të këtyre qendrave;

- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;

- udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”.

123. Mekanizmat e koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ofrojnë qasje të integruar të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës dhe siguron mbrojtje dhe mbështetje për to në nivel vendor dhe shtrirje të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe ngritjes së shërbimeve të reja specifike. Nën koordinimin e MSHMS-së dhe me mbështetjen e UNDP-së, janë ngritur dhe funksionojnë 57 mekanizma të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje, nga 61 bashki të vendit. Ka vazhduar ngritja e kapaciteteve të koordinatorëve vendore kundër dhunës në familje dhe të ekipeve teknike multidisiplinare.

124. Qeveria mbështet një strehëz të specializuar kombëtare, si dhe mbështet tri strehëza të specializuara të drejtuara nga OJF-të. Qendrat që trajtojnë viktimat e trafikimit ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit VT/VMT, të huaj ose vendës, fëmijë, burra ose gra. Këto strehëza kanë trajnuar stafin për të siguruar sigurinë e viktimave. Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat dhe viktimat e

mundshme të trafikimit ofron një gamë të gjerë ndihme, si veshje ushqimore, ndihmë mjekësore, ndihmë juridike, ndihmë psikologjike, kujdes shëndetësor, rehabilitim dhe programe profesionale. Shërbimi është 24 orë në ditë dhe vendoset në një strukturë të lartë sigurie. Mbrojtja sociale sigurohet bashkërisht nga objektet shtetërore dhe institucionet joqeveritare të cilat mbulojnë një gamë më të gjerë të nevojave dhe balancojnë kapacitetet e njëri-tjetrit.

125. Qendra e parë për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale – LILIUM (dhjetor 2018) ofron modelin socio-shëndetësor, me një ekip multidisiplinar me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë, do të japë shërbim të specializuar sipas standardeve 24 orë çdo ditë të javës. Që nga hapja e saj kanë marrë shërbime rreth 58 viktima të dhunës seksuale. Janë ngritur në disa bashki të vendit strehëzat emergjente. Janë organizuar fushatat e ndërgjegjësimit kundër dhunës ndaj grave. Funksionon Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza 116–117, prej vitit 2017.

Ndihma juridike falas

126. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka hyrë në fuqi, më datë 1.6.2018, dhe qëllimi i tij, është krijimi i një sistemi ligjor, të konsoliduar, lidhur me ofrimin e ndihmës juridike falas, për të gjithë individët në sistemin e drejtësisë, dhe garantimi i aksesit të barabartë, si dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

127. Përfituesit e aksesit në drejtësi, sipas ligjit nr. 111/2017, janë viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal, viktimat e mitura dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal, si dhe kategoritë e tjera përfituese në kuadër të nenit 11, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky ligj ka përforcuar aksesin në drejtësi, duke i dhënë mundësi ligjore të gjitha kategorive përfituese, në kuadër të nenit 11, të përfitojnë ndihmë juridike, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, të cilët janë:

- viktimat e dhunës në familje;



- viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

- viktimat e mitura dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;

- fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

- fëmijët të cilët gjenden nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

- personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;

- personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

- personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

- personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

- personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi”.

128. Ligji nr. 121 / 2016 “Për shërbimet sociale”, përcakton shërbime të specializuara për të gjitha kategoritë, si: fëmijë në konflikt me ligjin, persona me aftësi të kufizuara, gra dhe vajza të abuzuara, abuzuara ose trafikuar dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla. Ofron shërbime të barabarta për të dyja palët si viktimat e mundshme (të supozuara) dhe të njohura zyrtarisht. Të dyja si viktimat e mundshme/ viktimat e trafikimit kanë qasje në shërbimet e kujdesit shoqëror. Sa i takon ndihmës juridike falas, përkufizime ligjore për personat që

përfitojnë ndihmë juridike falas janë ata persona që janë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale ose plotësojnë kushtet për t’u përfshirë, si dhe rastet që janë viktimat të dhunës në familje ose viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.

129. Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”, parashikon, ndër të tjera, shtimin e diskriminimit të shumëfishtë, diskriminimin ndërsektorial, gjuhën e urrejtjes, segregimin, ngacmimin seksual etj.

Të drejtat e fëmijëve

130. Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur” (i miratuar më datë 30.3.2017, hyri në fuqi më 1 janar 2018). Qëllimi i këtij Kodi është të garantojë një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, të promovojë riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin penal, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe të parandalojë riviktimizimin dhe viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale. Ligji përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç.

131. Në zbatim të këtij Kodi janë miratuar:

- Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018–2028 dhe Plani i saj i Veprimit është miratuar nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 541, datë 19.9.2018.

- Miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 37/2017. “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” është e finalizuar dhe e miratuar dhe tashmë ka filluar zbatimin i tyre nga institucionet ligjzbatuese.

- Janë miratuar 6 vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime, si dhe një projektvendim, duke garantuar në këtë drejtim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

132. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton qartë se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar se cilat janë “masat e mbrojtjes” që mund të aplikojnë punonjësit kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit,



neglizhimit apo shfrytëzimit. Ligji për herë të parë parashikon mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge në kuadër të mbrojtjes që i garantohet fëmijëve që punojnë dhe shfrytëzohen për punë, adresimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve siç është bulizmi, dhuna në shkollë, dhuna në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik dhe fëmijët në situatë rruge, siguria e fëmijëve në mjedisin digjital, fëmijët e pashoqëruar ose viktimë të trafikimit etj.

133. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në nenin 65, përcakton se strukturat e mbrojtjes së fëmijës marrin masa të menjëhershme për vlerësimin e rastit të fëmijës që dyshohet apo ka kryer vepra penale, i cili është nën moshën për përgjegjësi penale, duke angazhuar njësinë e vlerësimit dhe të referimit të rasteve, si dhe grupin teknik ndërsektorial për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, i cili përmban një nga masat e mbrojtjes të parashikuara në këtë ligj, si dhe ndërhyrjet e shërbimet e tjera të nevojshme për riintegrimin e tij. VKM-ja nr. 635, datë 26.10.2018 “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën për përgjegjësi penale, që dyshohet apo ka kryer veprë penale”, rregullon veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, për trajtimin e fëmijës, që është nën moshën për përgjegjësi penale dhe që dyshohet apo ka kryer një veprë penale.

134. Ligji nr. 18/2017 parashikon detyrat dhe forcon institucionet, strukturat dhe mekanizmat që do të garantojnë dhe do të sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja dhe shteti dhe forcon sistemin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, duke përfshirë edhe nivelin vendor në veçanti. Ky ligj qartëson masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë rreziku për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Ligji parashikon si masë mbrojtje mbikëqyrjen e specializuar të fëmijës në mjedisin familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

135. Ligji, përveç masave të mbrojtjes, parashikon edhe mbrojtjen e posaçme për kategori të caktuara fëmijësh, më konkretisht atyre të

abuzuar, dhunuar, neglizhuar, fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve të cilët akuzohen se kanë kryer vepra penale, por janë nën moshën e përgjegjësisë penale

136. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020 synoi përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve, duke synuar përfundimin e kuadrit ligjor dhe institucional, përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve dhe një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve.

Rekomandimi 15. Trafikimi i personave

137. Legjislacioni penal shqiptar penalizon trafikimin e personave. Ndryshimet në vitin 2017 në “Kodin e Procedurës Penale”, i ndryshuar, synojnë arritjet e standardeve më të mira të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtare. Njëpërmjet këtyre ndryshimeve janë përmirësuar ndjeshëm të drejtat dhe pozita e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

138. Ligji procedural penal ka pësuar ndryshime të konsiderueshme lidhur me kompetencën lëndore të hetimit dhe gjykimit të këtyre veprave, si dhe duke garantuar një rol me aktiv dhe të drejta të rëndësishme të viktimës në procesin penal. Me ndryshimet e reja ligjore, kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale për këto vepra janë prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe për gjykimin, gjykatat e rretheve gjyqësore. Në rastet kur këto vepra kryhen në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal apo organizate kriminale, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurave Penal (neni 75/a), kompetente për hetimin e tyre është Prokuroria e Posaçme dhe gjykimi është në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

139. Organi i prokurorisë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme të drejtave të viktimës së trafikimit, ku janë marrë parasysh elementet, që kanë të bëjnë me krijimin e kushteve të përshtatshme për marrjen në pyetje të viktimës së trafikimit, duke siguruar praninë e punonjësit social apo psikologut, akomodimin e viktimës në qendrat pritëse ku përfitojnë strehim, ushqim dhe shërbime të tjera falas etj.



140. Në praktikën tonë, nuk janë penalizuar viktimat e trafikimit për krime që ato kanë bërë si pasojë e trafikimit (falsifikim dokumentesh, ushtrim prostitucioni etj.), pasi nuk mund të penalizohet viktimat për vepra të kryera si rezultat i të qenit viktimë e trafikimit. Nga ana tjetër, ato kanë të drejtë të gjejnë mbështetjen e prokurorisë për futjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nëse ndihen të kërcënuar.

141. Në kuadër të parandalimit dhe goditjes së fenomenit të trafikimit të personave, veprimet antitrafikim janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e kuadrit ligjor, rivitalizimin dhe forcimin e strukturave kombëtare; në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel qendror dhe lokal; kontrollin e trafikimit të brendshëm, kryesisht të fëmijëve dhe grave; përmirësimin e standardeve të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave; intensifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe atë të personelit që punon me shërbimet e ndihmës.

142. Ligji nr. 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës’”, parashikon se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet e Kodit Penal të “Trafikimit të personave të rritur” dhe “Trafikimit të të miturve”. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar. Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit (neni 37/2-c). Neni 37/3-b parashikon që nga ky fond përfitojnë edhe OJQ-të, duke përfshirë edhe strehëzat.

143. Masat në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

- Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014–2017, miratuar me VKM-në nr. 814, datë 26.11.2014.

- Plani i Veprimit për Riintegrimin Social – Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit (VKM-ja nr. 115, datë 17.2.2016).

- Plani Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020, miratuar me VKM-në nr. 770, datë 26.12.2018.

- Aktivitetet e parashikuara synuan:

- përmirësimin e funksionimit të një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrimin të viktimave të trafikimit;

- rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik lidhur me legjislacionin kombëtar e konventat ndërkombëtare antitrafikim, me të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, fëmijët në situatë rruge etj.), si dhe pasojat e tij.

- Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit (PSV), miratuar me VKM-në nr. 499, datë 29.8.2018. PSV-të janë dokumenti bazë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi është mbrojtja, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjitha llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

- Funksionimin efikas të “Mekanizmit Kombëtar të Referimit”, si dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie dhe komune (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të.

- Përmirësimi i bazës së të dhënave për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve.

- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të punonjësve të policisë së strukturave vendore antitrafikim, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme, në veçanti rreth zbatimit të “Procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, si dhe mbi teknikat proaktive të hetimit të veprave penale të trafikimit të personave.

- Për sa u përket rasteve fëmijë-viktima trafikimi ose viktima të mundshme trafikimi, të identifikuar në rrezik të lartë dhe menjëhershëm, janë të ngritura dhe funksionojnë dy qendra kombëtare të cilat ofrojnë shërbimin emergjent deri në vendimin



e grupit teknik ndërsektorial nëse fëmija do të vendoset në përkujdesje alternative apo do të kthehet në familje.

Rekomandimi 16. Paraburgimi – Hetimi i të gjitha rasteve të torturës dhe keqtrajtimit në paraburgim dhe garantimi i viktimave të tyre në akses për drejtësi dhe mjete efektive për dëmshpërblim

144. Kodi i Procedurës Penale (i ndryshuar) parashikon dispozita të detajuara mbi: procedurat, afatet e përfundimit të hetimeve: kushtet e procedimit; gjykimin; akuzat; marrja e vendimit; vendimi i dënimit.

145. Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve” (i ndryshuar me ligjin nr. 40/2014), ka pasur parashikime mbi trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarit duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Ligji ka pasur si qëllim rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Trajtimi i të paraburgosurve dhe i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, si dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

146. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” garanton kushtet për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

147. Ky ligj (neni 89 “Të drejtat e të paraburgosurve”) parashikon: 1. Personat e paraburgosur, që ndodhen në institucionet e paraburgimit ose seksionet e paraburgimit, gëzojnë të drejtat e përcaktuara nga ky ligj. 2. Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për arrestimin dhe për vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me anëtarët e familjes. Të paraburgosurit e huaj lejohen të informojnë përfaqësinë konsullore ose diplomatike të vendit të tyre.

148. Ligji (neni 90 “Ndihma juridike”) parashikon: 1. Të paraburgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfutur ndihmë juridike të garantuar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose kur nuk kanë mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, në përputhje

me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. 2. Mjediset ku mbahen të paraburgosurit duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen privatisht dhe të komunikojnë me mbrojtësit dhe të kenë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen gjatë gjithë gjykimin. 3. Të paraburgosurit të mitur i garantohet ndihmë juridike dhe psikologjike, si dhe ushtrimi i të gjitha të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

149. Policia e Shtetit ka marrë masa dhe garanton të drejtën e personave të ndaluar/arrestuar për të marrë informacion mbi të drejtat e tyre dhe në veçanti për realizimin praktik të së drejtës për t’u mbrojtur me avokat, si:

- afishimin në ambientet e drejtorive/komisariateve dhe stacioneve të policisë të posterave me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, ku pjesë e këtyre të drejtave është dhe ajo për t’u mbrojtur me avokat;

- dhënia për personat e ndaluar/arrestuar e kopjes së formatit/deklaratës të shkruar me të drejtat që u njeh ligji në këtë fazë këtyre personave;

- afishimi në ambientet e policisë, dhomat e shoqërimit dhe në dhomat e sigurisë të listave emërore të avokatëve mbrojtës që ushtrojnë aktivitetet në juridiksionin që mbulon njësi policore, si dhe të numrave të kontakteve të tyre;

- komunikimi verbal që kryhet ndaj këtyre personave nga policia gjyqësore lidhur me të drejtat që gëzojnë.

150. Gjithashtu, në vijimësi janë përgatitur akte administrative (urdhra, letërporosi, tërheqje vëmendje) të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit apo drejtorëve të departamenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku strukturave vendore të policisë dhe personelit policor i është kërkuar marrja e masave, për:

- njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.

151. Përmes mekanizmit të kërkesës dhe ankesës është krijuar akses nga administrata e burgjeve që të dënuarit dhe të paraburgosurit të adresojnë ankesat e tyre në lidhje me të drejtat dhe trajtimin në sistemin e burgjeve, duke ruajtur konfidencialitetin në çdo rast. Protokollin e mekanizmit të kërkesës dhe ankesës përmban formatet përkatëse referuese të drejtimit të një



ankese (apo kërkesë) pranë organeve kompetente, duke përfshirë edhe formatin përmes së cilës ankesa mund t'i drejtohet Institucionit të Avokatit të Popullit. Përdorimi i këtyre formateve nuk është detyrues, por orientues për të dënuarin/të paraburgosurin mbi mënyrën se si ai/ajo mund të drejtojë një ankese, organet/institucionet ku mund të drejtohet, si dhe afatet zyrtare të cilat organet/institucionet duhet të respektojnë për kthimin e përgjigjes të burgosurit.

Rekomandimi 17. Ndalimi administrativ

152. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit (neni 16/25): “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji. Janë parashikuar rastet kur personi shoqërohet, koha e mbajtjes si i shoqëruar, të drejtat që kanë kjo kategori personash gjatë qëndrimit në ambientet e policisë (dhe jo vetëm), si dhe detyrimet për personelin policor, si:

- trajtimi i të shoqëruarve të bëhet në kushte të ndryshme dhe jo të njëjlojta si personat e ndaluar/arrestuar;

- në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë;

- i shoqëruari ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit;

- të njoftohet i shoqëruari se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë;

- i shoqëruari ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin;

- personat e shoqëruar kanë të drejtë që t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë;

- dokumentimi nga punonjësi i policisë në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

153. Gjatë periudhës së mbajtjes dhe trajtimit të personave deri në 10 orë, nga ana e policisë gjyqësore/specialistët dhe ndihmësspecialistët e policisë kryhen veprime policore dhe procedurale për verifikimin e sqarimin e rrethanave të çështjes/arsyes për të cilën është shoqëruar personi dhe në përfundim të saj vendoset nëse personi do

të arrestohet/ndalohet apo ndiqet në gjendje të lirë. Koha e qëndrimit/mbajtjes si të shoqëruar për personat e ndaluar/arrestuar llogaritet në kohën e ndalimit/arrestimit dhe për këtë në procesverbalet përkatëse si kohë të ndalimit/arrestimit pasqyrohet ora e shoqërimit (ora faktike kur i është privuar liria) dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimi 18. Moskthimi

154. Ligji “Për të huajt” (i ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, datë 14.7.2016 dhe ligjin nr. 13/2020) përcakton kategorinë e personave që nuk dëbohen, duke përcaktuar shprehimisht mosdëbimin kur ka arsye të bazuara për të dyshuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese. Gjithashtu i mituri i pashoqëruar, nëse nga vendi i origjinës, një vend tjetër ose nga institucione të tjera nuk garantohet ribashkimi familjar ose kujdesi i duhur shëndetësor (neni 113). Përrjashtimisht, i huaji mund të dëbohet, megjithëse plotësohen kushtet e përmendura në nenin 113 neni, nëse qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë publike, si dhe përbën kërcënim për sigurinë kombëtare, sipas përcaktimeve të ligjit.

155. Ligji nr. 10/2021 “Për azilin në RSH-së” (neni 11) lidhur me “moskthimin parashikon: 1. Kërkuesi, refugjati, personi me statusin e mbrojtjes plotësuese dhe mbrojtje të përkohshme nuk dëbohet, kthehet apo ekstradohet jashtë territorit të RSH-së:

- a) në një shtet ku jeta ose liria e tij kërcënohet për shkak të racës, të besimit, të kombësisë, të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;

- b) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet torturës ose ndëshkimit çnjerëzor e degradues apo çdo trajtimi tjetër të parashikuar në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore dhe Lirive të Njeriut, të interpretuar nga Gjykata Evropiane apo në marrëveshjet/konventat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;

- c) në një shtet ku ka arsye të besueshme se mund të jetë në rrezik t'i nënshtrohet zhdukjes me forcë;

- ç) në shtetin e tij të origjinës, në rast se të huajve u është dhënë një nga format e mbrojtjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji; d) në një shtet



të tretë, i cili mund ta kthejë ose ta dërgojë personin në një nga shtetet, sipas përcaktimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike.

Rekomandimi 19. Garancitë diplomatike

156. Në nenin 126, të ligjit nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, përcaktohen garancitë diplomatike për të huajt:

- Vënia në dijeni e përfaqësuesit diplomatik: Me kërkesën e të huajt, ose kur përcaktohet nga një marrëveshje dypalëshe, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme njoftohet menjëherë misioni diplomatik apo konsullor i shtetit të të huajt të ndaluar në qendër, për ndalimin e tij, si dhe për zgjatjen e periudhës së ndalimit.

Në rast se i huaji ka kërkuar azil ose gëzon statusin e refugjatit apo një mbrojtje tjetër nga RSH-së, ky informacion nuk i bëhet i ditur përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të vendit të tij.

Rekomandimi 20. Mundësi për mjete ankimi në ambientet e policisë

157. Në nenin 115, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar është përcaktuar: e drejta për të paraqitur kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore nga çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër lidhur me sjelljen/qëndrimin dhe veprimet e policisë, si dhe detyrimin e policisë për të evidentuar/regjistruar, trajtuar, zgjidhur dhe kthyer përgjigje ankuesit/kërkuesit. Janë sanksionuar:

- e drejta për të paraqitur ankesë/kërkesa nga personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuarit në ambientet e policisë, si dhe çdo shtetas tjetër që cenohet nga veprimet e qëndrimit e policisë;

- mënyrat e bërjes së ankesave me gojë ose me shkrim;

- institucionet se ku drejtohen ankesë/kërkesat, si: drejtuesve të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore;

- të drejtën për personat e shoqëruar që t'i drejtohen gjykatës në çdo kohë;

- detyrimin e policisë për të evidentuar e trajtuar ankesë /kërkesat e paraqitura;

- afatet e trajtimit të ankesë/kërkesave dhe kthimit të përgjigjeve për ankuesit: nëse ankesa i drejtohet drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari apo i ndaluari, përgjigja duhet të jepet menjëherë,por jo më vonë se 5 ditë.

158. Është hartuar dhe vënë në zbatim procedura standarde e punës për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e policisë dhe zgjidhja e ankesë/kërkesave të tyre. Pjesë përbërëse e procedurës standarde për trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar janë dhe rregullat për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ ankesave që bëhen nga personat e shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar (urdhri nr. 440/3, datë 27.4.2017 “Për miratimin e procedurës standarde të punës”: trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”).

159. Regjistri për evidentimin, trajtimin dhe zgjidhjen e ankesë/kërkesave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit, i cili administrohet nga të gjitha njësitë policore. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluari apo i arrestuari, përgjigja i jepet menjëherë,por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre.

160. Janë prodhuar dhe afishuar në ambientet e drejtorive dhe komisariateve të policisë, ambientet e dhomave të shoqërimit dhe ato të ndalim/arrestimit (korridoret dhe brenda dhomave të sigurisë):

- Postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar të cilat janë të vendosura në ambiente të dukshme në dhomat e sigurisë e ambiente të tjera të njërive vendore të policisë;

- Numra të telefonit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, organizatës Instituti Evropian i Tiranës, në të cilat personat e ndaluar, arrestuar dhe të shoqëruar mund të telefonojnë pa pagesë për të paraqitur ankesa/kërkesa lidhur me qëndrimin, trajtimin që iu bëhet nga personeli policor në këto ambiente dhe raste të keqtrajtimeve;

- Listat emërore të avokatëve mbrojtës që ushtrojnë aktivitet në juridiksionin që mbulon njësia policore, si dhe të numrave të kontakteve të tyre.

161. Për hetimin dhe trajtimin e rasteve të ankesave për abuzime, keqtrajtime të kryera nga punonjës të Policisë së Shtetit ndaj personave të privuar nga liria (të shoqëruar, të ndaluar dhe të arrestuar) dhe persona të tjerë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit është ngritur dhe funksionon



Drejtoria e Standardeve Profesionale. Kjo strukturë në varësi direkte të D.P. së Shtetit ka për objekt të punës inspektimin dhe kontrollin e veprimtarisë të të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të Policisë Shtetit; administrimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave të bëra nga shtetasit për abuzime, keqtrajtime e shkelje të të drejtave të shtetasve, si dhe të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë; fillimin e hetimit administrativ/disiplinor për punonjësit e policisë përgjegjës që nuk përmbushin detyrat sipas akteve ligjore, nënligjore dhe procedurave standarde të punës së policisë dhe nuk respektojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Pjesë e kontroleve të kësaj strukture kanë qenë dhe ato me objekt: trajtimi i personave të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar në ambientet e Policisë së Shtetit dhe masat e marra për respektimin e garantimin e të drejtave të kësaj kategorie personash. Në përfundim të procesit hetimor disiplinor, jep masa disiplinore sipas kërkesave dhe parashikimeve të bëra në Rregulloren e Policisë së Shtetit të miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015.

162. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat fillon hetimet administrative apo ato penale, bazuar në ligjin organik nr. 70/2014, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit penal, pra punonjësi i strukturës, ka dyshime se ka konsumuar elemente të veprës penale, materialet referohen pranë organit të prokurorisë, për regjistrimin e procedimit penal dhe ndjekjen penale të punonjësit përgjegjës. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit administrative, adresohen gjetjet e këtij hetimi pranë strukturave kompetentë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe PMNZSH-së, për fillimin e hetimit disiplinor dhe dhënie e ndëshkimit me masë disiplinore për punonjësin përgjegjës.

163. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat inicion hetimet administrative apo ato penale, bazuar në ligjin organik nr. 70/2014, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, pas marrjes së ankesave, denoncimeve të qytetarëve mbi sjelljet joetike të punonjësve të strukturave. Gjithashtu, ankesat merren edhe nga: posta zyrtare dhe elektronike të shërbimit; pranë zyrave të strukturave vendore të Shërbimit, të atashuara në

drejtoritë vendore të Policisë; institucione të tjera publike e private; media e shkruar, vizive dhe elektronike; rrjetet sociale etj. Sektori i Trajtimit të Ankesave bën regjistrimin, protokollimin, vlerësimin e karakterit të ankesës dhe analizimit të të dhënave të saj. Ky shërbim adreson verifikime të mëtejshme nga strukturat vendore dhe përgatitjen e përgjigjeve të qytetarit/strukturës për përfundimin e hetimit administrative, gjetjet/ose mënyrat për zgjidhjen e mëtejshme të tyre. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit penal, pra punonjësi i strukturës, ka dyshime se ka konsumuar elemente të veprës penale, materialet referohen pranë organit të prokurorisë, për regjistrimin e procedimit penal dhe ndjekjen penale të punonjësit përgjegjës. Në rastet kur evidentohen shkelje të karakterit administrativ, adresohen gjetjet e këtij hetimi pranë strukturave kompetentë të Policisë së Shtetit, për fillimin e hetimit disiplinor dhe dhënie e ndëshkimit me masë disiplinore për punonjësin përgjegjës.

Rekomandimi 21. Hetime të menjëhershme, të pavarura dhe të plota

164. Policia e Shtetit në vazhdimësi ka marrë masa për ndalimin e torturës, keqtrajtimeve, që mund të shkaktohen nga personeli policor gjatë veprimeve që kryhen me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë, si dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore vetëm në bazë të ligjit duke respektuar të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim janë përgatitur dhe dërguar për njohje dhe zbatim gjithë strukturave të Policisë së Shtetit (qendrore dhe vendore), urdhra, letërporosi, tërheqje vëmendje/qarkore, përshkrime, përgjithësime të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe drejtorëve të departamenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si:

- Tërheqje vëmendje nr. 972, datë 5.2.2014 “Për zbatimin me përpikëri të akteve ligjore, nënligjore dhe procedurave standarde të punës lidhur me arrestimin/ndalimin, kontrollin fizik dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar”.

- Tërheqje vëmendje nr. 1947, datë 12.3.2014 “Për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore dhe procedurat standarde të punës, duke respektuar e garantuar të drejtat e personave të privuar nga liria”.

- Tërheqje vëmendje e DPPSH-së me nr. 4577/1, datë 10.9.2014 “Për shoqërimin dhe



respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”.

- Qarkore mbi ligjin nr. 108/2014 dhe zbatimin e kërkesave të neneve 109, 112 të ligjit për shoqërimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, evidentimin e të dhënave në regjistrat përkatës.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 4963, datë 5.8.2015 “Për kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësiwe policore vetëm në bazë të ligjit duke respektuar të drejtat e njeriut”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 2687, datë 10.6.2016, “Mbi përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësiwe ligjore të policisë, për marrjen dhe trajtimin e kallëzimeve të shtetasve dhe trajtimin e të shoqëruarve”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 4678/1, datë 8.8.2016 “Për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë të rregullave dhe masave të sigurisë për të arrestuarit që trajtohen në institucionet mjekësore dhe për përdorimin e forcës gjatë arrestimeve”.

- Letërporosi nr. 784, datë 18.8.2016 “Për parandalimin e ngjarjeve të rënda që mund të kryhen nga persona që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 3931, datë 19.5.2017 “Për eliminimin, parandalimin e keqtrajtimeve/dhunës fizike ndaj personave të privuar nga liria dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të punonjësve të policisë përgjegjës”.

- Tërheqje vëmendjeje (maj 2018) “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për regjistrimin dhe administrimin elektronik të të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 4353, datë 30.5.2018 “Mbi respektimin e të drejtave të personave gjatë shoqërimit, intervistimit dhe trajtimi i tyre në ambientet e policisë”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 7213/1, 26.9.2018 “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde që kanë të bëjnë me shoqërimin dhe trajtimin e të shoqëruarve në ambientet e policisë”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 3582, datë 2.5.2019 “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, në ambientet e njësive vendore të policisë”.

- Tërheqje vëmendjeje e DPP-së Shtetit nr. 5669/2, datë 15.8.2019 “Për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë përdorimit të forcës në

përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore nga Policia e Shtetit”.

- Letërporosi nr. 5126, datë 15.8.2019 “Për respektimin e të drejtave të komuniteteve/pakicave kombëtare, parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve diskriminuese që cenojnë dinjitetin e tyre”.

- Letërporosi e DPP-së Shtetit nr. 6104/3, datë 2.9.2019 “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të CPT-së për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit”.

- Letërporosi nr. 278/1, datë 15.1.2020 “Për zbatimin me korrektësi të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veçanti të të drejtave të fëmijëve, gjatë kryerjes së veprimeve policore dhe procedurale nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit”.

- Tërheqje vëmendjeje nr. 1449/2, datë 2.3.2020 “Për zbatimin e rregullave dhe procedurave standarde për sigurimin dhe trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe shoqëruarve në ambientet e njësive policore”.

165. Prokuroria e Përgjithshme, si organ i pavarur, trajton dhe ndjek me prioritet rastet e pretendimeve për torturë dhe keqtrajtime nga policët apo kryerjen e veprimeve arbitrare nga strukturat e tjera ligjzbatuese.

166. Për parandalimin e keqtrajtimit në burgje, me urdhrin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve prej muajit maj të vitit 2019 është miratuar platforma për inspektimin e përgjithshëm të institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale. Nëpërmjet kësaj platforme udhëzohet institucionet, si edhe stafet e inspektimeve për kryerjen gjithëpërfshirëse të inspektimeve, si dhe duke pasur qëllim parësor vlerësimin e përmbushjes së standardeve të të drejtave dhe trajtimit të burgosurve, planifikimit dhe realizimit të objektivave të sigurisë dhe rehabilitimit, menaxhimit të burimeve njerëzore, trajnimit dhe motivimit të stafit.

167. Hetimet mbi keqtrajtimet nga personeli i burgjeve realizohen nga mekanizmat e brendshëm të inspektimit, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) – strukturë në varësi të ministrit të Drejtësisë, i cili bën hetime në rastet e shkeljes së ligjshmërisë dhe të ushtrimit të dhunës. Përveç mekanizmave të brendshëm të inspektimit, ku hetimet mbi keqtrajtimet nga personeli i



burgjeve, pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgjeve verifikohen nga Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës, si dhe nga organizata të shoqërisë civile në vend. Rastet e pretenduara për keqtrajtim nga administrata e burgjeve adresohen pranë organit të Prokurorisë, i cili vendos për fillimin e hetimeve të mëtejshme për verifikimin e rastit/eve. Për periudhën 2014 – korrik 2020 janë marrë dhe trajtuar 8091 ankesa/denoncime për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, ku rastet e denoncimeve/ankesave për keqtrajtim/ushtim dhune gjatë shoqërimit apo ndalimit/arrestimit në dhomat e paraburgimit në ambientet e strukturave të Policisë së Shtetit zënë vetëm 1.6 % të totalit (127 ankesa).

168. Sistemi i burgjeve monitorohet në mënyrë të vazhdueshme veçse nga instancat eprore e shtetërore edhe nga institucione të pavarura, siç janë:

- Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT);
- Avokati i Popullit;
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit;
- Komisioneri kundër Diskriminimit.

169. Në secilin prej raporteve të këtyre organizmave është evidentuar progresi i kryer në sistemin e burgjeve në drejtim të zbatimit të kërkesave ligjore për të drejtat e trajtimit e të burgosurve, i cili konsiston në:

- ofrimin e aksesit të shpejtë në të gjitha institucionet e planifikuara për t'u vizituar nga Komiteti CPT, përfshirë edhe institucionet që nuk ishin njoftuar paraprakisht;
- aksesin për të zhvilluar intervista private me personat e privuar nga liria;
- aksesin në të gjithë informacionin e kërkuar.

170. Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të inspektimeve periodike në IEVP ka përcjellë raportet për konkluzionet e inspektimeve në secilën IEVP prej të cilëve evidenton progres krahasuar me raportin pararendës. Veç këtyre Avokati i Popullit kryen edhe inspektime në distancë përmes kërimit e marrjes së të dhënave apo dhe vizitave në vend për raste të veçanta (mbi bazë të ankesave që iu drejtohen atyre) apo për çështje në tërësi (si p.sh. marrja në analizë e rasteve të vdekjeve në burgje etj.). Gjithashtu, inspektime e verifikime janë kryer edhe nga Komisioneri kundër Diskriminimit. Edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit

ka ushtruar inspektime në vend e distancë (përmes kërkesës për të dhëna për raste të veçanta), si dhe ka pasur bashkëpunim me DPB-në. DPB-ja për çdo rekomandim nga këto institucione ka reaguar pozitivisht dhe në frymë bashkëpunimi duke dhënë sqarime, por edhe duke hartuar plane veprimi për përmirësime të vazhdueshme. Një strukturë përgjegjëse është caktuar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm në DPB, për ndjekjen e realizimit të gjitha rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

171. Nuk ka pasur raste keqtrajtimi në sistemin e burgjeve. Komiteti për Parandalimin e Torturës, në vizitën e vitit 2018, në Shqipëri raportoi se asnjë akuzë nuk është marrë ndaj stafit për torturë apo ushtim dhune, ndërsa stafi ka bërë përpjekje të konsiderueshme për minimizimin e dhunës ndërmjet të dënuarve.

Rekomandimi 22. Burgosja në vende sekrete

172. Të gjithë personat që ndalohen dhe arrestohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbahen dhe trajtohen në ambientet e dhomave të sigurisë të njërive vendore të policisë dhe janë të njohura për komunitetin, avokatët mbrojtës, organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut, Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të të gjitha shkallëve të gjyqësorit, Ministrinë e Drejtësisë etj. Mbajtja dhe trajtimi i personave të ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë bëhet deri në marrjen e vendimit nga gjykata për caktimin e masës së sigurisë për personin dhe pas caktimit të masës së sigurisë personi lihet i lirë ose transferohet në ambientet e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të Ministrisë së Drejtësisë.

173. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikon shprehimisht institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (neni 15):

- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mbi bazën e kategorisë së subjekteve ndaj të cilave ekzekutohen vendimet penale, ndahen në: a) institucione për të dënuarit e rritur; b) institucione për të dënuarit e mitur; c) institucione për gratë; ç) institucione të paraburgimit; d) institucione të kujdesit shëndetësor për të burgosurit;

- Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilët gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme.



- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ose seksione brenda tyre, mbi bazën e sigurisë, kategorizohen si më poshtë: a) institucione të sigurisë së lartë; b) institucione të sigurisë së zakonshme; c) institucione të sigurisë së ulët; ç) institucione të hapura. 5. Përjashtimisht, krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim ose seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

174. Me urdhër nr. 380, datë 19.7.2019, të ministrit të Drejtësisë është miratuar rregullorja e brendshme e Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”.

Rekomandimi 23. Trajnimet e personelit ligjzbatues

175. Në vazhdimësi janë zhvilluar trajnime të stafit policor lidhur me rregullat dhe procedurat standarde që kanë të bëjnë me mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit; respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore të tyre, si: mbrojtja me avokat; ofrimi i shërbimit mjekësor; njohja me të drejtat e tyre; njoftimi i familjarëve për arrestimin/ndalimin dhe vendndodhjen e tyre; trajtimi ushqimor; kushtet dhe standardet e ambienteve ku mbahen e trajtohen kjo kategori personash; e drejta për të paraqitur kërkesë – ankesa për trajtimin që iu bëhet/sjelljen e qëndrimin e policisë etj. Sipas programeve vjetore të trajnimeve në Policinë e Shtetit, realizohen trajnime të specializuara në Akademinë e Sigurisë me punonjës të policisë të nivelit zbatues dhe drejtues të drejtorive vendore të policisë.

176. Është miratuar dhe vënë në zbatim: “Manuali i rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, në njësitë policore”, miratuar me urdhrin nr. 763, datë 27.9.2011, të drejtorit të Policisë së Shtetit. Pas rishikimit dhe riformatimit, me urdhrin nr. 440/3, datë 27.4.2017 të DPP-së së Shtetit, është miratuar procedura standarde: “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Janë miratuar “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” (me urdhrin nr. 308, datë 31.3.2016).

177. Në programet vjetore të trajnimeve të Policisë së Shtetit janë planifikuar trajnime në shërbim i punonjësve të policisë të strukturave vendore dhe trajnime të specializuara për nivelin zbatues dhe atë të parë të drejtimit, si: shërbimi i patrullës përgjithshme, shërbimi i policisë rrugore, ndihmësspecialistët e policimit në komunitet, punonjës të strukturave për krimet etj., lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të individëve gjatë shoqërimit, ndalimit, arrestimit dhe trajtimit në ambientet e Policisë së Shtetit. Trajnime të specializuara, të zhvilluara për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit dhe zbatimi i kërkesave të manualit nr. 763, datë 27.9.2011”.

178. Trajnimet lidhen me njohjen e akteve ndërkombëtare, Kushtetutën, Kodin e Procedurës Penale, ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, ligje të tjera, manualin “Për trajtimin dhe sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve në dhomat e sigurisë të njëjësive të policisë”; “Rregullat dhe procedurat standarde për hedhjen e administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në sistemin ADAM; “Përcaktimet ligjore për shoqërimin, rastet e shoqërimit, trajtimi i të shoqëruarve dhe përcaktimet e bëra në procedurën standarde të punës:

- Trajnim dyditor me të gjithë personelin policor të strukturave vendore dhe qendrore të policisë lidhur me njohjen e kërkesave të Rregullores së Policisë së Shtetit dhe Kodit të Etikës së Policisë.

179. Trajnime nga organizatat e shoqërisë civile:

- Trajnime organizuar nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës me tematika: “Trajtimi me dinjitet i personave në konflikt me ligjin; “Trajtimi njerëzor i personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar në ambientet e policisë dhe garancitë që ofron legjislacioni shqiptar për trajtimin shëndetësor dhe psikologjik të ndaluarve/arrestuarve, në ambientet e policisë”.

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit – “Parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit në komisaritet e policisë”.

- Trajnime organizuar nga Këshilli i Evropës mbi “Trajtimin e përshtatshëm të të ndaluarve/arrestuarve në ambientet policore”.

- Janë zhvilluar seminare/tryeza të rrumbullakëta të përbashkëta me OJQ/OJF për të



prezantuar dhe diskutuar raportet e monitorimeve të hartuara.

- Seminare dhe tryeza të rrumbullakëta të zhvilluara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me njohjen dhe zbatimin e ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

180. Aspekte të tjera të bashkëpunimit me OJF:

- përgatitja dhe hedhja në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit të një “Spoti TV” të prodhuar nga për të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar;

- prodhimi dhe shumëfishimi i deklaratës “tip” të të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar në 9 gjuhë të huaja, me 1000 (njëmijë) kopje për çdo gjuhë;

- prodhimi, i 300 (treqind) posterave për parandalimin e dhunës dhe keqtrajtimit të personave në ambientet e policisë, të cilat u janë shpërndarë njësisë vendore të policisë;

- kryerja e monitorimeve në komisaritet e policisë OJF në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit.

181. Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit: nga ana e Avokatit të Popullit janë zhvilluar monitorime/kontrolle çdo vit pothuajse në të gjitha njësitë vendore të policisë. Nga strukturat e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe ato të drejtorive vendore të policisë janë administruar njohur dhe analizuar raportet e monitorimeve të kryera nga Avokati i Popullit. Gjithashtu, janë përgatitur e dërguar përgjigjet për Avokatin e Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të bëra pas inspektimeve të kryera. Janë realizuar takime midis Avokatit të Popullit dhe drejtuesve të Lartë të Policisë së Shtetit për forcimin e bashkëpunimit, përmbushjen e detyrave nga Policia e Shtetit duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ndjekjen dhe trajtimin ligjor të ankesave të për shkelje të të drejtave të tyre nga policia etj. Janë zhvilluar seminare e tryeza të rrumbullakëta nga Avokati i Popullit, lidhur me kushtet dhe standardet e ofrimit të shërbimit shëndetësor ndaj të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e policisë; prezantimin e projekt raporteve të vizitave monitoruese të kryera në strukturat e Policisë së Shtetit.

Rekomandimi 23. Informimi dhe trajnimi i personelit multidisiplinar të sistemit të burgjeve.

182. Në periudhën 2014–2020, kanë ndodhur ndryshime dhe reforma të rëndësishme në sistemin penitenciar, të cilat janë finalizuar me miratimin e ligjit të ri për trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në vitin 2020 dhe Planin e Veprimit 2019–2022. Trajnimi i stafit të burgjeve dhe paraburgimit mbetet një nga prioritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kurrikulat, manualët dhe procedurat standarde, përmbajnë informacione dhe njohuri të lidhura me sjelljen profesionale, parandalimin e keqtrajtimeve, dhunës, respektimin e të drejtave të personave në konflikt me ligjin dhe dinjitetit njerëzor.

183. Disa projekte të rëndësishme janë zhvilluar në sistemin e burgjeve gjatë kësaj periudhe:

- projekte binjakëzimi;

- zbatimi i fazës së dytë të Instrumentit Horizontal Facility;

- parandalimi radikalizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm;

- rritja e kapaciteteve të stafit që punon me të mitur etj.

184. Të gjitha këto projekte, si dhe trajnimet e zhvilluara nga Qendra e Trajnimit e DPB-së dhe trajnimet e zhvilluara në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve të stafit dhe në përmirësimin e shërbimit ndaj personave nën kujdesje.

185. Çdo vit ka pasur trajnime të vazhdueshme. Në vitin 2019, janë trajnuar 2042 punonjës, (45% e numrit të përgjithshëm) nga të cilët, 361 janë punonjës të nivelit të mesëm të shërbimeve multidisiplinare; 1516 janë punonjës të rolit bazë dhe 27 janë punonjës të nivelit të lartë të drejtimit dhe 138 ekupe multidisiplinare. Gjithashtu, janë trajnuar stafi që punon me të miturit, në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

186. Trajnimi i stafit të sistemit të burgjeve, veçanërisht trajnimin fillestar për rekrutim në sistemin e burgjeve. Trajnimi fillestar është përmirësuar në aspektin e kurrikulave, me mbështetjen e projekteve të Këshillit të Evropës në kuadër të programit “Mbështetje horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, fazat I dhe II.

187. Bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë, për trajnimin fillestar të punonjësve të rinj, duke u ofruar edhe akomodim pranë ambienteve të



Akademisë. Temat e trajnimit fillestar kanë të bëjnë me çështje të të drejtave të burgosurve, parandalimi i dhunës, menaxhimi i incidenteve, trajtimi i grupeve vulnerabël etj.

Krahas trajnimit bazë zhvillohet edhe trajnime në detyrë, referuar nevojave të stafit të cilat janë vlerësuar gjatë ushtrimit të detyrës.

188. Në Planin e Veprimit për sistemin e burgjeve për periudhën 2020–2022, është planifikuar forcimi i qendrës së trajnimeve kryesisht përmes:

- rishikimit të kurrikulës fillestare dhe ato në detyrë në lidhje me Kodin e Etikës, aspektet shëndetësore dhe të ndihmës së parë, përdorimit të mjeteve të forcës dhe të kufizimit fizik, aspektet e menaxhimit, menaxhimit të krizave, abuzimit me substancat dhe ndërgjegjësimi mbi drogat etj.;

- programeve të trajnimit për nevoja të veçanta të grave të burgosura dhe menaxhimi i burgjeve për gratë;

- programeve të trajnimit për stafin e burgjeve për menaxhimin e të burgosurve me rrezik të lartë/të dhunshëm.

189. Stafi i burgjeve dhe paraburgimit është trajnuar lidhur me raportimin e dhunës dhe torturës dhe kryerjen e hetimeve të thelluara. Gjatë periudhës së pranimit nga ana e stafit shëndetësor në burgje dhe paraburgime kryhet një vizitë e përgjithshme dhe nëse ka shenja të përdorimit të dhunës hartohet një raport i menjëhershëm për drejtorin e institucionit dhe prokurorin. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka zhvilluar disa seanca trajnimi lidhur me Protokollin e Stambollit në bashkëpunim me partnerë dhe organizata joqeveritare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

190. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka trajnuar periodikisht stafin e sigurisë, civil dhe mjekësor mbi këtë manual dhe formatet përkatëse të dokumentimit të rasteve. Programi i miratuar i trajnimit për punonjësit e nivelit bazë të sigurisë përfshin një modul mbi konceptet dhe parandalimin e torturës nga administrata e sistemit të burgjeve. DPB-ja ka bashkëpunuar me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, përmes zbatimit të programit mbi parandalimin e torturës dhe dhunës në sistemin e burgjeve, i cili ka konsistuar në:

- monitorimin e sistemit, sipas standardeve të OPCAT-së;

- advokimit për përmirësimin e praktikave në lidhje me trajtimin human të personave në konflikt me ligjin, ngritje kapacitetesh për stafin multidisiplinar të nivelit të mesëm drejtues të sistemit të burgjeve, lidhur me zbatimin e Protokollit të Stambollit;

- seminare trajnimi mbi procedurat e dokumentimit efektiv të rasteve të keqtrajtimeve, në zbatim të Protokollit të Stambollit dhe rregullat e Komitetit për Parandalimin e Torturës, si dhe shkëmbim përvojash me vendet e rajonit përmes vizitave studimore.

- DPB-ja ka bashkëpunuar me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, përmes zbatimit të programit mbi parandalimin e torturës dhe dhunës në sistemin e burgjeve, i cili ka konsistuar në monitorimin e sistemit, sipas standardeve të OPCAT-së, advokimit për përmirësimin e praktikave në lidhje me trajtimin human të personave në konflikt me ligjin, ngritje kapacitetesh për stafin multidisiplinar të nivelit të mesëm drejtues të sistemit të burgjeve, lidhur me zbatimin e Protokollit të Stambollit, seminare trajnimi mbi procedurat e dokumentimit efektiv të rasteve të keqtrajtimeve, në zbatim të Protokollit të Stambollit dhe rregullat e Komitetit për Parandalimin e Torturës, si dhe shkëmbim përvojash me vendet e rajonit përmes vizitave studimore.

Rekomandimi 23 (b). Mbi trajnimin e personelit zbatues të ligjit, të gjyqtarëve në veçanti.

191. Legjislacioni në zbatim të reformës në drejtësi i ka dhënë karakter detyrues formimit vazhdues të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH-së”, parashikohet që magistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues, të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin e Prokurorisë, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit.

Formimi vazhdues organizohet nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli i Prokurorisë.

192. Oficerët e policisë gjyqësore kanë detyrim pjesëmarrjen në trajnimin vazhdues, sipas parashikimit në nenin 28, të ligjit nr. 25/2019 “Për organizmin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, një



ndihmesë të rëndësishme për institucionin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm japin edhe projektet/misionet ndërkombëtare, si: EURALIUS, PAMECA, OPDAT etj.

193. Shkolla e Magistraturës ka zhvilluar trajnime të vazhdueshme periodike me gjyqtarë e prokurorë dhe kandidatë për magistratë dhe prokurorë mbi: procesin penal; Kodin e Procedurave Penale; viktimë dhe procesi penal; trafikimi i qenieve njerëzore; dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore²⁶.

Rekomandimi 25. Gjakmarrja

194. Me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, janë bërë ndryshime në Kodin Penal duke cilësuar veçmas vrasjet për hakmarrje dhe vrasjet për gjakmarrje:

- Nenin 78 “Vrasja me paramendim”: “Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet, vrasja e kryer për interes apo hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”.

- Neni 78/a “Vrasja për gjakmarrje”: “Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm”.

195. Prej vitit 2012, është hartuar Plani i Veprimit “Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes”, i cili është përmirësuar në vitet 2014 dhe 2018²⁷. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është ngritur Shtabi i Drejtimit kundër Krimeve me Motive Hakmarrje dhe Gjakmarrje, i cili ka për detyrë të drejtë, kontrollojë, koordinojë veprimtarinë e strukturave vartëse për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të krimit të vrasjes të kryer për hakmarrje apo gjakmarrje.

196. Objektivat e këtij Plani Veprimi:

- goditja e fenomenit të gjakmarrjes dhe hakmarrjes duke bashkëpunuar ngushtë me pushtetin vendor dhe organizatat jofitimprurëse për zgjidhjen me pajtim të konflikteve;

- forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë për hetimin e shpejtë të këtyre veprave penale dhe vënien para drejtësisë të autorëve të tyre;

- organizimi i masave të gjithanshme për kapjen e autorëve të vrasjeve në tërësi dhe të atyre për gjakmarrje në veçanti si një masë e madhe parandaluese për vazhdimin e gjakmarrjes;

- forcimi i bashkëpunimit me drejtoritë arsimore e shkollat për edukimin e brezit të ri me frymën e tolerancës dhe parandalimin e krimit.

197. Të dhënat statistikore të administruara nga strukturat e Policisë së Shtetit, për veprën penale “Vrasja për gjakmarrje”, parashikuar nga neni 78/a, i Kodit Penal:

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i rasteve	7	3	4	0	1	1	1	0	1

198. Nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit gjatë periudhës 2013–2020, janë organizuar në vazhdimësi takime sensibilizuese në lidhje me fenomenin e gjakmarrjes, ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga pushteti vendor, si dhe OJF të ndryshme.

199. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është krijuar një bazë të dhënash për regjistrimin e të gjitha familjeve të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes, si dhe janë hartuar Procedurat Standarde të Punës “Për evidentimin e regjistrimin në bazën e të dhënave të personave të përfshirë në vepra penale me motiv gjakmarrjen”. Referuar të dhënave të administruara nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit, rezulton se, aktualisht në vendin tonë ka 75 familje me 159 persona të ngjuar (me vetëkufizim lirie), nga të cilët 25 janë fëmijë. Nga këto 15 familje me 56 persona janë larguar jashtë shtetit.

Rekomandimi 26. Identifikimi i pjesëtarëve të grupeve të ndërhyrjes në burgje

200. Në zbatim të VKM-së nr. 463, datë 6.5.2009, “Për përcaktimin e ngjyrës, të uniformës dhe të shenjave, në mjetet e policisë së burgjeve”, janë marrë masa për pajisjen e uniformave të të gjithë efektivëve të Policisë të Burgjeve, përfshirë edhe punonjësit e grupeve të ndërhyrjes speciale, me shenjat dalluese dhe identifikuese.

201. Staf i që shërben në burgje, në ambientet e brendshme të banimit të dënuarve, por edhe jashtë,

²⁶ Informacion i detajuar mbi trajnimet jepet në shtojcat në vijim.

²⁷ Plani nr. 1277 datë 24.10.2012, “Për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes”, i ndryshuar me Planin e Veprimit nr. 419, datë 31.3.2014, dhe Planin e Veprimit nr. 2057, datë 19.12.2018.



edhe në shoqërimin jashtë burgut, janë të pajisur me uniforme të dallueshme, simbole dhe emrin e punonjësit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka miratuar procedurën e përdorimit të forcës, e cila shoqërohet me raportimin e rastit te drejtori i institucionit në formularë standardë.

202. Krahas standardizimit të përdorimit të forcës vetëm si mjet i fundit dhe kur është e nevojshme dhe domosdoshme, si dhe në minimumin e nevojshëm, janë përmirësuar standardet e përdorimit të masës së veçimit, reflektuar edhe në ligjin e ri për të drejtat e të dënuarve dhe paraburgosurve (viti 2020).

203. Komiteti për Parandalimin e Torturës, në vizitën e vitit 2018, në Shqipëri raportoi se asnjë akuzë nuk është paraqitur ndaj stafit për kryerje torture apo ushtrim dhune, ndërsa stafi ka bërë përpjekje të konsiderueshme për minimizimin e dhunës ndërmjet të dënuarve.

Rekomandimi 27. Padia civile për kompensim

204. Siç është evidentuar më sipër në informacionin mbi nenin 14, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale të vitit 2017 (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017,) përmirësojnë të drejtat dhe pozitën e viktimës së veprave penale 85. Në nenin 61 parashikohet padia civile në procesin penal. Personi që ka pësuar dëme nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

Rekomandimi 28. Mbledhja e të dhënave

205. Mbi përpilimin dhe administrimin e statistikave të krimeve nga Shteti palë, mbështetur në mekanizmin e kërkesës dhe ankesës çdo institucion burgimi administron të dhëna mbi ankesat që i drejtohen institucionit, të cilat ndahen me institucionet e linjës. Numri i ankesave që mund të kenë në objekt pretendimet për torturë nga administrata e burgjeve, të cilat u adresohen Institucioneve/agjencive jashtë sistemit të burgjeve nuk mundën objektivisht të përpilohen nga sistemi i burgjeve për shkak të konfidencialitetit të adresimit të tyre.

206. Ministria e Punëve të Brendshme, ka administruar të dhëna statistikore për dhunën në familje, bazuar në urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 251, datë 15.2.2008, “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”, i cili përcaktonte krijimin e

formularëve të posaçëm statistikorë për dhunën në familje (formulari nr. 16). Të dhënat e administruara në këta formularë nuk përfshijnë nenin 130/a, i cili është shtuar në vitin 2012/2013. Përfshirja në formularët statistikorë të të dhënave për dhunën në familje (neni 130/a i K. Penal) u realizua me urdhrin nr. 1531, datë 24.10.2014 “Për hartimin e statistikave të kriminalitetit”, të DPP-së së Shtetit, ku formulari nr. 16, për të dhënat e dhunës në familje, ndryshoi dhe në të u përfshi edhe neni 130/a.

207. Prej vitit 2014 zbatohet në bashkitë e vendit, projekti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me UNDP-në, sistemi *on line* i kompjuterizuar për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje. Koordinatorët vendor të dhunës në çdo bashki, mbledhin të dhënat për rastet e evidentuara dhe trajtuara nga Mekanizmi i referimit në nivel lokal. MSHMS-ja ka trajnuar dhe vazhdon ngritjen e kapaciteteve të koordinatorëve vendorë për këtë qëllim. Ky sistem përmban të dhëna mbi dhunuesin, si dhe ndjek rastet e dhunës në familje që nga raportimi deri kur rasti merr përfundimisht zgjidhje.

208. Sistemi regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën procesi dhe ku ka ngelur, si dhe siguron përfundimin e tij. Të dhënat e mbledhura lidhur me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore bëhen pjesë e transparencës publike në nivel kombëtar. Të dhënat përdoren për trajnimin e profesionistëve dhe ndërgjegjësimin mbi situatën me qëllim adresimin e politikave të përshtatshme. Të dhënat publikohen në nivel kombëtar edhe përmes botimeve të ndryshme të INSTAT-it ose Open Data Albania, vjetori statistikor i Ministrisë së Drejtësisë etj. Këto të dhëna janë të aksesueshme sipas rregullave për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale të viktimës, garantuar nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit në RSH”.

SHTOJCAT

Shtoja nr. 1. Sistemi i burgjeve

1. Si rezultat i zbatimit të dënimeve alternative, zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, hapjes së institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) të reja (Fier, Shkodër), aplikimit të masave alternative të sigurisë, veçanërisht në periudhën e



pandemisë, është tejkaluar përfundimisht çështja e mbipopullimit në burgje. Kushtet e përgjithshme të akomodimit të të dënuarve në burgje janë përmirësuar.

Viti	Numri i të burgosurve	Kapaciteti	Niveli i mbipopullimit
2016	5753	5455	9%
2017	5466	5455	4%
2018	5411	6236	3%
2019	5191	6106	-13%
2020	4866	6106	-21%

Shërbimi shëndetësor

2. Të burgosurit përfitojnë pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, mbështetur në VKM-në nr. 337, datë 6.4.2011, “Për përfshirjen e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve në kategorinë ekonomikisht joaktivë” dhe memorandumit e bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në sistemin e burgjeve, realizohet *Check-up* (kontrolli mjekësor bazë) për të gjithë të burgosurit të grup-moshës 35–70 vjeç, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Shtetasit me çrregullime shëndetësore akute apo kronike në sistemin e burgjeve, trajtohen me të njëjtat standarde të institucioneve të shëndetit publik dhe trajtohen, sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë. Në të gjitha institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale ofrohet shërbim shëndetësor 24 orë.

3. Rehabilitimi dhe riintegrimi i të burgosurve:

- programe rehabilituese zbatohen për çdo kategori të burgosurish, të cilat synojnë modifikimin e mendimeve dhe sjelljeve kriminale;
- në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) është bërë e mundur këtë vit zgjerimi i hartës së IEVP-ve ku zhvillohet procesi arsimor për të burgosurit;
- procesi i formimit profesional zhvillohet në disa IEVP;
- të miturit dhe gratë e dënuar aktivizohen në aktivitete punësimi.

4. Regjimi i posaçëm konsiston në:

- a) lejimin e një takimi familjar në muaj, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohet hyrja e personave apo sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Me termin “familjarë”

nënkuptohen të paralindurit, të paslindurit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Takimi me persona të ndryshëm nga familjarët, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e ministrit të Drejtësisë. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës;

b) lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kurse për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendëse ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;

c) ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që mund të marrë i dënuari ose i paraburgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

d) kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në nenin 43 të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

e) reduktimin e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;

f) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve apo të paraburgosurve.

Masat parandaluese të COVID-19 – Sistemi i burgjeve:

5. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka përmirësuar protokollet e masave të ndërmarra, duke krijuar jo vetëm standarde për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave të dënuar e të paraburgosur dhe garantimin e së drejtës së trajtimit njerëzor në kushtet e pandemisë botërore të shkaktuar COVID-19, por edhe praktikave të mira dhe efiente për përballimin e situatave të ngjashme të emergjencave natyrore në sistemin e burgjeve. Nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) janë nxjerrë disa



urdhura dhe udhëzime për marrjen e masave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

6. Me qëllim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave të dënuar dhe garantimin e së drejtës së trajtimit njerëzor dhe respektimit të dinjitetit të individit, në kuadër të masave të posaçme ndaj pandemisë botërore që ka shkaktuar koronavirusi i ri COVID-19, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 7/2020 “Për dhënien e lejes së përkohshme për të burgosurit e dënuar, të cilët lejohen të qëndrojnë në shtëpi për një periudhë tremujore”.

7. Nga ky akt kanë përfituar 372 të dënuar, sipas kriterëve vijuese:

- të dënuar të cilët janë dënuar për vepra penale që nuk përbëjnë rrezikshmëri shoqërore dhe që u ka mbetur më pak se 3 vite burg për të vuajtur.

- të dënuar të grup-moshës baras ose mbi moshën 60 vjeç, që janë dënuar për vepra penale që nuk përbëjnë rrezikshmëri shoqërore, të cilëve u ka mbetur më pak se 5 vite burg për të vuajtur dhe vuajnë nga sëmundje kronike të tilla që në kushtet e epidemisë COVID-19 mund të përbëjnë rrezik për jetën.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) ka nxjerrë disa akte administrative për parandalimin e përhapjes së virusit në sistemin e burgjeve dhe masa shtesë për ruajtjen e rendit e sigurisë në IEVP dhe mirëqenien psikologjike të të burgosurve në situatën e pandemisë. Udhëzime specifike për masa strikte shëndetësore dhe asistencë psikologjike të shtuar janë dhënë veçanërisht për ato IEVP, që:

- akomodojnë kategori specifike si të sëmurë kronik, të burgosur të moshës së tretë, të sëmurë me çrregullime mendore, gra etj., si dhe

- ndodhen pranë zonave të riskuara për përhapjen e epidemisë.

9. Situata shëndetësore e të burgosurve është ndjekur në dinamikë nga stafi i kujdesit shëndetësor në burgje, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e shëndetit publik.

Të burgosurit janë informuar paraprakisht për masa kufizuese të distancimit social të kondicionuara nga situata e pandemisë COVID-19.

Shtojca nr. 2.

Të dhëna statistikore për periudhën 2014–31.6.2020, për dhunën dhe krime të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare – Ministria e Brendshme:

1. Gjatë vitit 2014:

- janë evidentuar gjithsej 4121 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare;

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori për 1699 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, si dhe janë arrestuar në flagrancë 585 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2422 raste, të dhunës në familje;

- janë evidentuar 17 vrasje në familje me 22 viktima, prej të cilave gra/vajza janë 10 dhe nga këto 6 kanë qenë bashkëshorte.

2. Gjatë vitit 2015 janë evidentuar gjithsej 3866 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori për 1719 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në familje, si dhe janë arrestuar në flagrancë 730 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2148 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 18 vrasje në familje me 20 viktima, prej të cilave gra/vajza janë 10 dhe nga këto 9 kanë qenë bashkëshorte.

3. Gjatë vitit 2016 janë evidentuar gjithsej 4163 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 1956 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në familje, prej të cilave 1488 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 944 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2207 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 16 vrasje në familje, me 17 viktima, prej të cilave gra/vajza janë 13 dhe nga këto 8 kanë qenë bashkëshorte.

4. Gjatë vitit 2017 janë evidentuar gjithsej 4543 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 1950 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në familje, prej të cilave 1412 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 654 autorë;



- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2207 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 15 vrasje në familje, me 16 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 9 dhe nga këto 5 kanë qenë bashkëshorte.

5. Gjatë vitit 2018 janë evidentuar gjithsej 4951 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 1914 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1373 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 608 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 3037 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 11 vrasje në familje, me 20 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 11 dhe nga këto 4 kanë qenë bashkëshorte.

6. Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej 4629 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori në 1793 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 1341

raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 535 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 2836 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 14 vrasje në familje, me 17 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 12 dhe nga këto 8 kanë qenë bashkëshorte.

7. Gjatë vitit 2020 janë evidentuar gjithsej 2053 raste të dhunës dhe krimeve të tjera të ndodhura në marrëdhëniet familjare, nga të cilat:

- janë referuar materialet për ndjekje penale në prokurori 847 raste të dhunës dhe krimeve të tjera në marrëdhëniet familjare, prej të cilave 674 raste janë bazuar në nenin 130/a “Dhuna në familje”, si dhe janë arrestuar në flagrancë 270 autorë;

- janë trajtuar me kërkesë padi “Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes” 1206 raste të dhunës në familje;

- janë evidentuar 4 vrasje në familje, nga të cilat janë shkaktuar 5 viktimë, prej të cilave gra/vajza janë 4 dhe nga këto 3 kanë qenë bashkëshorte.

- Më poshtë tabela përmbledhëse e të dhënave për dhunën në familje.

Viti	Raste gjithsej evidentuar	Raste trajtuar me kërkesëpadi UMM/UM	Raste/ dhunë ndaj grave	Raste/ dhunë ndaj fëmijëve në familje
2012	2526	1562	2036	58
2013	3020	1851	2346	108
2014	4121	2422	3090	157

Viti	Raste gjithsej evidentuar	Raste të trajtuara me kërkesëpadi UMM/UM	Raste të ndjekura penalisht 130/a	Raste/ dhunë ndaj grave	Raste/ dhunë ndaj fëmijëve në familje
2015	3866	2148	1299	2954	145
2016	4163	2207	1488	3062	186
Janar-qershor 2017	2035	1117	680	1462	105

Viti	Raste dhune në familje/ evidentuar gjithsej	Kërkesëpadi për UMM/UM	Procedime neni 130/a, K.P.	Arrestuar për 130/a	Vrasje në familje
2014	4121	2422	1120	439	17
2015	3866	2148	1300	588	18
2016	4163	2207	1488	742	16
2017	4543	2593	1412	654	13
2018	4951	3037	1373	608	11
2019	4629	2836	1341	535	14
2020 6-mujori	2053	1206	674	270	4

**Shtojca nr. 3.** Të dhëna mbi procedimet penale

Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 1215 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 941 procedime;

Gjatë vitit 2015 janë regjistruar 1206 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1023 procedime;

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 1355 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1157 procedime;

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 1310 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1057 procedime;

Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 1349 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 1050 procedime;

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1239 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 878 procedime;

Gjatë vitit 2020 (6-mujori I) janë regjistruar 554 procedime penale dhe janë dërguar për gjykim 380 procedime.

Shtojca nr. 4. Të dhënat statistikore, mbi trafikimin, paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për periudhën 2014 – korrik 2020, paraqiten si më poshtë:

Për vitin 2014, janë evidentuar në total 58 vepra penale me 75 autorë, sipas veprave penale:

- 49 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur”, me 66 autorë;

- 9 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 9 autorë.

Për vitin 2015, janë evidentuar në total 80 vepra penale me 90 autorë, sipas veprave penale:

- 63 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur”, me 67 autorë;

- 17 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 23 autorë.

Për vitin 2016, janë evidentuar në total 63 vepra penale me 65 autorë, sipas veprave penale:

- 42 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur”, me 44 autorë;

- 21 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 21 autorë.

Për vitin 2017, janë evidentuar në total 80 vepra penale me 91 autorë, sipas veprave penale:

- 58 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur”, me 66 autorë;

- 22 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 25 autorë.

Për vitin 2018, janë evidentuar në total 38 vepra penale me 51 autorë, sipas veprave penale:

- 30 vepra penale për “Trafikim i personave të rritur”, me 42 autorë;

- 8 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 9 autorë.

Për vitin 2019, janë evidentuar në total 41 vepra penale me 62 autorë, sipas veprave penale:

- 34 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë;

- 7 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 8 autorë.

Për periudhën janar–korrik 2020 janë evidentuar në total 20 vepra penale me 25 autorë, sipas veprave penale:

- 16 vepra penale për “Trafikim i personave”, me 21 autorë;

- 4 vepra penale për “Trafikim i të miturve”, me 4 autorë.

Shtojca nr. 5. Të dhëna mbi trajnimet e realizuara nga Policia e Shtetit “Për garantimin e të drejtave të shtetasve të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në ambientet e policisë, parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit në ambientet e policisë”

Nr.	Viti	Nr. i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve
1	2014	16	334
2	2015	6	93
3	2016	6	110
4	2017	0	0
5	2018	1	23
6	2019	2	12
7	Janar–qershor 2020	0	0
		Gjithsej 31 trajnime	572 punonjës të trajnuar



Shtojca nr. 6. Masat disiplinore të dhëna ndaj personelit policor për ushtrim dhune, keqtrajtime dhe shkelje të tjera të të drejtave të personave, janë si vijon për periudhën 2014–2020:

Nr.	Lloji i masës/viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Përfshirje nga Policia	-	10	6	5	1	4	1
2	Uljë me një gradë për 6 muaj	1	-	3	-	-	-	-
3	Shtyrje e afatit të gradimit deri 2 vjet	2	3	6	13	2	13	2
4	Pezullim pa pagesë deri 30 ditë	8	3	-	-	-	-	-
5	Masa të lehta	-	5	44	9	1	9	3
6	Në proces hetimi	-	-	-	-	4	-	-
7	Totali	11	21	59	27	8	26	6

Shtojca nr. 7. Trajnime: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – dhuna me bazë gjinore dhe dhuna ndaj grave

- Përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje;
- Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse;
- Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i sistemit *on-line* të rasteve të dhunës në familje;
- Buxheti gjinor dhe ngritja e kapaciteteve të nëpunësve gjinorë në nivel qendror dhe vendor;
- Trajnimi i nëpunësve gjinorë të ministrive;
- Standardet evropiane lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit nga sistemi i drejtësisë;
- Trajnime të punonjësve të policisë, për dhunën në familje, në drejtoritë vendore të policisë;
- “Roli i Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’ dhe në mekanizmin e reagimit të koordinuar ndaj dhunës në familje”;
- “Hetimi i krimeve seksuale”, ku janë trajnuar 60 specialistë për dhunën në familje, të miturit dhe krimet seksuale, si dhe specialistë të krimeve në komisariatet e policisë;
- Trajnime për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore në adresimin e dhunës në familje.

Shtojca 8: Informacion mbi trajnimet periodike të kryera nga Shkolla e Magjistraturës

- Risetë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risetë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave.

- Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut GJEDNJ-së në lidhje me marrjen në pyetje të të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal.

- Konventat e Hagës me fokus në të drejtën familjare dhe të drejtat e fëmijëve. Roli i gjyqësorit në zbatimin e tyre.

- Konventa e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së. Trajnime me fokus konventat e Hagës të detyrueshme për Shqipërinë.

- Zbatimi në praktikë i Konventës së Hagës; përditësimi i gjyqësorit shqiptar me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

- Trafikimi i qenieve njerëzore. Ndjekja dhe gjykimi penal i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me risitë në Kodin e Procedurës Penale. Të drejtat e viktimës së trafikimit gjatë procesit penal.

- Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore. Roli i gjykatës me fokus problematiken e praktikës gjyqësore.

- Detyrimet që burojnë nga Konventa e Stambollit dhe Rekomandimet e Komitetit Grevio për sistemin e drejtësisë.

- Ndryshimet në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe bashkërendimi institucional në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.



- Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a i Kodit të Familjes.

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëshmipërblimi i viktimave.

- Roli i alternativave të dënimit me burgim dhe shërbimi i provës. Lirimi para kohe me kusht si një nga alternativat e dënimit me burgim. Praktika gjyqësore. Marrëdhëniet e shërbimit të provës me prokurorinë në fazën e ekzekutimit.

- Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në këndvështrim të ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.

- Ekstradimi.

- Arresti i përkohshëm.

- Njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë “*in absentia*” nga autoriteti gjyqësor i huaj.

- Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëshmipërblimi i viktimave.

- Gjykimi në mungesë.

- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor praninë e të pandehurit në gjykim.

- Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017.

- Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore – me fokus ndryshimet ligjore, shërbimet ndaj viktimës dhe rehabilitimin/punën me dhunuesit.

- Të drejtat e migrantëve dhe azilkërkuesve. Standardet e mbrojtjes së parashikuar në konventat e ratifikuara nga Shqipëria në fushën e migracionit dhe azilit, dhe direktivave të BE-së në këtë fushë. Probleme të praktikës gjyqësore shqiptare. Vështrim krahasimor me praktikat më të mira të tribunaleve ndërkombëtare respektive.

Shtojca nr. 9. Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Horizontal Facility)

1. Faza e dytë e HF-së zbatohet për një periudhë 3-vjeçare (2019–2022), financohet nga BE-ja dhe KE-ja (respektivisht 85% dhe 15%), si dhe projektet zbatohen nga Këshilli i Evropës.

Fushat e veprimit lidhen me: sistemin i drejtësisë; luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; antidiskriminimi dhe të drejtat e njeriut; lirinë e shprehjes dhe media.

2. Arritjet kryesore të zbatimit të HF-së në sistemin e burgjeve.

- Përgatitja e një analize gjinore në sistemin e burgjeve me qëllim të rritjes së barazisë midis grave dhe burrave, veçanërisht përmes aktiviteteve të parashikuara.

- Broshura informuese mbi të drejtat e të burgosurve, shërbimet e disponueshme dhe mekanizmat e ankesave, si dhe zhvillimi i fushatave informuese në institucionet e vuajtjes së dënimit.

- Pilotimi i planeve model të para-lëshimit dhe regjimet ditore, si pjesë e paketës së rehabilitimit në tri institucione burgje.

- 16 module trajnimi mbi induksionin dhe trajnimin e vazhdueshëm janë rishikuar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- Rishikimi ligjor mbi sjelljen e policisë së burgjeve, në përputhje me standardet e CPT-së dhe përmbajtjen përkatëse/ specifike të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

- Trajnim pilot katërmujor i stafit rehabilitues në tri burgje pilot (“Ali Demi”, Fier dhe Peqin). Planet e para-lëshimit dhe metodologjitë e regjimit ditor u zhvilluan bazuar në rezultatet e vlerësimit në lidhje me nivelin aktual dhe cilësinë e aplikimit të kësaj të fundit. Këto instrumente të zhvilluara rishtas do të plotësojnë zbatimin e vlerësimit të rrezikut dhe nevojave dhe planifikimit të dënimit individual, si pjesë e përmirësimit të procesit të rehabilitimit të të burgosurve, në tri burgjet pilot të zgjedhura.



VENDIM
Nr. 363, datë 16.6.2021

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TE MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
TË PRONËS NR. 442, ME EMËRTIM
“ISH-BATALION I GATSHËM”, ME
VENDNDODHJE NË METEOR,
SHTIQEN, KUKËS, DHËNIEN NË
PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA
SHPËRBLIM, TË DISA OBJEKTEVE
DHE TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL
FUNKSIONAL, PJESE E PRONËS NR.
436, ME EMËRTIM “NDËRTESE
SINOPTIKE”, ME VENDNDODHJE NË
KUKËS, KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
TE MINISTRIA E MBROJTJES, TË NJË
SIPËRFAQEJE PREJ 1 181 m², DY
AMBIENTE ZYRASH TE GODINA E
MBROJTJES NDAJ ZJARRIT, DHE PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 515,
DATË 18.7.2003 DHE NR. 343,
DATË 7.6.2006**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 442, me emërtim “ish-Batalion i Gatshëm”, me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas formularit dhe planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit”.

2. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, me afat 30 (tridhjetë) vjet, të objekteve së bashku me truall funksional, në total me sipërfaqe prej 2 302 (dymijë e treqind e dy) m², dhe

objektin nr. 1, me sipërfaqe 98.3 m², pjesë e pronës nr. 436, me emërtim “Ndërtesë sinoptike”, me vendndodhje në Kukës, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit”.

3. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti i Aviacionit Civil) te Ministria e Mbrojtjes, të një sipërfaqeje prej 1 181 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m², 2 (dy) ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit, për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.

4. Ndryshimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe nr. 343, datë 7.6.2006, “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, sipas planrilevimeve dhe skicës që i bashkëlidhen këtij vendimi e që janë pjesë përbërëse e tij, për t’i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP “Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit” dhe për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.

5. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i transferohen në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 442, me emërtim “ish-Batalion i Gatshëm”, me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas planrilevimit bashkëlidhur, dhe të shtohet prona me sipërfaqe 1 181 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m², me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas skicës dhe planrilevimit bashkëlidhur, si dhe 2 (dy) ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit në këtë pronë, të cilat do të përdoren për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik.

6. Në pronën e paluajtshme shtetërore, sipas vendimit nr. 343, datë 7.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, të hiqet sipërfaqja 1 181 (një



mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m² me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas skicës dhe planrilevimit bashkëlidhur, si dhe 2 (dy) ambiente zyrrash të godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit, dhe të shtohet prona nr. 442, me emërtim “ish-Batalion i Gatshëm”, me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas planrilevimit bashkëlidhur.

7. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronave, të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ose t'ua japin ato në përdorim të tretëve.

8. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Komanda e Forcës Ajrore dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 30-vjeçare, të sipërfaqes prej 2 302 (dymijë e treqind e dy) m² dhe objektin nr. 1, me sipërfaqe 98.3 (nëntëdhjetë e tetë pikë tre) m², të pronës me nr. 436, sipas planrilevimit, duke përcaktuar kushtet e detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e

sipërfaqes së pronës, sipas parametrave e kushteve teknike.


9. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Komanda e Forcës Ajrore, dhe Ministria e Infrastrukturës, para dorëzimit të sipërfaqeve të pronave sipas këtij vendimi, të lidhin marrëveshje me shoqërinë koncesionare të aeroportit të Kukësit, me detyrimin e këtij të fundit për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik, vendosjen e një kontejneri për magazinimin e materialeve dhe furnizimin me energji elektrike, ujë të pijshëm dhe internet për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe





VENDOSJA E AMBIENTIT TE ZYRANE TEK
GODINA E MN2





PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.442 "Ish Batalioni i Gatshëm", Meteor, Shtiqën, Kukës
(Për Transferim nga MM te MIE)

PRONARI SHTET MM (Komanda Mbështetëse) DATË 14 /06/2021 QËLLIMI: Transferim nga MM tek MIE

VENDNDODHJA
 Bashkia KUKËS DVASHK KUKËS Nr.Pasurisë 774/2 Z.K 3425 Indeksi i Hartës K-34-65-(238-A)

TE DHËNAT E PASURISË
 Lloi i pasurisë _____ Sip e pasurisë **12 821.2m²** Sip e gjurmës së ndërtimit Ojektet me nr.1,2,3,4,5,6,7,8 Nr. kateve _____

Nord = 4656255.15 East = 534183.14 **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)** Nord = 4656255.15 East = 534623.05

Spjeguese
 Sip. e përgj. për transferim nga MM tek MIE përfshi objektet 1,2,3,4,5,6,8 dhe objektin 7 (që ndodhet tek prona 436) = **12 821.2m²**
 Kufiri i Repartit
 Vija e zgjerimit të aeroportit

PISTA

Sip. e përgj. për transferim nga MM te MIE përfshi objektet me nr. 1,2,3,4,5,6,8 dhe objekti 7 (që ndodhet te prona 436) = 12 821.2m²

Nord = 4655904.08 East = 534183.14 **SH 1: 2500** Nord = 4655904.08 East = 534623.05

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			4050, 5697	KS1726024H
2	Lindje			774/3	
3	Jug			774/3	
4	Perëndim			5697	

REALIZOI PËR IGJIU
 Specialist Ramiz Haxhiu
KONFIRMOI PËR IGJIU
 DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK
 Specialisti _____
 DVASHK _____
 Nënshkrimi _____
KONFIRMOI
 Përgjegjësi/Drejtori _____
 Nënshkrimi/ Vula _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas gjendjes faktike në terren.
 Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së SHSHP të FA nr.3634/1, datë 10.06.2021 bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU, dhe projektit të zgjerimit të aeroportit të Kukës b/lidhur shkresës së KFA-së nr.1091, datë 29.03.2021

PRONARI: SHTET MM (Komanda Mbështetëse)
MIRATOHEJ
ZV/KOMANDANT I KOMANDËS MBËSHTETËSE
 Kolonel Përpamir GEGA



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

Prona nr.436 "Ndërtesa e Sinoptikës", Kukës (Sip. dhe objekti për dhënie në përdorim MIE-s)

PRONARI SHTET MM (Forca Ajrore) DATË 14 /06/2021 QËLLIMI: Dhënie në përdorim nga MM tek MIE

VENDNDODHJA
 Bashkia KUKËS DV ASHK KUKËS Nr.Pasurisë 774/3 Z.K 3425 Indeksi i Hartës K-34-65-(238-A)

TE DHËNAT E PASURISË
 Lloi i pasurisë _____ Sip e pasurisë **3 202m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **98.3m²** Nr. kateve **1** Nr. pemeve _____

Nord = 4656255.15 East = 534183.14 **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)** Nord = 4656255.15 East = 534623.05

Spjeguese
 Sipërfaqja e përgjithshme = 3202.0 m²
 Sipërfaqja nën objekt = 98.3 m²

Sip. e përgj. që do të jepet në përdorim MIE-s (aeroporti të Kukësit) përfshi objektin nr.1 dhe objekti nr.7 i cili është komponent i pronës nr. 442 = **2302m²**

Kufiri i Repartit

Vija e zgjerimit të aeroportit

Sip. e përgj. që i jepet në përdorim MIE (Aeroporti të Kukësit) përfshi objektin 1 dhe 7 = 2302m²

Nord = 4655904.08 East = 534183.14 **SH 1: 2500** Nord = 4655904.08 East = 534623.05

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			774/2	K51726024H
2	Lindje			774/3	
3	Jug			772/8	
4	Perëndim			5697	

REALIZOI PËR IGJIU
 Specialist Ramiz Haxhiu
KONFIRMOI PËR IGJIU
 DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK
 Specialisti
 DVASHK
 Nënshkrimi
 KONFIRMOI
 Përgjegjësi/Drejtori
 Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas gjendjes faktike në terren.
 Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së SHSHP të FA nr.3634/2, datë 10.06.2021 dhe të KFA nr.1091, datë 29.03.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkin e IGJIU, dhe projektit të zgjerimit të aeroportit të Kukësit bërë shkresës së KFA-së.
PRONARI: SHTET MM (Forca Ajrore)
 MIRATOHET
 ZV/KOMANDANT I FORCËS AJRORE
 Kolonel Ylli PULA



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE			
PRONARI: MIE, AAC		DATË 16/06/2021 QËLLIMI: Kalim pergjegjësi administrimi	
VENDNDODHJA			
Bashkia: Kukës DVASHK/ZVASHK: Kukës Nr.Pasurisë:771/41; 771/42 Z.K:3425 Indeksi i Hartës:K-34-65-(238-A)			
TE DHËNAT E PASURISË		Nr. kateve _____	
Lloji i pasurisë _____		Nr. pemeve _____	
Sip e pasurisë 771/41= 2788.8 m ²		Sip e pasurisë 771/42= 2878.7 m ²	
Sip e gjurmës së ndërtimit nuk ka		Sip e gjurmës së ndërtimit _____	
Nord = 4655581.074 East = 534275.729		Nord = 4655581.074 East = 534715.639	
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)			
SH 1: 2500		SH 1: 2500	
Nord = 4655230.004 East = 534275.729		Nord = 4655230.004 East = 534715.639	
SHPJËGUESË:			
PËR NDARJE PASURIE			
Parcela nr.771/41 me sip.2788.8m ² vijon: Parcela 1=2208.8 m ²			
Parcela nr.771/42 me sip.2878.7m ² vijon: Parcela 2= 580.0 m ²			
Parcela nr.771/43 me sip.2277.7 m ² Parcela 1=2277.7 m ²			
Parcela nr.771/44 me sip.2601.0 m ² Parcela 2= 601.0 m ²			
PËR BASHKIM PASURIE			
Parcela 2 e pas. nr.771/41 = 580 m ²			
Parcela 2e pas. nr.771/42= 601 m ² vijon:			
Parcela me sip.1181m ² , që do ti kalojë në përgjegjësi administrimi MM, Forcës Ajrore			
Kufiri i sip. që do ti kalojë në përgjegjësi administrimi MM, Forcës Ajrore			
Sipërfaqja = 1181m ²			
SH 1: 2500			
NR ORIENTIMI PERDORIMI TIPI I KUFIRIT KUFITARI ID/NIPT			
1 Veri			
2 Lindje			
3 Jug			
4 Perëndim			
REALIZOI :		TEKNOLOGJIA E MATJEVE	
Specialist : ing. Sokol HASIMLLARI		Kodet për teknologjinë e matjeve: T; Z; O; D	
Nënshkrimi _____		PËRCAKTIMI I KUFIRIT	
		Kodet për Përcaktimin e kufirit: P; K; HK	
REALIZOI PËR ASHK		SHËNIME TË VEÇANTA:	
Specialisti _____		Sipërfaqja që kërkohet të kalojë në përgjegjësi administrimi nga MIE, AAC tek MM,	
DVASHK _____		Forca Ajrore u përcaktua në vend në bashkpunim me specialistët e Forcës Ajrore, me qëllim ndërtimin e Stacionit Metrologjik Ushtarak	
Nënshkrimi _____		PRONARI/BASHKPRONARËT-DEKLARIM NË LIDHJE ME KUFITARËT	
KONFIRMIMI		MIRATOHET	
Përgjegjësi/Drejtori _____		DREJTORI I AUTORITETIT AVIACIONIT CIVIL	
Nënshkrimi/ Vula _____		Edlira KRAJA	
		Vule-Firme	



UDHËZIM
Nr. 245, datë 3.6.2021

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
PËR MARRJEN E INFORMACIONIT
DHE VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE E
TË DEKLARIMEVE NGA VENDI I
ORIGINËS PËR AZILKËRKUESIN
DHE REFUGJATIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, të pikës 3, të nenit 94, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me qëllim të zhvillimit të intervistave dhe marrjen e një vendimi përfundimtar, mbledh dhe përpunon të dhënat personale të kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, bën verifikimin e të dhënave që mbledhen gjatë aplikimit dhe intervistimit për mbrojtje ndërkombëtare, në institucionet shtetërore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me gjendjen e përgjithshme që mbizotëron në vendin e origjinës së kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare dhe kur është e nevojshme, edhe në vendet përmes të cilave ka qenë tranzit.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion pranë Drejtorisë për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të kërkuarit dhe/ose përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare. Drejtoria për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, brenda fushës së

kompetencës së kësaj drejtorie, me qëllim verifikimin e deklarimeve të kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare, për vendet përmes të cilave ka qenë tranzit. Kjo drejtori, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 10 ditëve pune, nga marrja e kërkesës.

5. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, kërkon informacion pranë Shërbimit Informativ të Shtetit, me qëllim mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve të kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatit dhe personit nën mbrojtje plotësuese. Shërbimit Informativ i Shtetit, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune, për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

6. Bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit mund të kryhet edhe me autoritetet homologe të cilat shprehin dakordësinë për çështje specifike ose të përgjithshme.

7. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët nuk mund t’u japë asnjë informacion aktorëve të mundshëm të persekutimit apo cenimit të rëndë ndaj kërkuarit, në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare, apo për faktin që një kërkesë e tillë është paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që do të rrezikonte integritetin fizik të kërkuarit, anëtarëve të familjes së tij ose lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët ende jetojnë në shtetin e origjinës.

8. Në përjashtim nga përcaktimi i bërë në pikën 7 mund të konsiderohet kërkim apo ndarje informacioni për personat në kërkim të mbrojtjes ndërkombëtare apo të përkohshme, me vendin ku kërkuari ka aplikuar ose ka kaluar tranzit para se të hynte në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim sigurimin e informacionit për të verifikuar dhe saktësuar, se:

a) kërkuari ka vënë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse të dhëna të vërteta;

b) kërkuari i rrezikohet seriozisht jeta në vendin e origjinës;

c) kërkuari nuk përbën rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

9. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të shkëmbejë me autoritetet ligjzbatuese të huaja të dhënat e mëposhtme:



a) të dhënat personale (emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, gjininë, shtetësinë, adresën e fundit të njohur në vendin e origjinës apo të tranzitit) të personit në fjalë dhe, nëse është e nevojshme, të dhënat personale të të afërmeve të tij të cilat janë deklaruar vetë nga kërkuesi;

b) të dhënat lidhur me dokumentet e identitetit të paraqitur nga vetë kërkuesi;

c) gjurmët daktiloskopike dhe fotografitë;

d) dokumente të tjera që janë paraqitur nga kërkuesi;

e) të dhënat lidhur mbi gjendjen gjyqësore, për aq sa kjo është e rëndësishme për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për aq sa personi në fjalë nuk rrezikohet. Përjashtim nga ky verifikim për çdo aplikues, bëjnë fëmijët nën moshën 12 (dymbëdhjetë) vjeç.

10. Gjurmët daktiloskopike dhe fotografia, të cilat administrohen nga Policia e Shtetit në bazën e të dhënave për të huajt, vihen në dispozicion të Autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët me kërkesën e këtij të fundit.

11. Informacioni në përputhje me klasifikimin e tij, mund të kërkohet apo të jepet me shkresë zyrtare.

12. Informacioni i mbledhur administrohet në dosjen personale të kërkuesit apo përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare.

13. Rregullat dhe procedura për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave dhe të deklarimeve nga vendi i origjinës për kërkuesin apo përfituesit të mbrojtjes ndërkombëtare, të parashikuara në këtë udhëzim, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat që kanë përfituar statusin e mbrojtjes së përkohshme.

14. Udhëzimi i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 645, datë 14.12.2015, “Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatën”, shfuqizohet.

15. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

UDHËZIM

Nr. 246, datë 3.6.2021

PËR PROCEDURËN DHE AFATIN PËR MARRJEN E VENDIMIT TË PUSHIMIT TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 6, të nenit 32, të ligjit nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vendos pushimin e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ndërprerja e procedurës, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 32, të ligjit nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kërkesa për tërheqjen e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare paraqitet me shkrim, pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, para përfundimit të afateve procedurale të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

3. Kërkuesi, i cili banon në Qendrën e Pritjes për Azil, mund ta paraqesë kërkesën me shkrim për tërheqje të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare edhe pranë kësaj qendre. Qendra e Pritjes për Azil, njofton menjëherë në mënyrë elektronike autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe përcjell kërkesën në rrugë zyrtare, brenda 3 (tri) ditëve nga depozitimi i saj. Kur Qendra konstaton se kërkuesi është larguar nga ambientet e akomodimit, njofton brenda ditës në formë elektronike Autoritetin.

4. Nëse autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, merr dijeni se kërkuesi është larguar nga Republika e Shqipërisë, njofton brenda ditës në mënyrë elektronike autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe e dërgon këtë informacion me shkresë brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni.

5. Vendimi i pushimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, merret nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në një mbledhje të posaçme me shumicë votash. Ai përpilohet me shkrim dhe është i arsyetuar.



6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët depoziton një kopje të këtij vendimi në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Brendshme, si dhe bën regjistrimin e tij në regjistrin elektronik, të kërkuarve dhe personave në mbrojtje ndërkombëtare.

7. Vendimi i pushimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare i komunikohet kërkuarit apo përfaqësuesit të tij ligjor, nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij vendimi.

8. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton autoritetin përgjegjës për kufirin dhe migracionin për vendimin e pushimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare brenda 5 (pesë) ditëve, nga marrja e këtij vendimi.

9. Udhëzimi i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 268, datë 2.6.2016, “Për procedurën dhe afatin për marrjen e vendimit të pushimit të shqyrtimit të aplikimit për azil në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, Qendra e Pritjes për Azil dhe autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

VENDIM
Nr. 26, datë 25.5.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Marsida Xhaferllari,	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji,	anëtare e “ “
Altin Binaj,	anëtar i “ “
Përparim Kalo,	anëtar i “ “
Sonila Bejtja,	anëtare e “ “
Elsa Toska,	anëtare e “ “

me sekretare Enina Kotoni, në datën 18.5.2021, mori në shqyrtim, në seancë plenare publike, çështjen nr. 2 (K) 2019, të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: KRYEMINISTRI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Elira Kokona, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska, me autorizim;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Mimoza Arbi, me autorizim.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Interpretimi i nenit 98, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 98, pika 1, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “ç” dhe 134, të Kushtetutës; nenet 27, 54, 55 dhe 56, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, që ka kërkuar pushimin e çështjes dhe nëse ajo shqyrtohet në themel, kërkon rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN
I

Rrethanat e çështjes

1. Kryeministri i Republikës së Shqipërisë (*Kryeministri*), në datën 31.12.2018, ka propozuar shkarkimin nga detyra të z. Ditmir Bushati, ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe po në të njëjtën datë ka paraqitur propozimin për emërimin e ministrit të ri, z. Gent Cakaj.

2. Presidenti i Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), me anë të shkresës nr. 16/1 prot., datë 10.1.2019, drejtuar Kryeministrit, ka refuzuar propozimin e këtij të fundit për emërimin e z. Cakaj në detyrën e ministrit për Evropën dhe



Punët e Jashtme. Ky refuzim është bërë pasi Presidenti ka kryer një proces verifikimi dhe ka arritur në përfundimin se z. Cakaj ka një mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative dhe shtetërore, në secilin element dhe në tërësi, duke mos krijuar besueshmëri, si dhe garancitë e nevojshme për ushtrimin me objektivitet dhe në lartësinë e kërkuar të detyrës tepër të rëndësishme të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Presidenti ka konstatuar se z. Cakaj ka mbajtur qëndrime publike për korrigjimin e kufijve të Kosovës dhe Serbisë, si dhe Ballkanit Perëndimor, të cilat janë në kundërshtim me programin e qeverisë për politikën e jashtme. Gjithashtu, Presidenti ka konstatuar se z. Cakaj ka ushtruar detyrën e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme për një periudhë 7-mujore pa pasur certifikatën përkatëse të sigurisë për njohjen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, certifikatë me të cilën është pajisur brenda 1 dite pune nga institucioni përgjegjës, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

3. Ndërkohë, Presidenti nuk është shprehur për shkarkimin e z. Ditmir Bushati nga detyra e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme brenda afatit 7-ditor të përcaktuar në nenin 98, pika 1, të Kushtetutës.

4. Kryeministri, në vijim, me shkresën nr. 208 prot., datë 14.1.2019, i ka përcjellë Presidentit propozimin që vetë Kryeministri të emërohet edhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Presidenti, me dekretin nr. 11061, datë 18.1.2019, ka shkarkuar z. Bushati nga detyra e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe, me dekretin nr. 11062, datë 18.1.2019, ka emëruar z. Edi Rama, Kryeministër, edhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Të dyja këto dekrete të Presidentit janë shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi në datën 21.1.2019, përkatësisht me vendimet nr. 19/2019 dhe nr. 20/2019.

6. Me urdhrin nr. 67, datë 23.1.2019, të botuar në Fletoren Zyrtare, Kryeministri i ka deleguar zëvendësministrit z. Cakaj disa kompetenca të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, të cilat ai i ka ushtruar deri në datën 29.12.2020, kur ka dhënë dorëheqjen nga detyra.

7. Në mbledhjen e datës 5 dhjetor të vitit 2018, Këshilli Ministerial i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kishte vendosur

që Shqipëria të merrte kryesimin e OSBE-së për vitin 2020, kompetencë e cila është ushtruar nga ana e Kryeministrit, në funksionin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

8. Kryeministri, në datën 8.2.2019, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit. Pas plotësimit të kuorumit për funksionimin e kolegjeve seleksionuese të Gjykatës, në datën 19.12.2019, është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Gjithashtu, me përmbushjen e parashikimit të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare, është bërë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. *Kryeministri* ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet tij dhe Presidentit, si dhe interpretimin e nenit 98, pika 1, të Kushtetutës, duke pretenduar, në mënyrë të përmblëdhur:

9.1 Në rastin konkret janë plotësuar kriteret e legjitimitetit, në përputhje me nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës dhe nenet 54–56, të ligjit nr. 8577/2000. Konkretisht, mosmarrëveshja është krijuar midis dy organeve kushtetuese të ndryshme, si dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Propozimi i ri i bërë nga Kryeministri nuk e zgjidh konfliktin dhe as nuk tregon pranimin nga ana e tij të argumenteve të Presidentit për refuzimin e kandidaturës së z. Cakaj.

9.2 Veprimet e ndërmarra nga ana e institucionit të Presidentit kanë krijuar një mosmarrëveshje të mirëfilltë kompetencash për sferën, natyrën dhe kufijtë e ushtrimit të kompetencave të Kryeministrit, Presidentit dhe Kuvendit në procesin e propozimit, emërimit ose shkarkimit të ministrit. Kjo për arsye se Presidenti, duke mos nxjerrë dekretin përkatës për kandidaturën e propozuar nga Kryeministri, ka ndërhyrë në të drejtën e këtij të fundit për të propozuar një ministër dhe ka bllokuar procedurën e plotësimit të vendeve vakante në kabinetin qeveritar.

9.3 Gjithashtu, Presidenti nuk ka shprehur vullnetin as për propozimin e Kryeministrit për shkarkimin e z. Bushati si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke penguar Kryeministrin



në ushtrimin e kompetencave të tij. Për më tepër, Presidenti e ka nxjerrë dekretin për shkarkimin e z. Bushati tej afatit kushtetues.

9.4 Presidenti e ka vlerësuar kandidatin e propozuar nga Kryeministri nga pikëpamja politike dhe meritokratike, ndërkohë që ky lloj vlerësimi substancial bëhet nga Kuvendi. Kompetenca e Presidentit për emërimin e ministrit është formalisht presidenciale, një kompetencë solemniteti dhe jo kompetencë thelbësore e tij. Ajo mbetet kompetencë thelbësore e organeve që realizojnë drejtimin politik dhe që kanë marrë përsipër qeverisjen e vendit përmes votës së popullit, konkretisht e Kryeministrit dhe Kuvendit. Presidenti duhet të shprehë vullnetin nëpërmjet dekretimit të kandidaturës së përzgjedhur e propozuar nga Kryeministri dhe nuk duhet të vlerësojë cilësitë dhe aftësitë e kandidatit. Kushtetuta e ka konceptuar rolin e Presidentit si një vlerësues formal të kandidaturës së propozuar për ministër, vetëm për ato kushte që Kushtetuta kërkon për deputetin, prandaj Presidenti kushtëzohet të vlerësojë, vetëm nëse kandidatura bie ndesh me kriteret që duhet të plotësojë një deputet. Gjatë seancës, përfaqësuesi i Kryeministrit është shprehur se Presidenti është i detyruar të nxjerrë dekretin, pasi nuk ka kompetenca verifikuese as në aspektin formal.

9.5 Parimi i kooperimit institucional dhe luajalitetit kushtetues kërkon që organet kushtetuese të përfshira në proces të mos ndërhyjnë në kompetencat e organeve të tjera, të bashkëpunojnë reciprocisht dhe pa bllokime institucionale. Presidenti nuk është konsultuar paraprakisht me Kryeministrin për rishikimin e kandidaturës së ministrit të propozuar dhe nuk i ka lënë hapësirë Kryeministrit për konsultim ose bashkëpunim të mëtejshëm, por vetëm ka refuzuar propozimin e tij. Ndërsa, gjatë seancës plenare përfaqësuesi i Kryeministrit është shprehur në lidhje me parimin e luajalitetit, se neni 98 i Kushtetutës, qartësisht, nuk parashikon asnjë hap konsultimi paraprak gjatë, pas ose përpara propozimit.

9.6 Mënyra e vetme e reagimit të Presidentit, në rastin konkret, duhej të ishte nxjerrja e dekretit për emërimin e ministrit. Refuzimi i propozimit të Kryeministrit, për më tepër me shkresë, nuk hyn në atributet kushtetuese të Presidentit, por mund të bëhet vetëm nga Kuvendi. Presidenti, si pjesë e

këtij procesi, ka detyrimin kushtetues të shprehet për propozimet e paraqitura nga Kryeministri nëpërmjet nxjerrjes së dekretit, si i vetmi akt i shprehjes nga pikëpamja formale të kompetencës së tij.

10. **Subjekti i interesuar, Presidenti**, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

10.1 Në rastin konkret nuk ka më një mosmarrëveshje konkrete dhe as aktuale, për arsye se përcjellja e propozimit të ri të Kryeministrit për emërimin e tij si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, dekretimi nga Presidenti dhe miratimi i dekretit nga Kuvendi, së bashku me miratimin e dekretit për shkarkimin e z. Bushati, ka shteruar, sipas jurisprudencës kushtetuese, interpretimin dhe zbatimin e dispozitës kushtetuese objekt shqyrtimi. Në këto kushte, jemi përpara mungesës faktike të një mosmarrëveshjeje kompetence dhe mungesës së një konflikti, prandaj Gjykata duhet ta pushojë çështjen.

10.2 Presidenti, në ushtrim të përgjegjësi të tij kushtetuese, ka treguar në mënyrë të vazhdueshme vullnet për bashkëpunim dhe ka respektuar parimin e luajalitetit kushtetues. Kështu, gjatë takimit të zhvilluar me Kryeministrin, në datën 4.1.2019, Presidenti i ka shprehur atij shqetësimet e tij për emërimin e z. Cakaj në postin e rëndësishëm të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndërkohë që Kryeministri nuk i është përgjigjur me sqarime ose kundërgjegjësi shkresës nr. 16/1 prot., datë 10.1.2019, të Presidentit, ku jepeshin arsyet për refuzimin e propozimit dhe kërkohej vijimi i konsultimit mes Presidentit dhe Kryeministrit, por me një propozim të ri. Ai është treguar bashkëpunues duke dekretuar gjatë muajit janar 2019, brenda afatit kushtetues, propozimet përkatëse të shkarkimit dhe emërimit të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, Presidenti, me shkresën nr. 16/2 prot., datë 11.1.2019, i ka kërkuar Kuvendit ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për hetimin e veprimtarisë së DSIK-së në procesin e pajisjes me certifikatë sigurie të z. Cakaj, shkresë për të cilën nuk ka marrë përgjigje.

10.3 Presidenti, në ushtrimin e kompetencës së tij për emërimin e një ministri: “kryen një vlerësim kushtetues”, që shkon përtej kompetencës propozuese të Kryeministrit, i cili realizon një proces vlerësimi politik. Në këto raste, vlerësimi i Presidentit, duke qenë i paanshëm politikisht,



përmbush një qëllim më të madh e më të përgjithshëm sesa ai politik i qeverisë, për të siguruar emërimin e kandidaturave që krijojnë bindjen e plotë se interesi kombëtar nuk do të cenohet. Pas kryerjes së verifikimit, Presidenti ka vërejtur se profili i kandidaturës së z. Cakaj paraqiste mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative dhe shtetërore në secilin element dhe në tërësi, argumente të paraqitura edhe në shkresën nr. 16/1 prot., datë 10.1.2019, me anë të së cilës ka refuzuar, brenda afatit 7-ditor të parashikuar nga Kushtetuta, propozimin për emërimin e z. Cakaj, si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

10.4 Presidenti, si zotërues i detyrimit kushtetues substancial dhe jodeklarativ, ka vepruar sipas bindjes së brendshme se propozimi nuk e justifikonte interesin publik dhe kombëtar, unitetin kombëtar dhe sigurinë e vendit. Duke pasur parasysh që, në momentin e emërimit të tij, Shqipëria pritej të merrte kryesimin e OSBE-së, si dhe mungesën e përvojës në ushtrimin e detyrave të larta shtetërore dhe diplomatike të kandidatit, kjo mund të shkaktonte pasoja negative afatgjata dhe të pariparueshme për vendin, për rajonin, si dhe për faktorin ndërkombëtar. Për shkak të rolit që Presidenti ka në marrëdhëniet ndërkombëtare, përfaqësimin e vullnetit shtetëror jashtë vendit dhe misionit të tij kryesor të përfaqësimit të unitetit të popullit, ai e ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme propozimin e Kryeministrit për postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

10.5 Dekreti për emërimin e ministrit nuk është thjesht një akt administrativ formal dhe as një procedurë solemniteti, por një akt i shprehjes së vullnetit dhe afirmim i marrjes së detyrës për ushtrimin e funksionit. Në këtë kontekst, Presidenti nuk ka funksion deklarativ, formal ose honorifik në vendimmarrje, për të qenë gjithnjë në dakordësi me autoritetin propozues, por në cilësinë e kreut të shtetit, si garant i unitetit dhe sigurisë kombëtare, duhet të shqyrtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse çdo kandidaturë të propozuar. Dekreti për shkarkimin e ish-ministrit, z. Bushati, është nxjerrë tej afatit kushtetues, pasi, në kushtet kur nuk është bërë zëvendësimi i tij me një ministër tjetër të jashtëm, ministri Bushati ka vazhduar të qëndrojë në detyrë derisa Presidenti të shprehej me dekret për shkarkimin e tij, bashkë me dekretimin e propozimit të ri të Kryeministrit.

11. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

11.1 Në rastin konkret ka një mosmarrëveshjeje kompetencash midis organeve kushtetuese që u përkasin pushteteve të ndryshme dhe janë plotësuar kushtet e legjitimitit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000.

11.2 Sipas jurisprudencës kushtetuese, dekreti i Presidentit për emërimin ose shkarkimin e ministrit është akt individual i nxjerrë nga organi kompetent, i cili hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi. Mënyra e vetme me të cilën duhet të shprehet Presidenti është nxjerrja e dekretit për emërimin e ministrit dhe jo refuzimi i propozimit të Kryeministrit përmes një shkrese, gjë e cila nuk është e parashikuar në Kushtetutë. Refuzimi i kandidaturës së një ministri bëhet vetëm nga Kuvendi. Mosushtimi i kompetencës për dekretimin e ministrit nga Presidenti e ka bërë të pamundur ushtrimin e kompetencës vlerësuese të Kuvendit për miratimin ose jo të ministrit të propozuar. Në kuadër të bashkëpunimit paraprak midis Presidentit dhe Kryeministrit, në lidhje me propozimet për ministër, nëse *konstatohet një shkak ndalimi për kandidaturën e paraqitur, shkakun mënjanohet, por asnjëherë Presidenti nuk mund të mos shprehet me dekret*.

11.3 Kuvendi, kur shqyrton dekretin e Presidentit, të nxjerrë në përputhje me pikën 2 të nenit 98 të Kushtetutës, nuk kufizohet vetëm në kontrollin formal të tij, por bën edhe një kontroll substancial, sepse ky lloj shqyrtimi ka natyrë politike dhe është i ngjashëm me kontrollin që ushtrohet në kuadrin e një mocioni mosbesimi ose besimi. Në rastin konkret, Presidenti, duke vlerësuar kandidaturën në këndvështrimin politik dhe meritokratik, ka zëvendësuar institucionin e Kuvendit. Roli i Presidentit në emërimin/shkarkimin e një ministri është vetëm akt formal dhe solemn. Kryerja e një vlerësimi politik dhe meritokratik i kandidatit të propozuar për ministër nga ana e Presidentit është tejkalim i funksioneve dhe cenim i kompetencave të Kryeministrit dhe Kuvendit, në kundërshtim me parimet e kooperimit institucional dhe luajalitetit kushtetues. Në parashtrimet gjatë seancës plenare, përfaqësuesi i Kuvendit është shprehur se Presidenti mund të bëjë vlerësim të kriterëve formale të kandidaturës së propozuar, por jo një vlerësim të natyrës substancial.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës

12. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Kjo kompetencë e Gjykatës trajtohet hollësisht në nenet 54–56, të ligjit nr. 8577/2000, ku parashikohet se Gjykata shqyrton konfliktet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Ajo merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe, sipas rastit, kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta. Në përfundim, Gjykata vendos se cilit organ të pushtetit i përket kompetenca për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Në këto raste është e domosdoshme të ketë një mosmarrëveshje konkrete, pasi zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto* (shih vendimet nr. 4, datë 1.2.2015; nr. 36, datë 1.6.2015; nr. 54, datë 5.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

13. Një mosmarrëveshje kompetence, që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën Kushtetuese përqendrohet pikësepari në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës, për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues, duke gjetur dhe cilësuar të papajtueshëm me Kushtetutën shkaku vendimtar që ka sjellë lindjen e mosmarrëveshjes (shih vendimin nr. 36, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në jurisprudencë të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se konflikti i kompetencave mund të ekzistojë nëse dy organe/pushtete pretendojnë ushtrimin e së njëjtës kompetencë ose kur asnjëri prej dy organeve/pushteteve nuk merr përsipër ushtrimin e një kompetence (shih vendimet nr. 12, datë 20.5.2008; nr. 20, datë 4.5.2007; nr. 26, datë 4.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese). Nisur nga ky

qëndrim, mosmarrëveshja e kompetencës mund të shtrohet në dy plane: njëri plan lidhet me rastin kur objekt i mosmarrëveshjes është ndërhyrja me akt normativ në kompetencat e një organi kushtetues, duke sjellë si pasojë pakësimin ose shtimin e kompetencave të tij. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in abstracto* nëse ky ndryshim i kompetencave ka cenuar parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Një plan tjetër është rasti kur konflikti i mirëfilltë i kompetencave lidhet me faktin kur një ose disa organe nxjerrin akte që cenojnë sferën e kompetencave të organit tjetër. Në këtë rast, objekt i mirëfilltë i gjykimit kushtetues është vlerësimi *in concreto* nëse akti ka prekur kompetencat e një organi tjetër (shih vendimin nr. 41, datë 19.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

15. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se përveç hipotezave të mësipërme, konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk e kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre (shih vendimet nr. 48, datë 8.11.2011; nr. 22, datë 5.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

16. Në mënyrë që të arrihet në një përfundim, lidhur me ekzistencën ose jo të mosmarrëveshjes së pretenduar, Gjykata analizon se midis cilave organe ka lindur konflikti, cila është kompetenca që ushtrohet nga organi tjetër dhe në ç'mënyrë pengohet ushtrimi i saj ose në ç'mënyrë një organ e ushtron pa të drejtë një kompetencë të një organi tjetër (shih vendimin nr. 54, datë 5.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

17. Në rastin konkret, Kryeministri ka pretenduar se ka një mosmarrëveshje kompetencash midis dy organeve kushtetuese, Kryeministrit dhe Presidentit, e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre, sipas nenit 98 të Kushtetutës. Sipas tij, ndodhemi përpara një problemi kushtetues, i cili kërkon interpretimin e normës kushtetuese në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes konkrete.

18. Presidenti ka prapësuar se kërkesa është pa objekt, pasi nuk kemi më një mosmarrëveshje konkrete dhe as aktuale, për arsye se përcjellja e propozimit të ri të Kryeministrit për emërimin e tij si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, dekretimi nga Presidenti dhe miratimi i dekretit nga Kuvendi, së bashku me miratimin e dekretit për



shkarkimin e z. Bushati ka shteruar, sipas jurisprudencës kushtetuese, interpretimin dhe zbatimin e dispozitës kushtetuese objekt shqyrtimi. Në këto kushte, jemi përpara mungesës faktike të një mosmarrëveshjeje kompetence dhe mungesës së një konflikti, prandaj Gjykata duhet ta pushojë çështjen.

19. Kuvendi në seancë ka pretenduar se në rastin konkret jemi përpara një mosmarrëveshjeje kompetencash midis organeve kushtetuese, Kryeministrit dhe Presidentit, dhe në çështjen në shqyrtim Kuvendit i është cenuar ushtrimi i kompetencës së tij për shqyrtimin e dekretit dhe miratimin e ministrit të propozuar nga Kryeministri.

20. Gjykata konstaton se në momentin e paraqitjes së kërkesës, postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme e mbante Kryeministri, z. Edi Rama. Ai ka filluar ta ushtrojë këtë detyrë që nga data 21.1.2019, datë në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi dekreti i Presidentit për emërimin e tij në këtë pozicion, deri në datën 31.12.2020. Gjatë kësaj periudhe, një pjesë e kompetencave të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme janë ushtruar me delegim nga zëvendësministri, z. Cakaj.

21. Gjykata, bazuar në sa më sipër dhe në rrethanat faktike të çështjes, konstaton se në rastin konkret, gjatë procesit, Kryeministri dhe Presidenti kanë vepruar dhe i kanë dhënë kuptim të ndryshëm kompetencës për emërimin dhe shkarkimin e ministrit, sipas nenit 98, pika 1, të Kushtetutës. Për shkak të veprimeve të këtyre dy organeve, Kuvendit nuk i është dhënë mundësia të shqyrtojë dekretin e Presidentit, sipas nenit 98, pika 2, të Kushtetutës. Duke qenë se organet kushtetuese të përfshira në proces i kanë dhënë kuptim të ndryshëm kompetencave të përcaktuara në nenin 98 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se midis Kryeministrit, Presidentit dhe Kuvendit ka lindur një mosmarrëveshje kompetencash e natyrës kushtetuese.

22. Pavarësisht sa më sipër në momentin e gjykimit të çështjes, Gjykata çmon se nuk ka më konflikt konkret kompetencash, për arsye se procedura e filluar nga palët për emërimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme është realizuar. Në këto kushte, nuk ka më një mosmarrëveshje konkrete kompetencash për të zgjidhur, prandaj Gjykata vlerëson ta pushojë

gjykimin, për sa i përket kërimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kryeministrit dhe Presidentit.

23. Megjithëse mosmarrëveshja e kompetencës, zgjidhja e së cilës është kërkitimi i parë objekt shqyrtimi, është shuar përpara se Gjykata ta shqyrtonte dhe të jepte vendim për të, Gjykata vlerëson se duhet të vazhdojë gjykimi i kërimit tjetër për interpretimin e nenit 98, pika 1, të Kushtetutës, pasi jo vetëm ka ekzistuar një mosmarrëveshje kompetencash për kuptimin e kësaj dispozite kushtetuese, por, mbi të gjitha, kuptimi i saktë i nenit 98 të Kushtetutës garanton qeverisjen e vendit pa përplasje midis institucioneve kushtetuese që kanë kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e ministrit. Për pasojë, Gjykata çmon se vazhdimi i gjykimit të këtij kërkitimi paraqet interes publik për qytetarët në drejtim të qeverisjes dhe interes shtetëror për organet shtetërore që veprojnë në këtë proces. Këtë vlerësim Gjykata e mbështet edhe në frymën e ligjit nr. 8577/2000, i cili, pas ndryshimeve në vitin 2016, si në rastet e heqjes dorë nga kërkesa ose shfuqizimit ose ndryshimit të ligjit/aktit normativ para se Gjykata të marrë vendim, parashikon se kjo e fundit mund të vendosë vazhdimin e gjykimit, nëse çështja ka interes publik ose shtetëror.

B. Për interpretimin përfundimtar të nenit 98 të Kushtetutës

24. Neni 98 i Kushtetutës parashikon: “1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. 2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.”.

25. Gjykata vëren se kjo dispozitë kushtetuese rregullon procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, në të cilin marrin pjesë tri organe kushtetuese. Nga pikëpamja kohore ky proces vihet në lëvizje nga Kryeministri, zhvillohet nga Presidenti dhe përmbyllet nga Kuvendi. Ndërsa, në këndvështrim të termave specifike për veprimet që kryen secili organ kushtetues në këtë proces, neni 98 i Kushtetutës i emërton me radhë: Kryeministri “propozon ministrin”, Presidenti “emëron dhe shkarkon ministrin” dhe Kuvendi “shqyrton dekretin”. Po ashtu, Gjykata është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës



duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa më lart, Gjykata do të interpretojë nenin 98 të Kushtetutës, për t'i dhënë zgjidhje çështjes së shtrirjes së kompetencave të secilit prej tri organeve kushtetuese të përfshira në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, si dhe mënyrës së ushtrimit të tyre në raport me rolin e tyre kushtetues.

27. Lidhur me rolin dhe kompetencat e Kryeministrit, Gjykata vëren se, bazuar në nenin 102 të Kushtetutës, ai është organi që përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij, koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to, siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje. Kryeministri ka, gjithashtu, kompetenca propozuese në emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të veçantë të Këshillit të Ministrave, sipas nenit 98 të Kushtetutës, për të siguruar vazhdimësinë dhe mirëfunksionimin e qeverisë gjatë mandatit qeverisës. Ai ka përgjegjësinë të iniciojë procesin e shkarkimit të ministrit dhe të emërimit të ministrit të ri, duke përzgjedhur e propozuar kandidatin që ai e gjykon të përshtatshëm për të ushtruar funksionin e ministrit në Këshillin e Ministrave.

28. Kryeministri ka rol parësor në formimin e qeverisë në fillim të mandatit qeverisës dhe ka përgjegjësi politike kundrejt Kuvendit, përgjegjësi e cila është e lidhur ngushtë me veprimtarinë e Këshillit të Ministrave. Ky rol i rëndësishëm i Kryeministrit mbështetet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës, e cila, në vështirim të neneve 95, 96, 97, 100 dhe 102 të Kushtetutës, ka pohuar se Kryeministri i emëruar nga Presidenti ka detyrimin që brenda 10 ditëve të paraqesë për miratim programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij. Programi politik dhe

përbërja e Këshillit të Ministrave, përfshirë edhe Kryeministrin, i nënshtrohen kontrollit parlamentar, si kusht për dhënien e besimit politik (*shih vendimin nr. 28, datë 21.2.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa i përket rolit dhe kompetencave të Presidentit, i cili është kreu i shtetit, kushtetutëbërësi i ka përcaktuar ato në mënyrë të detajuar në nenet 86, 89, 92 dhe 94 të Kushtetutës, si dhe në fusha specifike, siç janë sigurua kombëtare (neni 168), Forcat e Armatosura (nenet 168–169), formimi i qeverisë (neni 96), si dhe emërimi e shkarkimi i ministrave (neni 98). Presidenti, bazuar në nenin 96 të Kushtetutës, ka kompetenca për formimin fillestar të qeverisë, në fillim të legjislaturës, duke emëruar Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend. Kryeministri i emëruar i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij (neni 97 i Kushtetutës). Gjithashtu, sipas nenit 98 të Kushtetutës, Presidenti ka kompetencën të emërojë dhe shkarkojë me dekret ministrin me propozim të Kryeministrit, gjatë periudhës qeverisëse.

30. Gjykata, për sa i përket pozicionit kushtetues të Presidentit, ka theksuar se, sipas neneve 89, 90, pika 1 dhe 94, të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private, nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të (*shih vendimin nr. 10, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e tij si përfaqësues i unitetit të popullit është të mbikëqyrë funksionimin normal të mekanizmave kushtetues, duke ndërhyrë për eliminimin e mangësive në këtë drejtim (*shih vendimin nr. 76, datë 25.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*). Presidentit i është dhënë roli i Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (FA) për shkak të pozitës së tij si organ jopolitik dhe përfaqësues i unitetit të popullit, në funksion të garantimit të parimeve themelore kushtetuese në sferën e mbrojtjes. Për shkak të pozicionit të tij *super partes*, Presidenti nuk mund të jetë komandant efektiv ushtarak i FA-ve, por, nga ana tjetër, roli i tij kushtetues si Komandant i Përgjithshëm i FA-ve nuk mund të konsiderohet si



honorifik. Kushtetuta i ka atribuuar Presidentit një funksion garantues në fushën e sigurisë kombëtare (neni 168, pika 3). Presidenti ka një rol të rëndësishëm në sistemin e karrierës ushtarake të oficerëve madhorë dhe në respektim të parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve, si dhe parimit të asnjësisë politike të FA-ve (*shih vendimet nr. 10, datë 26.2.2015; nr. 64, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Edhe Komisioni i Venecies është shprehur: “Kushtetuta i cakton Presidentit një pozicion neutral si “kreu i shtetit” dhe si organi që “përfaqëson unitetin e popullit”. Këtotribute nuk nënkuptojnë që autoriteti i Presidentit është mbi politikën. Ato më saktë nënkuptojnë që Presidenti duhet të mbetet jashtë politikës partiake, me qëllim që të sigurojë, ndër të tjera, një konkurrencë të ndershme midis palëve dhe funksionimin e rregullt të formës së qeverisjes dhe të veprimtarive të tjera të shtetit (...) një President, misioni kryesor i të cilit është përfaqësimi i unitetit të popullit, ka mandatin kushtetues për të kontribuar në funksionimin normal të shtetit” (*shih Opinionin e Komisionit të Venecies për Shqipërinë të titulluar “Për kompetencat e Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve”, CDL-AD (2019) 019, datë 14 tetor 2019, § 40, § 41, § 55*).

32. Për sa i përket rolit dhe kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Kushtetuta ka parashikuar se Shqipëria është republikë parlamentare dhe populli e ushtron sovranitetin që i përket nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërdrejt (*neni 1, pika 1 dhe neni 2, i Kushtetutës*). Funksioni kryesor i Kuvendit është procesi ligjvënës i sanksionuar në nenet 81–83 të Kushtetutës, që konkretizohet me miratimin e ligjeve dhe plotësimin e kuadrit kushtetues dhe ligjor të nevojshëm për funksionimin demokratik të shtetit. Sipas nenit 98 të Kushtetutës, Kuvendi ka kompetencën e shqyrtimit të dekretit të Presidentit, si për emërimin e ministrit, ashtu edhe për shkarkimin e tij. Ky lloj dekreti bëhet objekt vlerësimi nga Kuvendi, i cili më pas merr një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e tij.

33. Kuvendi, krahas funksionit legjislativ, ushtron kompetenca të rëndësishme kontrolli ndaj ekzekutivit dhe ndaj akteve të Presidentit. Baza e përgjegjësisë parlamentare është raporti që krijohet në marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit dhe qeverisë. Kuvendi jo vetëm kontrollon qeverinë, por, në çdo

kohë, miraton edhe raporte ose rezoluta të veçanta instruktive për të. Veprimtaria e Kuvendit lidhet, gjithashtu, me funksionin e tij zgjedhës, siç është zgjedhja e disa prej funksionarëve më të lartë të shtetit, si dhe me funksionin e formimit të vullnetit politik kur përplasen vullnetet politike të forcave të ndryshme parlamentare (*shih vendimet nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 18, datë 14.5.2003; nr. 6, datë 18.1.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Si përfundim, në analizë të rolit të secilit organ kushtetues, Gjykata vlerëson se neni 98 i Kushtetutës e trajton emërimin dhe shkarkimin e ministrit si proces të përbashkët, në të cilin marrin pjesë Kryeministri, në cilësinë e drejtuesit të pushtetit ekzekutiv, Presidenti, si organ kushtetues i pavarur dhe Kuvendi, në cilësinë e organit të pushtetit legjislativ. Në këtë vështrim, kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e ministrit, sipas nenit 98 të Kushtetutës, ndahet ndërmjet këtyre tri organeve, pra Kryeministrit, Presidentit dhe Kuvendit, sipas rolit përkatës që Kushtetuta i ngarkon secilit prej tyre.

B.1 Për parimet që rregullojnë procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, sipas nenit 98 të Kushtetutës

35. Gjykata vlerëson të ndalet në vijim te parimet mbi bazën e të cilave të tria organet e mësipërme kushtetuese ushtrojnë kompetencat në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, sipas nenit 98 të Kushtetutës. Për të kryer këtë vlerësim ajo do të bazohet në dy parime kryesore: *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve* dhe *parimin e luajalitetit kushtetues*. Gjykata ka theksuar se krijimi i raporteve të balancuara ndërmjet pushteteve duhet të orientohet nga standardi kushtetues i bashkëpunimit. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet tyre (*shih vendimin nr. 10, datë 6.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

B.1.1 Për parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve

36. Palët në këtë gjykim kanë pranuar se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve zbatohet në këtë proces, duke qenë se emërimi dhe shkarkimi i ministrit është një proces i përbashkët mes Kryeministrit (pushtet ekzekutiv), Presidentit (organ kushtetues i pavarur), si dhe Kuvendit (pushtet legjislativ).

37. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Gjykata në



jurisprudencën e saj, lidhur me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ka theksuar se ky parim në demokraci si formë e qeverisjes synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi ose të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Çdo organ kushtetues dhe pjesë përbërëse të tij kanë detyrimin t'i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve të vendit. Prandaj konsiderohet domosdoshmëri që parimi i ndarjes së pushteteve, pavarësisht ndryshimit të forcave politike në pushtet, të mbetet mbizotërues dhe të mos cedojë për arsye të papërligjura. Në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutëbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij. Ky parim shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit, ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet nr. 41, datë 16.5.2017; nr. 23, datë 24.4.2015; nr. 24, datë 9.6.2011; nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata çmon se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve zbatohet duke pasur parasysh se secili nga organet kushtetuese që janë të përfshira në procesin e emërimit dhe shkarkimit të ministrit nuk i përkasin të njëjtit pushtet, që do të thotë se Kushtetuta u ka dhënë atyre kompetenca të ndara. Prandaj, caktimi i kompetencave organeve kushtetuese, të pavarura nga njëra-tjetra, shpreh ndarjen e pushteteve, ndërsa bashkëveprimi midis tyre, garanton balancën në ushtrimin e pushtetit. Balancimi i pushteteve, teksa kërkon ekuilibrim të kompetencave, nuk do të thotë që pesha dhe kompetenca e organeve është e njëjtë. Ai ka të bëjë me faktin se struktura institucionale shtetërore bazohet në ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, ndarje e cila tregon vendin

që kushtetutëbërësi ka dashur t'i japë secilit prej tyre në përmbushjen e rolit përkatës. Nuk mund të pranohet që një organ t'i shtrijë kompetencat e tij në dëm të tjetrit. Pra, Kushtetuta ka krijuar një sistem për ndarjen e kompetencave midis organeve të ndryshme, i cili i cakton secilit rolin e tij në strukturën institucionale shtetërore dhe në realizimin e detyrave që i janë besuar.

39. Më konkretisht, veprimet respektive të propozimit, emërimit dhe shkarkimit me dekret, si dhe shqyrtimit të dekretit, të kryera me radhë nga Kryeministri, Presidenti dhe Kuvendi, përfaqësojnë elemente të parimit të ndarjes dhe ekuilibrit institucional, që kërkohet nga neni 98 i Kushtetutës. Kryeministri, si përgjegjës për qeverisjen e vendit dhe veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, ka kompetencën e propozimit të ministrit. Përfshirja e Presidentit, si kreu i shtetit dhe figurë neutrale në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, ka për qëllim balancimin e këtij procesi, pasi Kryeministri dhe Kuvendi janë organe me natyrë të mirëfilltë politike. Po kështu, pjesëmarrja e Kuvendit në këtë proces, nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të dekretëve të Presidentit, balancon kompetencën e Kryeministrit dhe të Presidentit në emërimin dhe shkarkimin e ministrit, si dhe vesh të gjithë procesin me legjitimitetin e nevojshëm politik në kushtet e një republike parlamentare. Qëllimi i Kushtetutës ka qenë pikërisht përfshirja në proces e të tria institucioneve, duke vepruar secili në ushtrimin e kompetencës për pjesën që i përket, sipas rolit kushtetues.

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se Kryeministri, Presidenti dhe Kuvendi në procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit duhet të udhëhiqen nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, në përputhje me qëllimin e nenit 98 të Kushtetutës.

B.1.2 Për parimin e luajalitetit kushtetues

41. Kryeministri ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur në kërkesë se parimi i kooperimit institucional dhe luajalitetit kushtetues kërkon që organet kushtetuese të përfshira në proces të mos ndërhyjnë në kompetencat e organeve të tjera, të bashkëpunojnë reciprocisht dhe pa bllokime institucionale, gjë e cila, sipas tij, nuk ka ndodhur në rastin konkret, pasi Presidenti nuk është konsultuar paraprakisht me Kryeministrin për rishikimin e kandidaturës së ministrit të propozuar



dhe nuk i ka lënë atij hapësirë për konsultim ose bashkëpunim të mëtijshëm. Ndërsa, gjatë seancës plenare përfaqësuesi i Kryeministrit u shpreh në lidhje me parimin e luajalitetit se neni 98 i Kushtetutës së Shqipërisë qartësisht nuk parashikon asnjë hap konsultimi paraprak, gjatë, pas ose përpara propozimit. Sipas tij, nëse në traditën institucionale krijohen praktika të konsoliduara për veprime të caktuara midis institucioneve, kjo nuk mund që të kthehet në një parametër kushtetues.

42. Presidenti ka argumentuar se në ushtrim të përgjegjësisë të tij kushtetuese, sipas nenit 98 të Kushtetutës, ai ka treguar në mënyrë të vazhdueshme vullnet për bashkëpunim dhe ka respektuar parimin e luajalitetit kushtetues. Konkretisht, ai ka shpjeguar se gjatë takimit të zhvilluar me Kryeministrin, në datën 4.1.2019, të bërë publik në media, i ka shprehur këtij të fundit shqetësimet e tij për emërimin e z. Cakaj në postin e rëndësishëm të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ndërkohë që Kryeministri nuk i është përgjigjur me sqarime shkresës nr. 16/1 prot., datë 10.1.2019, të Presidentit, ku jepeshin arsyet për refuzimin e propozimit dhe kërkohej vijimi i konsultimit mes Presidentit dhe Kryeministrit. Presidenti është treguar bashkëpunues, duke dekretuar, gjatë muajit janar 2019, propozimet e shkarkimit dhe të emërimit të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave.

43. Gjithashtu, Presidenti, gjatë parashtrimeve të tij në seancë plenare, ka argumentuar se edhe në rastin e ish-ministrit të Brendshëm, z. Lleshaj, pasi është dekretuar shkarkimi i ministrit paraardhës, Presidenti është shprehur me shkresë drejtuar Kryeministrit, ku janë paraqitur disa ndalime kushtetuese që pengonin emërimin e z. Lleshaj si ministër i Brendshëm. Në atë rast Kryeministri dhe Presidenti kanë bashkëpunuar institucionalisht për të verifikuar të gjitha shqetësimet e Presidentit dhe për të shmangur të gjitha ndalimet kushtetuese që pengonin emërimin e z. Lleshaj në postin e ministrit të Brendshëm.

44. Kuvendi ka parashtruar se Presidenti dhe Kryeministri duhet të bashkëpunojnë paraprakisht, në lidhje me propozimet për ministër të kabinetit qeveritar, në kuadër të parimit të luajalitetit. Nëse *konstatohet një shkak ndalimi për kandidaturën e paraqitur, në respektim të parimit të luajalitetit, shkakun mënjanohet, por asnjëherë Presidenti nuk mund të mos*

shprehet me dekret. Kryerja e një vlerësimi politik dhe meritokratik të kandidatit të propozuar për ministër nga ana e Presidentit është tejkalim i funksioneve dhe cenim i kompetencave të Kryeministrit, në kundërshtim me parimin e kooperimit institucional dhe luajalitetin kushtetues.

45. Gjykata do të shqyrtojë në vijim parimin e luajalitetit kushtetues në këndvështrim të nenit 98 të Kushtetutës, duke iu referuar faktit të mosmarrëveshjes që ka ekzistuar midis palëve. Ndonëse Kushtetuta nuk e përmban në mënyrë të shprehur parimin e luajalitetit kushtetues, ky parim i rëndësishëm është zhvilluar nga Gjykata, e cila në jurisprudencën e saj në vazhdimësi, kur është shtruar çështja e bashkëpunimit mes institucioneve, është shprehur se sistemi i emërimit të gjyqtarëve të lartë, i përcaktuar nga Kushtetuta, ka në esencë kooperimin institucional të Presidentit dhe të Kuvendit. Ky sistem emërimi i vë subjektet që përfshihen në të para kërkesës së respektimit të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili shpreh, në thelb, respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Në këtë aspekt, u takon këtyre dy organeve që gjatë këtij procesi të shmangin çdo pengesë institucionale ose ligjore (*shih vendimet nr. 41, datë 19.7.2012; nr. 24, datë 9.6.2011; nr. 2, datë 18.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Nën dritën e këtij parimi, Kushtetuta parashikon marrëdhënie shumëpalëshe midis organeve kushtetuese, ku mund të përfshihen edhe procese që përmbajnë instrumente të tilla si: marrja e mendimit, këshillimi ose dhënia e pëlqimit. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se parimi i bashkëpunimit luajal mund të konsiderohet një normë e përgjithshme që përmbledh në vetvete *ratio*-n e një numri të konsiderueshëm dispozitash kushtetuese dhe ligjore.

47. Si rregull, të tria pushtetet dhe organet e pavarura kushtetuese, në mungesë të mosmarrëveshjeve midis tyre, veprojnë duke zbatuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Ndërsa kur, për shkak të faktorëve politiko-shoqërorë, ato mbajnë qëndrime të ndryshme ndaj normave kushtetuese, duke krijuar situata konflikti, janë të detyruara të bashkëveprojnë me njëra-tjetrën, duke zbatuar parimin e luajalitetit kushtetues, i cili shndërrohet në element thelbësor dhe detyrues për rivendosjen e funksioneve reciproke të pushteteve ose organeve



të pavarura. Parimi i bashkëpunimit luajal shpreh nevojën e krijimit të një modeli qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë eficiente, pasi një model i tillë, me detyrimin që cakton ndaj organeve, e bën Kushtetutën funksionale.

48. Parimi i luajalitetit kushtetues nënkupton se ndërmjet dy organeve kushtetuese, në respekt të kompetencave që i janë dhënë secilit, mund të ekzistojë një marrëdhënie bashkëpunimi, aty ku bashkëpunimi nuk cenon pavarësinë e secilit organ. Ky parim përfshin detyrimin për sjellje koherente dhe jo kontradiktore, pra palët nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse, bllokuese, të paqarta ose të pajustificuara, në mënyrë që bashkëpunimi midis tyre të jetë mbi baza mirëbesimi dhe korrekte, si dhe të jenë të hapura për qasjet e ndryshme të palës tjetër, por gjithnjë duke respektuar kompetencat që i janë dhënë secilës palë. Në këtë kuadër dhe me qëllim mbarrëvajtjen e këtij bashkëveprimi, edhe transparenca e bashkëpunimit ka rol pozitiv.

49. Në kuadër të mosmarrëveshjes së kompetencave, luajaliteti kushtetues nuk është gjë tjetër veçse e anasjella e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Për rrjedhojë, kur krijohet një konflikt kompetencash, detyra e Gjykatës është të imponojë ligjshmërinë kushtetuese për sjelljen e organeve kushtetuese, me ndikim në jetën politiko-shoqërore të vendit. Në këto lloj rastesh Gjykata shqyrton edhe se si palët në konflikt kanë zbatuar luajalitetin kushtetues, duke analizuar dhe testuar sjelljen konkrete të tyre dhe pasojat në çështjen specifike, për të identifikuar nëse ato kanë përmbushur detyrat me korrektësi të ndërsjellë dhe nëse midis nevojave të kundërta është arritur ekuilibri i duhur. Në këtë kuptim, Gjykata kur vlerëson luajalitetin kushtetues kryen një lloj gjykimi të arsyeshmërisë, por njëherazi duke bërë një analizë më të kujdesshme dhe duke ushtruar vetëpërmbytje në krijimin e rregullave të reja.

50. Siç u parashtrua më lart, Gjykata vlerëson se neni 98 i Kushtetutës e trajton emërimin dhe shkarkimin e ministrit si proces të përbashkët, në të cilin marrin pjesë Kryeministri, në cilësinë e drejtuesit të pushtetit ekzekutiv, Presidenti, si organ kushtetues i pavarur dhe Kuvendi, në cilësinë e organit të pushtetit legjislativ. Duke iu referuar qëllimit të përbashkët që ka ushtrimi i kompetencës në këtë proces, ajo nuk mund të ushtrohet në mënyrë të shkëputur nga Kryeministri, Presidenti ose Kuvendi. E thënë ndryshe, në planin juridik

asnjë nga institucionet nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë i vetëm, pa bashkëpunimin dhe bashkëveprimin me të tjerët. Në vlerësimin e Gjykatës, konsultimi dhe bashkëveprimi, si elemente të parimit të luajalitetit kushtetues, pavarësisht formës së zgjedhur nga institucionet (gojarisht ose me shkresë), e ndihmojnë procesin e emërimit të ministrit, në respektim të kriterëve dhe cilësive kushtetuese të kërkuara për këtë pozicion.

51. Si përfundim, në lidhje me nenin 98 të Kushtetutës, procesi i emërimit dhe shkarkimit të ministrit duhet të bazohet në dialogun ndërinstitucional, nga i cili burojnë detyrimet për bashkëpunim luajal kushtetues në marrëdhëniet midis organeve shtetërore. Parimi për bashkëpunim jo vetëm që i detyron organet të respektojnë kompetencat e tyre përkatëse, por mundëson dhe garanton mbarrëvajtjen e të gjithë procesit të përbashkët, pa cenuar kështu pavarësinë dhe ekuilibrin midis ushtrimit të kompetencave nga pushtetet, në respektim të Kushtetutës.

B.2 Për kompetencat kushtetuese të Kryeministrit, Presidentit dhe Kuvendit në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit

52. Kryeministri ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se Presidenti ka vlerësuar nga pikëpamja politike dhe meritokratike kandidatin e propozuar nga Kryeministri, ndërkohë që ky lloj vlerësimi substancial bëhet nga Kuvendi. Sipas tij, kompetenca e Presidentit për emërimin e ministrit është formalisht presidenciale, një kompetencë solemniteti, që konkretizohet në një vlerësim formal të kandidaturës së propozuar për ministër, vetëm për ato kushte që Kushtetuta kërkon për deputetin. Ndërsa në seancë Kryeministri u shpreh se Presidenti është i detyruar të nxjerrë dekretin pa pasur kompetenca verifikuese as në aspektin formal. Gjithashtu, ai ka pretenduar se Presidenti e ka nxjerrë dekretin për shkarkimin e z. Bushati tej afatit kushtetues.

53. Presidenti ka parashtruar se në ushtrimin e kompetencës së tij për emërimin e një ministri ai “kryen një vlerësim kushtetues”, që shkon përtej kompetencës propozuese të Kryeministrit dhe përmbush një qëllim më të madh e më të përgjithshëm sesa ai politik i qeverisë, për të siguruar emërimin e kandidaturave që krijojnë bindjen e plotë se interesi kombëtar nuk do të cenohet. Ai ka vepruar sipas bindjes së brendshme se kandidatura e propozuar në rastin konkret, për



shkak të mungesës së përvojës politike, diplomatike administrative dhe shtetërore, nuk justifikonte interesin publik, unitetin kombëtar dhe sigurinë e vendit për të mbajtur postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Presidenti ka argumentuar se ai nuk ka funksion deklarativ, formal ose honorifik në nxjerrjen e dekretit dhe nuk ka detyrimin për të qenë gjithnjë dakord me autoritetin propozues. Gjithashtu, ai ka parashtruar se dekreti për shkarkimin e ish-ministrit, z. Bushati, është nxjerrë tej afatit kushtetues, pasi ai duhet të qëndronte në detyrë derisa Presidenti të dekretonte ministrin e ri.

54. Kuvendi ka pretenduar se mënyra e vetme me të cilën duhej të shprehej Presidenti është nxjerrja e dekretit për emërimin e ministrit dhe jo refuzimi i propozimit të Kryeministrit përmes një shkrese, gjë e cila nuk është e parashikuar në Kushtetutë. Mosushtimi i kompetencës për dekretimin e ministrit nga Presidenti i ka pamundësuar Kuvendit ushtrimin e kompetencës së tij vlerësuese për miratimin ose jo të ministrit të propozuar. Kontrolli substancial i kandidaturave për ministër bëhet vetëm nga Kuvendi, ndërsa roli i Presidentit në emërimin dhe shkarkimin e një ministri është vetëm akt formal dhe solemn. Në parashtrimet gjatë seancës plenare, përfaqësuesi i Kuvendit u shpreh se Presidenti mund të bëjë vlerësim të kriterëve formale të kandidaturës së propozuar, por jo një vlerësim të natyrës substancial.

55. Gjykata konstaton se sipas nenit 98 të Kushtetutës, Kryeministri ka kompetencën të propozojë kandidatin për t'u emëruar ministër ose ministrin për t'u shkarkuar. Pra, ai ka rolin iniciues në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit.

56. Duke iu referuar diskutimeve në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës (*Debatë Kushtetues, vëllimi I, botim i OSBE-së, viti 2006*), Gjykata vëren se hartuesit e Kushtetutës nuk kanë debatuar lidhur me kompetencën e Kryeministrit për të propozuar kandidatin për t'u emëruar ministër, gjatë periudhës qeverisëse, sipas nenit 98 të Kushtetutës. Ata janë shprehur se Kryeministri është përgjegjës për qeverinë që drejton, pra ka diskrecion për të qeverisur (f. 403) dhe është përgjegjës për veprimtarinë e qeverisë (f. 372). Ministri është anëtar i ekzekutivit, përgjegjës politik i të cilit, në

analizë të fundit është vetë Kryeministri (f. 402), i cili, nëse kërkon shkarkimin e ministrit në Kuvend, duhet të argumentojë përse kërkon ta heqë ministrin (f. 401). Megjithatë, ata kanë evidentuar diskrecionin e Kryeministrit dhe nevojën që ai ka për të pasur pavarësi në zgjedhjen e njerëzve me të cilët do të vërë në jetë programin qeverisës (f. 367).

57. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se qëllimi i kushtetutëbërësit, në fazën e parë të procesit të emërimit të ministrit, pra atë të propozimit, bazuar në nenin 98 të Kushtetutës, është dhënia e diskrecionit Kryeministrit në përzgjedhjen e ministrit, pasi ai është përgjegjës për qeverinë që drejton. Kryeministri në këtë fazë përzgjedh dhe vlerëson kandidatin për ministër, nën përgjegjësinë e tij politike dhe kushtetuese. Ai bën një vlerësim substancial të meritës profesionale dhe përshtatshmërisë politike të kandidatit për t'u emëruar ministër, si dhe një vlerësim të plotësisht të kriterëve dhe cilësive kushtetuese nga ana e këtij të fundit. Këto lloje vlerësimesh janë të lidhura ngushtë me qëllimin e Kryeministrit për të pasur një ekzekutiv të qëndrueshëm dhe për të realizuar programin qeverisës. Edhe në rastin e shkarkimit të ministrit, Kryeministri, nën përgjegjësinë e tij politike, gëzon diskrecion për vlerësimin e ministrit që propozohet për t'u shkarkuar.

58. Gjykata konstaton se, sipas nenit 98 të Kushtetutës, Presidenti ka kompetencën të emërojë dhe të shkarkojë ministrin, me propozim të Kryeministrit. Pra, veprimet e Presidentit përbëjnë fazën e dytë të procesit të emërimit dhe të shkarkimit të ministrit.

59. Duke iu referuar diskutimeve në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës (*Debatë Kushtetues, vëllimi I, botim i OSBE-së, viti 2006*), Gjykata vëren se është vlerësuar nevoja për ta përshtatur institucionin e Presidentit me modelin e republikës parlamentare dhe vendosjen e një qeverie më të përgjegjshme dhe më të fortë në themel të tij (f. 319). Presidenti i Republikës është konceptuar si figurë neutrale, me rol të rëndësishëm në zgjidhjen e krizave, balancimin e pushteteve dhe kryerjen e funksioneve të tyre respektive, rol i cili lidhet edhe me procedurën e zgjedhjes së tij në drejtim të shumicës parlamentare të nevojshme dhe të raundeve të votimit (f. 320). Presidenti nuk duhet të investohet politikisht, sepse duhet të ruajë pozitën e tij të pavarur (f. 393). Ai nuk duhet të



shihet as si pjesë e drejtpërdrejtë e ekzekutivit dhe as si pjesë e drejtpërdrejtë e partive politike, por si një arbitër kushtetues, i cili vetëm në këtë rol mund të zgjidhë krizat institucionale dhe të bëhet garant i Kushtetutës (f. 322). Megjithëse, Presidenti do të jetë neutral, prapëseprapë ai do të ketë kompetenca të rëndësishme për sa i përket emërimit dhe shkarkimit të ministrave, si dhe të një pjese të drejtuesve të organeve të tjera qendrore (f. 320). Kompetenca të tjera në lidhje me pushtetin ekzekutiv, atij nuk mund t'i vishen (f. 326). Presidenti nuk është i detyruar të emërojë personin që propozohet nga Kryeministri, megjithëse refuzimi është një fenomen i rrallë. Kur nuk ka shkaqe që ndalojnë dikë të bëhet ministër, Presidenti do ta bëjë emërimin që i kërkohet nga Kryeministri, ndryshe Presidenti do të përfshihej në jetën politike. Pastaj është Kuvendi që ia jep ose ia heq besimin. Arsyet për të cilat mund të mos e emërosh një ministër janë të gjitha ato që e ndalojnë një person të bëhet deputet (f. 405). Dekreti i shkarkimit të ministrit është i detyrueshëm (f. 399).

60. Bazuar në sa më sipër, qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë që Presidenti të jetë një figurë neutrale, *super partes*, garant i Kushtetutës dhe arbitër në zgjidhjen e krizave institucionale. Gjykata çmon se Presidenti, pavarësisht se për shkak të funksioneve të tij kushtetuese nuk merr vendime politike, ndikon në jetën politike të vendit, në përputhje me rolin që Kushtetuta i ka caktuar në republikën parlamentare. Kështu, në rastet kur vendimet iniciohen nga organe të tjera kushtetuese, Presidenti, përmes rolit që vetë Kushtetuta ia lejon, brenda parametrave kushtetues, bashkëvepron me këto organe dhe në raste të caktuara i nxit ato të reflektojnë për veprimet ose aktet e tyre.

61. Në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, kushtetutëbërësi mund t'i jepte Presidentit rol të lidhur vetëm me betimin e ministrit para tij, siç përcaktohet në disa procedura të tjera, por zgjedhja e kushtetutëbërësit, duke e vendosur Presidentin ndërmjet dy institucioneve, Kryeministrit, nga njëra anë, si propozues dhe Kuvendit, nga ana tjetër, si përmbyllës i procesit, tregon se atij i është dhënë rol verifikues në këtë proces, me qëllim që të garantojë funksionimin korrekt të sistemit dhe mbrojtjen e interesave të përgjithshme të vendit, që të mënjanohet

precedenti i pushtetit të drejtpërdrejtë të partive mbi Kuvendin dhe Presidentin.

62. Gjykata, bazuar në rolin dhe kompetencat e tij kushtetuese, në vështrim të neneve 6/1, 45, 69 dhe 103, të Kushtetutës, vlerëson se Presidenti ka të drejtë të verifikojë kriteret dhe cilësitë kushtetuese të kandidatit të propozuar për ministër. Presidenti i komunikon Kryeministrit arsyet e mospërmbushjes me qëllim rishikimin e kandidaturës për kriteret dhe cilësitë kushtetuese të sipërpërmendura. Ndërkohë, Kryeministri rishikimin e kandidaturës e bën nën dritën e mundësisë së korrigjimit të pengesave kushtetuese të kandidatit të propozuar për t'u dekretuar si ministër i Këshillit të Ministrave. Gjykata çmon se verifikimi që Presidenti bën për kandidatin e propozuar për ministër është një vlerësim jopolitik, i cili bazohet në përmbushjen e detyrës së tij institucionale.

63. Ndonëse neni 98 i Kushtetutës nuk parashikon në mënyrë të shprehur se Kryeministri dhe Presidenti kanë kompetencë për verifikimin e cilësive dhe të kriterëve të kandidaturës për ministër, kjo kompetencë vetëkuptohet, pasi, në të kundërt, neni 98 nuk mund të zbatohet në mënyrë të dobishme dhe të arsyeshme, në kuptimin që procesi i zhvilluar sipas tij të japë rezultatin kushtetues të synuar, atë të emërimit në pozicionin e ministrit të një kandidature që plotëson kriteret dhe cilësitë kushtetuese.

64. Përveç sa më lart, duke qenë se mosmarrëveshja ka lindur për emërimin dhe shkarkimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gjykata do të analizojë rolin dhe kompetencat që Presidenti ka në fushën e politikës së jashtme.

65. Kushtetuta, teksa parashikon se Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm (neni 1, pika 2) dhe se Presidenti është kryetar i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit (neni 86, pika 1), në nenin 92, shkronja “ë”, i jep Presidentit kompetencën të lidhë marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit. Gjithashtu, bazuar në nenin 92, shkronjat “c”, “dh” dhe “e”, të Kushtetutës, Presidenti jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit, me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare, si dhe pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve



diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

66. Në lidhje me kompetencën e Presidentit për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, me natyrë politike, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se kryetari i shtetit përfaqëson shtetin si të tërë, pra unitetin e tij, duke përçarur këtë ide edhe jashtë vendit, qëndrim i cili mbështetet nga nenet 86, pika 1 dhe 92, shkronja “ë”, të Kushtetutës. Përcaktimi i thelbit të marrëdhënieve me jashtë bëhet nga ekzekutivi, i cili, në kuadër të realizimit të programit qeveritar, përcakton drejtimit kryesore të politikës së jashtme, ndërsa shfaqja e këtij vullneti jashtë vendit, në emër të Republikës, bëhet nga Presidenti, duke iu përmbajtur politikës së përcaktuar më parë nga qeveria dhe/ose Kuvendi, sipas rastit. Kryetari i shtetit ka kompetencë të ushtrojë *ius repraesentationis omni modae*, pra të bëjë të njohur ndërkombëtarisht vullnetin e brendshëm shtetëror dhe të përfaqësojë unitetin e shtetit në skenën ndërkombëtare (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

67. Dispozitat kushtetuese i njohin Presidentit rolin e përfaqësuesit më të lartë të shtetit në marrëdhëniet me jashtë, si dhe kompetenca specifike në fushën e politikës së jashtme. Gjykata vlerëson se këto dispozita ofrojnë bazë kushtetuese të mjaftueshme, mbi të cilën Presidenti vepron për vlerësimin e propozimit të Kryeministrit në procesin e emërimit të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kjo mënyrë interpretimi e këtyre dispozitave kushtetuese shërben që Presidenti të ushtrojë kompetencat specifike që ai ka në politikën e jashtme, duke siguruar edhe koherencën e nevojshme të kompetencave që i janë dhënë në planin vendas dhe ndërkombëtar.

68. Gjykata konstaton se, sipas nenit 98 të Kushtetutës, Kuvendi ka kompetencën të shqyrtojë dekretet e Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e ministrit. Pra, veprimet e Kuvendit përbëjnë fazën e tretë të procesit të emërimit dhe shkarkimit të ministrit.

69. Duke iu referuar diskutimeve në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës (*Debatë Kushtetues, vëllimi I, botim i OSBE-së, viti 2006*), Gjykata vëren se hartuesit e Kushtetutës janë shprehur se synohet një ekzekutiv i fortë, por gjithmonë përgjegjës përpara Kuvendit (f. 363). Pas emërimit për herë të parë të

Kryeministrit nga Presidenti të gjitha etapat e mëpasshme të formimit të qeverisë kalojnë ose janë krejtësisht në dorë të Kuvendit. Janë bërë përpjekjet për të krijuar një balancë midis Kuvendit dhe qeverisë (f. 364). Kryeministri nuk mund ta bëjë shkarkimin e ministrit pa miratimin e Kuvendit (f. 403). Kuvendi nuk cakton ministrin, por ka rol kontrollues dhe korrigjues (f. 372) përgjegjësi politike për të nxjerrë ekzekutivin ka Kuvendi (f. 396) Ministri është i zgjedhur nga Kuvendi (f. 422) Kryeministri përgjigjet përpara atyre që e zgjedhin, anëtarëve të Kuvendit (f. 410). Shkarkimi i ministrit bëhet në Kuvend, por formalisht dekreti i Presidentit e mbyll këtë proces (f. 399).

70. Nisur nga sa më sipër, qëllimi i kushtetutëbërësit ka qenë për t'i dhënë Kuvendit një rol kontrollues dhe balancues, në përputhje me raportet e besimit dhe të përgjegjësisë politike që ekzistojnë midis qeverisë dhe Kuvendit. Kështu, dekretet e Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e ministrit, sipas nenit 98 të Kushtetutës, bëhen objekt shqyrtimi në Kuvend dhe janë të lidhura pazgjidhshmërisht me procedurat parlamentare. Gjykata, në lidhje me këto dekrete, ka theksuar se ato hyjnë në fuqi ose shfuqizohen pasi Kuvendi merr një vendim për pranimin ose mospranimin e tyre, në përfundim të procesit të shqyrtimit. Shqyrtimi i këtij dekreti nga Kuvendi është një aspekt i rëndësishëm i rolit kontrollues të këtij organi. Me fjalën “shqyrtim”, sipas nenit 98, pika 2, të Kushtetutës, kuptohet e drejta dhe detyrimi i Kuvendit për të bërë objekt diskutimi e debati dekretin e Presidentit dhe për të marrë një vendim të caktuar për miratimin ose mosmiratimin e tij. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit, i nxjerrë në përputhje me pikën 2 të nenit 98 të Kushtetutës, nuk kufizohet vetëm në kontrollin formal të tij, por dhe në atë substancial, sepse ai është akt i një kontrolli politik të ngjashëm me atë që ushtrohet në kuadrin e një mocioni besimi ose mosbesimi. Duke mos shqyrtuar dekretet e Presidentit, pra duke mos ushtruar Kuvendi të drejtën dhe detyrën e tij, krijohet një precedent i rrezikshëm për funksionimin e shtetit dhe qeverisjen e vendit (*shih vendimin nr. 6, datë 18.1.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

71. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e saj, çmon se Kuvendi, kur ushtron kompetencën për shqyrtimin e dekretëve të Presidentit, në përputhje me rolin e tij kontrollues, bën një



vlerësim kushtetues, meritokratik e politik të kandidatit, si dhe të përmbushjes së kritereve e cilësive kushtetuese, nga ana e këtij të fundit. Nëse Kryeministri dhe Presidenti ushtrojnë kompetencat respektive në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, pa bashkëpunim luajal kushtetues, duke krijuar situata pa rezultat ose pa veprim, e vendosin Kuvendin në pamundësi të ushtrojë kompetencën e tij në këtë proces.

72. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se neni 98 i Kushtetutës përmban edhe dy afate për procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit. Në bazë të këtij neni ministri propozohet nga Kryeministri, emërohet me dekret nga Presidenti, brenda 7 ditëve, dhe dekreti i Presidentit shqyrtohet nga Kuvendi brenda 10 ditëve. Kushtetuta nuk ka parashikuar afat për ushtrimin e kompetencës propozuese nga Kryeministri, megjithatë kuptohet interesi i tij për të vepruar pa vonesa, nisur nga përgjegjësia që ka për qeverinë që drejton dhe roli parësor që ka si nismëtar i procesit të emërimit dhe shkarkimit të ministrit. Këto afate kushtetuese, konkretisht ai 7-ditor për një organ monokratik si Presidenti dhe ai 10-ditor për një organ kolegjal si Kuvendi, janë vendosur për qëllime verifikuese dhe vlerësuese të kandidatit. Pra, në të dyja rastet, qëllimet e këtyre afateve kushtetuese janë të njëjta, ndaj edhe në vlerësimin e Gjykatës është i rëndësishëm respektimi i tyre për arritjen e objektivit të përcaktuar nga norma kushtetuese, që është përfundimi i procesit të emërimit të ministrit dhe fillimi i ushtrimit të detyrës prej tij, çka përbën interes publik dhe shtetëror, siç është arsyetuar më lart në paragrafin 23 të këtij vendimi. Parashikimi i afateve kushtetuese për realizimin e procesit të emërimit dhe shkarkimit të ministrit ka rëndësi, pasi i detyron organet kushtetuese të përfshira në këtë proces të shprehen dhe të veprojnë brenda këtyre afateve, në mënyrë që të mos krijohet bllokim institucional, të garantohet një vazhdimësi në veprimtarinë e përditshme të ministrisë përkatëse, si dhe të zhvillohet një proces i shpejtë dhe efektiv i emërimit dhe shkarkimit të ministrit.

73. Gjykata thekson se nëse organet e përfshira në këtë proces nuk do të respektonin këto afate, kjo do të ndikonte negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vetë qeverisë. Prandaj, organet kushtetuese që ushtrojnë kompetenca në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit duhet të përmbushin detyrimet që kanë në këtë proces, në

respektim të afateve kohore të vendosura në nenin 98 të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, me përfundimin e procesit brenda afateve kushtetuese sigurohet edhe mirëfunksionimi i Këshillit të Ministrave, me një anëtarësi dhe përbërje të plotë, në përputhje me nenin 95, paragrafi 1, të Kushtetutës.

74. Gjykata vëren se procesi i shkarkimit, sipas nenit 98 të Kushtetutës, është i ndryshëm nga ai i emërimit të ministrit, sepse Kushtetuta nuk ka përcaktuar kritere e shkaqe dhe as mjete mbrojtjeje për shkarkimin e ministrit, që do të thotë se shkarkimi i tij lidhet drejtpërdrejt me raportin e besimit që Kryeministri duhet të ketë kundrejt ministrit. Po ashtu, në ndryshim nga rasti i emërimit të ministrit, në rastin e shkarkimit të tij nuk ka interes publik, pasi nuk merren përsipër përgjegjësi shtetërore, përkundrazi këto përgjegjësi shtetërore lihen nga ministri i shkarkuar. Gjykata vëren se procesi i emërimit dhe i shkarkimit të ministrit, pavarësisht se janë dy procedura të ndara, janë të përfshira në të njëjtën dispozitë kushtetuese. Për këto arsye, procesi i shkarkimit bazohet në marrëdhëniet e besimit politik mes Kryeministrit dhe Kuvendit. Lidhëza bashkërenduese “dhe” në bashkimin e termave “emërim” dhe “shkarkim”, në përmbajtje të normës juridike, tregon se këto dy procese kanë një qëllim të përbashkët, që është pikërisht shmangia e krijimit të boshllëkut institucional dhe garantimi i vazhdimësisë së veprimtarisë së ministrisë përkatëse.

75. Në vështrim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata çmon se vlerësimi dhe verifikimi i kandidatit për ministër që garanton përmbushjen e kritereve dhe cilësive kushtetuese për këtë funksion, bëhet nga të tria organet e përfshira në proces, të cilat, të udhëhequra nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ai i luajalitetit kushtetues, e kryejnë këtë vlerësim sipas rolit dhe kompetencave të tyre kushtetuese, brenda afateve kushtetuese.

76. Përfundimisht, Gjykata vlerëson se organet e përfshira në procesin e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit mund të përmbushin detyrimet e tyre kushtetuese dhe arritjen e synimit të kërkuar nga kushtetutëbërësi për emërimin dhe fillimin e ushtrimit të detyrës nga ministri, si dhe për shkarkimin e ministrit, vetëm duke i dhënë kuptim dhe zbatim nenit 98 të Kushtetutës, sipas arsyetimit të këtij vendimi.



PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç” dhe 134, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 54, 55, 56, 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Pushimin e gjykimit për kërkimin mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kryeministrit dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
3. Interpretimin përfundimtar të nenit 98 të Kushtetutës, për sa vijon:
 - Në procedurën e emërimit dhe të shkarkimit të ministrit, Kryeministri, Presidenti dhe Kuvendi udhëhiqen nga parimi i luajalitetit kushtetues dhe ai i ndarjes dhe balancimit të pushteteve;
 - Kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e ministrit ndahet ndërmjet tri organeve të mësipërme;
 - Procesi i emërimit të ministrit duhet të garantojë përmbushjen e kriterëve dhe cilësive kushtetuese për këtë funksion;

- Vlerësimi dhe verifikimi i kandidatit për ministër bëhet nga të tria organet e përfshira në proces, secili sipas rolit dhe kompetencave të tij kushtetuese, brenda afateve kushtetuese, në përputhje me arsyetimin e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.5.2021.

Shpallur më 18.6.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 403 (2551), datë 29.4.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ali Oso Meti, i lindur më datë 14.1.1932, në Oblikë, dhe banues në Oblikë, Njësia Administrative Ana e Malit dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuesit Tahir Ali Meti.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë